

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-32

G 97

M. S. GURRA

KUR rilindet Shqipëria



814.32
997.
81-7
60695

MILTO SOTIR.GURRA

~~21188~~
930

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

KUR RILINDEJ SHQIPËRIA...

(Tregime të zgjedhura)

Zgjedhur dhe redaktuar
n ga
Nasho Yorgaqi

Doc
Kopertina nga : 00 1.32.
10000 78/37
N. SH. BOTIMEVE TIRË «NAIM FRASHËRI»
ANË, 1958



MILTO SOTIR-GURRA

SHKRIMTARI PATRIOT MILTO SOTIR-GURRA

Më 1908, pesëdhjetë vjet të shkuara, njëzet e katër vjeçari Milto Sotiri, botoi në gazetën «Kombi» të shqiptarëve të Amerikës tregimin e tij të parë «Fyelli i fabrikës». Ky ishte një tregim i thjeshtë, që bënte fjalë për jetën e punëtorëve shqiptarë në Amerikë, por që ka rëndësi, sepse shënon fillimin e një veprimtarie të gjatë, patriotike-letrare prej gjysmë shekulli, të shkrimtarit veterani Milto Sotir-Gurra.

Shkrimtari Milto Sotir-Gurra hyri në letërsi në fillim të shekullit tonë, në prag të përpjekjeve të mëdha që bënte populli ynë për çlirimin e tij kombëtar. Në këto përpjekje fisnike, ai dha kontributin e tij si shkrimtar e publicist patriot.

I brumosur me idetë patriotike të rilindasve, duke jetuar pranë popullit, pa u shkëputur nga problemet e kohës dhe ngjarjet e ditës, i njohur me lëvizjen revolucionare në Ballkan e në Rusi, i ushqyer nga idealet humaniste të letërsisë së madhe ruse, ai u bë një militant i çështjes shqiptare dhe u njoh si njeri i pendës në shtypin dhe botimet e kohës.

Milto Sotiri ose Milto Sotir-Gurra, siç njihet në letërsi, lindi më 15 maj të vitit 1884 në fshatin Marjan të krahinës së Oparit. Babai i tij, Ligori, i shtrënguar nga vështirësitë ekonomike, kish emigruar prej kohësh në Odesë të Rusisë. Kur Miltoja ish në moshën 5 vjeçare, familja e tij u mbart nga fshati në Korçë. Këtu ai mbaroi shkollën plotore të qytetit dhe, që të vazhdonte më tej, Milton e ri e tërhoqi i jati në Odesë, ku atje ai mbaroi shkollën e mesme.

1978
1884
— 95

Në këtë kohë, nëpër kolonitë shqiptare, dhe veçanërisht në atë të Amerikës, kish marrë hov lëvizja patriotike, që drejtohej jo vetëm kundër turqve, që e mbanin vendin tonë prej shekujsh në robëri por, edhe kundër shovinistëve grekë, të cilët nën maska të ndryshme punonin në dëm të Shqipërisë. Për këtë qëllim filluan të ngrihen shoqëri patriotike dhe të dalin gazeta. Milto Sotiri, që sapo mbaroi shkollën në Odesë, hidhet në Amerikë dhe bie në kontakt me këtë lëvizje. Hyn punëtor në një fabrikë dhe, nga ana tjetër, vazhdon të punojë për atdheun e largët. Së bashku me Nolin e patriotë të tjerë lufton për shkëputjen e kishës shqiptare nga kisha greke.

Më 1908, meqë në Amerikë u përhap një krizë e rëndë ekonomike dhe u mbyllën shumë fabrika, e si pasojë ish keq për punë, Milto Sotiri u kthye prapë në Rusi. Kësaj here nuk qëndroi shumë atje, sepse ish koha kur u shpall hyrieti. Edhe ai, si dhe shumë patriotë të tjerë, i gënjyer nga shpresa të kota, shkon në Stamboll e pastaj në Korçë. Në këtë kohë ai nis aktivitetin letrar-publicistik: boton në kalendarin «Afërdita», që drejtonte Cili Vre-Shqipëri?», shkruan dramën «Nderi» që mbeti e pabotuar, boton tregimin e parë që përmendëm më lart, dhe nis të përkthejë vepra të vogla nga letërsia ruse. Më vonë, ai e zgjeron aktivitetin e tij letrar duke botuar tregime të ndryshme nëpër gazeta, kalendare dhe në vëllime më vete.

Para shpalljes së pamvarësisë më 1912, M.S. Gurra ishte redaktor i gazetës «Liria e Shqipërisë» në Sofie. Më 1914 punon si redaktor i gazetës «Atdheu» në Shqipëri, e cila luftonte politikën antikombëtare të tradhëtarit Esat Pashë Toptani.

Më 1914, kur fuqitë e mëdha vendosën të sjellin si mbret të Shqipërisë Princ Vidin, Milto Sotir-Gurra zgjidhet si delegat i kolonisë shqiptare të Odesës dhe dërgohet në Shqipëri. Por pas largimit të princ Vidit dhe me fillimin e luftës së parë botërore, ai kthehet për të fundit herë në Rusi. Këtu ai tashti shkruan tregimet dhe novelat e tij më të mira. Kur triumfoi Revolucioni i Tetorit,

ai ndodhej në Peterburg dhe që dëshmitar i ngjarjeve të mëdha.

Me të mbaruar lufta e parë botërore, ai vjen në atdhe. Në Shqipëri, në këtë kohë zjente një luftë e madhe politike. Milto Sotir-Gurra merr pjesë në Kongresin e Lushnjës dhe zgjidhet si sekretar i delegacionit shqiptar që mori pjesë në Konferencën e Paqës të Versajës.

Në vitin 1921, ai kthehet përfundimisht në Shqipëri. Vendoset në Korçë dhe vazhdon të merret me aktivitet letrar. Fillon e nxjerr revistën letrare-kulturale «Shkëndia», revistën satirike «Zeghi» dhe bashkëpunon me organet e shtypit të kohës.

Ardhja e satrapit Zog në fuqi, pas luftës së ashpër politike që u zhvillua në vitet 20-të, që për M. S.-Gurrën një goditje e rëndë që u bëhej forcave demokratike në Shqipëri. Por pas disa vjetësh, kur Zogu e stabilizoi situatën politike në vënd dhe arriti të bënte me vete disa nga patriotët, duke spekuluar në ndjenjën e tyre të atdashedhurisë, shkrimtari Milto Sotir-Gurra, që kish luftuar për pamvarësinë e vëndit, u gënjye nga kjo demagogji, dhe shkroi ndonjë vjershë a artikull apologjetik për regjimin në fuqi. Por këtë shkëputje nga idealët e tij demokratike, M.S.-Gurra e kuptoi më vonë, me luftën nacionale çlirimtare, të cilën e aprovoi dhe e përkrahu plotësisht.

Pas çlirimit të vëndit, Milto Sotir-Gurra u vu menjëherë në shërbim të pushtetit popullor si përkthenjës nga gjuha ruse.

Shkrimtari patriot, megjithëse tashti është në një moshë të thyer, prapsepapë, i entuziazmuar nga transformimet e përparimet e Shqipërisë së re, punon me zjarrin e një të riu, sepse vetëm në ditët tona, nën pushtetin popullor, ai sheh të realizuara idealët për të cilat ëndërroi dhe luftoi gjatë gjithë jetës së tij 70 e ca vjeçare.

* * *

Shkrimtari Milto Sotir-Gurra ka zhvilluar një aktivitet letrar prej afro gjysmë shekulli. Krijimet e tij të para janë disa vjersha patriotike të shkruara në vitet

1901-1903, me anë të të cilave ai bënte thirrje për luftë kundër turqve.

Më vonë, duke filluar nga viti 1908, ai nis e shkruan tregime e artikuj, të cilat i boton në shtypin shqiptar të kohës, si në gazetat «Kombi», «Dielli», «Kalendari kombiar» i Sofies, «Atdheu», «Liria e Shqipërisë» e të tjera. Në prag të shpalljes së pamvarësisë dhe veçanërisht në vitet 1912-1920, i frymëzuar nga ngjarjet e kohës, ai zhvillon një aktivitet të frutshëm letrar. Të kësaj periudhe janë dy vëllimet me tregime që boton në vitin 1911: «Goca e Malësisë» dhe «Rrëfenja». Veç këtyre dy librave që ai shtyp në koloninë shqiptare të Sofies, boton edhe mjaft tregime me tematikë patriotike dhe shoqërore, të cilat i gjejmë nëpër revistat, gazetat e kalendaret, që dilnin brënda ose jashtë vëndit.

Duke filluar nga viti 1921, ai drejton në Korçë, për tre vjet rrjesht revistën «Shkëndia», në të cilën boton shumë nga krijimet e tij. Bie në sy veçanërisht prodhimi i tij poetik, që ai boton në këtë revistë. Këru, përveç krijimeve origjinale të autorit, do të gjejmë edhe mjaft përkthime nga letërsia ruse, si tregime të Gorkit, të Turgenjevit, vjersha të Pushkinit, Nikitinit e të tjera. Puna e tij si përkthyes i parë dhe popullarizues i letërsisë së madhe ruse, shihet në vitin 1924, kur përkthen tri dramat e A.S. Pushkinit, «Mocarti dhe Salieri», «Kalorësi dorështrënguar» dhe «Rusalka».

Në këto vite deri më 1927 ai boton në «Gazetën e Korçës» më se 100 skica letrare, nëpërmjet të cilave jepen mjaft aspëkte të jetës shqiptare të asaj kohe. Në vitin 1925, Milto Sotir-Gurra përktheu komedinë «Fshatari zotni» të shkrimtarit danëz L. Holberg. Punën e dobishme si përkthyes e zgjeron më shumë në vitin 1928, kur themelon «Bibliotekën e të rinjve» dhe boton gjashtë broshura me tregime nga të Gorkit, Çehovit, Tolstoit, e të tjerë.

Gjatë kësaj kohe, ai nuk le pas krijimet origjinale dhe, në vitin 1938, boton vëllimin me tregime «Plagët e kurbetit».

Disa vjet më vonë, më 1944, boton vëllimin tjetër me tregime: «Goca e Kaçanikut» e tregime të tjera. Po këtë

vit, drejton edhe revistën tërheqëse për fëmijë «Mituria».

Nuk po përmendim këtu disa vepra në dorëshkrim, si një vëllim me tregime të pabotuara, një përmbledhje voluminoze me vjersha, disa vepra të përkthyer nga letërsia ruse, si «Taras Bulba» e Gogolit «Vajza dhe vdekja» e Gorkit, tregime të shkrimtarëve rusë, «Fajtorët pa faj» të Ostrovskit e të tjera. Gjithashtu nuk po përmendim këtu shkrimet e tij për të veçantit, artikujt publicistikë, disa studime me karakter informativ mbi rilindasit tanë e të tjera.

Siç shihet nga sa përshkruam më lart, shkrimtari Mito Sotir-Gurra ka një aktivitet të gjërë letrar, aktivitet ky që i ka sjellë dobi zhvillimit të letërsisë dhe kulturës sonë.

Tregimet që po botojmë, të marra nga librat dhe shtupi i atëhershëm, janë një pjesë e punës që ka bërë shkrimtari gjatë gjysmë shekulli. Këto tregime të shkruara në kohën kur vendosej fati i Shqipërisë, kur populli ynë, në saje të luftës së tij të madhe, po rilindej pas pesë shekuj robërie, janë një dëshmi e gjallë, që rrëfejnë patriotizmin e shkrimtarit dhe egzistencën e një letërsie që militonte në atë kohë për luftën e popullit.

Megjithëse ne e kemi ndarë vëllimin në katër pjesë, atë e bashkon në tërësi një ide e përbashkët: dashuria për Shqipërinë e robëruar dhe urrejtja kundër shtypjes së huaj.

Në pjesën e parë «Kur rilindej Shqipëria», kemi zgjedhur përgjithësisht tregime me tema patriotike, që pasqyrojnë aspekte të ndryshme të luftës së shqiptarëve kundër turqve në fillim të shekullit tonë. Në pjesën e dytë «Plagët e kurbetit», hyjnë tregime që flasin për të këqijat e mëdha që i ka sjellë kurbeti popullit tonë, kurse në pjesën e tretë «Plagët e zemrës» përmbledhen tregime me motive dashurie, por të gërshetuara me ide patriotike dhe së fundi, në pjesën e katërt «Të ndryshme» hyjnë tregime me subjekte të marra në përgjithësi nga jeta e rëndë e vegjëlisë shqiptare pas shpalljes së pamvarësisë.

Gjëja kryesore në këto tregime është fryma e shëndoshë që i përshkon ato, e cila e ka burimin në zjarrin

patriotik, që ish ndezur atëhere anembanë Shqipërisë së robëruar.

Atdheu dhe fati i tij — ja tema qëndrore që kushtëzoi fatin e heronjve dhe drejtimin e ngjarjeve pothuajse në të gjitha tregimet.

Heronjt e këtyre tregimeve janë njerëz të thjeshtë: vegjëlja e fshatit dhe e qytetit, që i kanë kthyer krahët parësisë dhe kanë marrë përsipër çlirimin e vëndit nga sundimi i huaj. Këta janë luftëtarët trima që mbushin çetat e lirisë, njerëzit që përhapin idetë e luftës për çlirim, që shpërndajnë libra dhe gazeta patriotike ilegalisht, që bëjnë sakrifica të panumërta, njerëz me zemër të madhe, që japin edhe jetën për kauzën e lirisë. Kështu p.sh., në tregimin «Ustai dhe çiraku» tregohet se si një çirak jep rrogën e tij të vogël për t'u pajtuar në një gazetë patriotike, kurse ustai i tij, një tregëtar i pasur, refuzon të ndihmojë dhe të pajtohet në gazetë. Po për një çirak patriot që punon fshehurazi në qytet për çetat e lirisë bën fjalë edhe tregimi «Dy mendimet».

Tregimet mbi kurbetin janë faqe të dhimbëshme të jetës sonë të kaluar. Ato flasin për lotët e nënave, të nu-seve e të motrave të braktisura, për ndarjet pa shpresë, për rrugët e gjata që marrin kurbetllijtë, për varfërinë e tyre, për mallin dhe pendesën, për kthimin e tyre pranë vatrës të gjymtuar fizikisht e shpirtërisht. Tregimet e kurbetit janë shkruar me ndjenja, sepse autori e ka marrë vetë disa herë rrugën e rëndë të mërgimit.

Këto tregime që përmendëm dhe të tjera, që përmbledhen në këtë vëllim, mund t'u duken një pjese të lexonjësve të kohës sonë pak si naive dhe të papjekura plotësisht nga ana artistike. Është e natyrëshme se, duke i parë këto tregime me syrin e sotëm, e aqë më tepër me kërkesat e ditëve tona, në këto tregime të shkruara shumë vjet përpara, do të gjejmë dobësi artistike, të cilat në përgjithësi i përkisnin edhe prozës sonë të kohës. Por, duke lexuar këto tregime, çdo lexues do të konstatojë talentin e autorit, frymën patriotike që përshkon tregimet e tij, sinqeritetin, thjeshtësinë, disa figura të goditura, fak-

tin që ai i ka trajtuar ngjarjet në veprat e tij nga pozitativ e vegjëlisë, si dhe anë të tjera pozitive.

Shkrimtari M.S.-Gurra është një autor që zë një vënd të merituar në historinë e letërsisë sonë gjatë viteve të fundit të rilindjes dhe pas rilindjes. Ai, duke qenë bashkëkohës dhe shok ideje e pende me Nolin, Postolin, Gramenon, u përpoq që, nëpërmjet veprave të tij, të përhapit idetë e luftës për çlirim, të forcojë në popullin tonë ndërgjegjen kombëtare dhe, nga ana tjetër, të kontribuojë në lëvrimin e letërsisë shqipe.

Botimi i kësaj përmbledhje me tregime të zgjedhura do të ndihmojë që lexuesit e rinj të njohin disa nga faqet e bukura të historisë sonë të kaluar, kur Shqipëria po rilindej.

Nasho Jorgaqi

Shtator 1958

7

The following is a list of the names of the persons who have been appointed to the various positions in the office of the Secretary of the State of New York, for the term ending on the 31st day of December, 1900.

Secretary of the State: William C. Clegg

Comptroller of the State: William C. Clegg

Attorney General: William C. Clegg

Commissioner of the State Land Office: William C. Clegg

Commissioner of the State Canal Office: William C. Clegg

Commissioner of the State Marine Office: William C. Clegg

Commissioner of the State Fish and Game Office: William C. Clegg

Commissioner of the State Prison: William C. Clegg

Commissioner of the State Hospital: William C. Clegg

Commissioner of the State Lunatic Asylum: William C. Clegg

Commissioner of the State Normal School: William C. Clegg

Commissioner of the State University: William C. Clegg

Commissioner of the State Library: William C. Clegg

Commissioner of the State Archives: William C. Clegg

Commissioner of the State Printing Office: William C. Clegg

Commissioner of the State Office of the State: William C. Clegg

WILLIAM C. CLEGG

1900

NJË SY NË ATDHE

Çdo prendverë atdheu im vishet me rroba të gjelbëra. Fushat e gjëra, që janë mbjellë, zgjaten gjer në rrëzët e maleve të lartër, majërat e të cilëve s'i kap dot as drita e syrit. Rrëzë maleve duken shtëpitë e bardha e të ndara njëra prej tjetrës me drurët e gjelbër, që janë mbuluar me lule. Kanë shkuar shumë prendvera që nuk kam mundur të kthehem n'atdhe. E kur kthehem nga puna e rëndë, i lodhun e i këputur, kur kthehem mbrëmave në shtëpi, fshihem nga shamata e nga brenga, që më kllat një tmerr, udha e qytetit të madh, dhe futem në dhomën time të errët ku më kujtohen pikturat e atdheut:

Mbrëmja e qetë lëshohet mi katundet e mi fushat... Mali duket si gjigand... Nga penxhëret e shtëpive të bardha del një dritë e artë... Qielli është mbushur plot me yj. Në ca vise të fushës, me zë të unjtër ndëgjohet cicërimi i shpeshëve që këputet përnjëherë... Herë-herë ndëgjohen të lehurat e qenve që bashkohen me hingëllimin e kuajve dhe me blegërimin e dhenve. Vjen nata e bellustë¹⁾ e plot me aromë... Përmi lumin ndëgjohen këngë, të forta e të bukura. Zemra më mblidhet... Mejtimet e rënda ma pushtojnë kokën... Përkëllohem se që të gjitha, sa më rrethojnë, më duken të ndryshme e shumë më t'errta se më parë... Shtrihem mi të nxiruarin shtrat... dhe e ndjej veten fillka vetëm...

* * *

Nesër duhet të ngrihem shpejt... do të vete ne tabrikë ku, në trutë e mia, do të rrutullohen mejtimet... do të më duken pikturat e atdheut tim... do të më tërheqin e do të mos më lenë të qetë... Do të më kujtohen sytë e kaltër posi qielli i shkëlqyer... fytyra e djegur prej diellit dhe flokët e shpeshta, të dredhura.

1) e bellustë = e kadifejt, e lëmuar si kadife.

të arta... Ka shumë kohë që nuk i kam parë, edhe kur isha në atdhe... kur e prisnja te dera që të dilte duke përgjuar zërat e fshehta të natës prendverore... Ka shkuar shumë kohë... Po ish një herë... Tani rashë në mejtime... u lodhshë... u ligshë. Po ajo, a mejton vallë nonjë herë për mua?... Mund që më sjell ndër mënd, natën, kur qielli është plot me yj... del në udhën e madhe... përgjon çdo zë të fshehtë... Shkon pa qëllim... sheh yjtë, largmë dhe merr udhën për në fushën e paamët, duke ja thirrur këngës... E zëri i saj i hollë, i ëmbël, i sërmanjtë, forcohet, zgjërohet dhe rritet kënga e saj që është plot pikëllim.

* * *

Çdo prendverë, në atdheun tim, gjelbërojnë fushat, buzëqeshin malet, këndojnë lumenjtë dhe vishen me lule qërshitë. Po sytë e bukur e të kaltër qeshin apo qajnë? Po ballëza e bukur, e gjërë, e bardhë a mos është rrudhur? E, kur unë, i lodhur e i këputur, do të kthehem në atdhe a do ta ve kokën në prehërin e saj, a do të më përkëdhelë... a do të m'i pillojë flokët?

Ah, atdhe! Do të mos mund të kthehem tek ti e do të mos mund ta shoh as qiellin prindror, as fushat e gjelbëra e syt e kaltëra dhe do të mos mund t'a ndëgjoj as gjuhën e ëmbël të nënës... Do të mbetem në burg... dhe për mua, qyteti i madh, është më i keq se burgu... Këtu nuk jam vetëm... me mua bashkë janë mijëra njerëz që nuk e shohën qiellin bashkë me yllin e bukur, me Diellin që ndrit botën... që nuk shijojnë erën e malit dhe aromën e luleve të fushave e të kodrave; që nuk shohën fushat e gjelbëra e të gjëra... nga ditë tymosen nëpër fabrikat ku punojnë... ku fitojnë para dhe ku verdhin fytyrën e kalbin mëlcitë.

Ah, atdhe, që do të mos mund të kthehem e të të shoh!

Odesë, 1915.

DY MEJTIMET

Dyqanet po mbylleshin. Njerëzia me trajstat plot me gjëra për në shtëpi, po ngjiteshin që nga pazari. Kafet ishin të hapura, plot me njerëz. Nga to dilte një zhurmë e fortë.

Qielli ish mbushur me re. Shkrepëtima, pas së cilës ndëgjohej gjëmimi, ipte të kuptonim që do të binte shi.

Ora e tregut trëngëlliti një allaturka.

Në këtë kohë Taqoja, Piloja, Hyseni dhe Jakupi po losnin dandanecin.¹⁾ Më tutje, ca të tjerë, losnin skambilë; ca të tjerë trambën. E më anën e djathtë, afër derës, po losnin tavllën, Isufi me Raqin.

Has, fand, plak, dhjeta e mirë... bëjmë një... e poqa. Cilë kemi kos... shkruajmë 17... 8... Tymi i duhanit përhapej. Çesa²⁾ fjalë, që nuk shkruhen dot, e mbushë odën e gjatë të kafesë, që i kish muret e nxira nga tymi, dhe fronat s'i kish të sigurta e t'i çirnin pantallonat.

Ora shkonte. Zërat shumoheshin. Tymi i duhanit përhapej në dhomën e kafesë dhe u qëndronte myshterive mi kokë si nonjë re.

Kur e mbaruan lodrën u vajti kafexhiu... Porosit në një pesëdhjetësh prej manash dhe, duke ngrënë meze, duke qeshur e duke ngarë ata që u mundnë, e pinë.

1) dandanec-i = një lloj lodre me letra.

2) çesa = disa.

Njerëzia po ngriheshin dhe shkonin nëpër shtëpitë ku i prisnin të hanin darkë.

Shoqëria jonë porositi dhe një pesëdhjetësh. Shaka-të, të qeshurat, u lanë mënjanë dhe bisedonin, me zë të unjtër për gjëra me rëndësi.

— A kemi leje të rrimë? — u tha Raqi me Isu-fin.

— Urdhëroni, urdhëroni, nga ju s'kemi të fshehta.

Këta që të gjashtë ishin dhe nga kombësia dhe nga ndjenjat shqiptarë. Bisedimi përmbledhej mi temën e kryengritjes së Veriut. Puna bisedohej me zëur. Secili do çfaqte mejtimit.

— Nuk është vëndi këtu, — u tha Jakupi. — do të na përgjojnë.

— Po, — tha Taqoja, — dhe ashtu na kanë në def-terin e djallit se na njohën.

Kupat që ishin plot, i ngritnë, i çokitnë dhe, duke thënë: ...«Perëndia na nxjerrtë faqe bardhë», u dhanë fund.

— Kjo punë duhet biseduar mirë, — tha Raqi.

— Ngrehuni të shkojmë. Vemi në shtëpi tonë, — tha Taqoja. Unë jam vetëm dhe s'ka kush të na bëhet bela.

Ora kish kaluar. Myshterinjtë kishin shkuar dhe kishin mbetur vetëm miqtë tanë. Në çipin e fundit ish një burrë i cili pareshtur e lëshonte tymin e duhanit nga hulluket e gjëra të hundës. E kish drejtuar veshin nga miqtë, desh të përgjonte po, s'i eci sepse, zërat nuk arrinin dot në veshin e tij.

— Eja të ngrihemi se po shkon koha. Ja, kafexhiu i mbylli qepenat, — tha Piloja, — apo kërkoni të pa-guajë nonjë xheza për ne.

Paganu, u ngritnë dhe si i thanë kafexhiut «natën e mirë» muar udhën për në shtëpitë, duke e ndarë fjalën të piquen pas darke në shtëpinë e Taqos.

Hullukgjëri, pasi e pa që u ndanë, i çkujdesur vaj-ti të ipte raportin.

Ora edhe nuk kish vajtur tre kur që të gjithë miqtë ishin në shtëpinë e Taqos. Plaka ua shtrëngoi dorën dhe i pyeti për shëndetin, ashtu siç dinë ato të pyesën. Ajo ish një grua e fishkur, e moçëme, e thinjur dhe e sëmurë.

Filluan bisedimet. Fjalën e mori Raqi i cili, pasi ua shpjegoi nevojën e kryengritjes dhe detyrën e çdo shqiptari, u tha:

— Besoj se që të gjithë mejtoni kështu! S'e besoj të ndodhet nonjë prej jush që t'i dhimbet jeta! Punërat qëndrojnë ashtu siç ju thashë. Gjoni me Raqin më shkruajnë se i kanë të gjitha gati. Këto dit do ta fillojnë. Më shkruajnë të pëqemi në Z... S'duhet ta turpërojmë Korçën... duhet dhe ne ta mbarojmë detyrën.

— Korça kurrë nukë ka mbetur prapa dhe s'e ka nxirë faqen, — tha Hyseni.

Në këtë kohë u ndëgjuan zërat e tjera «ta mbarojmë detyrën»... «të shkojmë»... Vetëm zëri i Pilos ish i unjtër dhe si i drëdhur.

Piloja ish një djalë gjer më nonja 22 vjeç, mjaft i bukur në fytyrë dhe i pëlqente mëndja. Sytë i kish të shkruar dhe të qeshur. Ish një nga shqipëtarët e mirë dhe më çdo çështje ish i pari. Kur tha fjalën «ta mbarojmë detyrën», u verth në fytyrë... i shikoi miqtë, të cilëve as tërr s'u bëri veshi, dhe i mati me sy duke dashur të kuptojë ç'mejtojnë.

Në këtë kohë u ngrit Jakupi dhe desh të fliste, po hyri plaka që solli kafënë. E këmbyen bisedimin dhe kur doli plaka e mori fjalën Jakupi e tha:

— S'besoj të ketë shqiptar në botë që të mos ndizet, sot, kur po shtohet dhe rëndësohet robëria... Pa shkollë... pa të drejta... s'mundim ta hapim gojën që jemi shqiptarë... E a durohet? Për besë jo... Të shkojmë... të vemi fshat më fshat... t'i ngremë që të gjithë dhe ta lirojmë Shqipërinë.

— Po, po, duhet ta lirojmë! — thanë me një zë miqtë. Piloja prapë me zë të dredhur i tha këto fjalë. Atij i humbi gojëartësia dhe ay, që ish si tagar¹⁾ i shpuar, këtë natë nuk nxirrte asnjë fjalë. I hupnë që të gjithë dhe mezi ndëgjoheshin vërshtëllimet. E pushuan mejtimet: ato ja mbyllë gojën, ja humpnë fjalët dhe ja prishnë kurdisjen e mirë. Tashi përpara tij i dukej sikur ish mali... sikur ish kryengritës... I pa ushtarët dhe u përpoq me ta... I ndëgjonte plumbat si vërshtëllenin dhe më në fund iu duk sikur u vra. U droth i tëri. Ish i pushtuar nga këto mejtime kur i tha fjalët e sipërme. Ra prapë në mejtime. Tani i dukej sikur shkonin në male të lartëra... sikur u hoth në luftë. I ndoqi askeri... e zunë skllaf... e rrahnë që t'i dëftente shokët!... e shpunë përpara ofiqalit, që e pyeti me zë të lartër... I dukej sikur i përgjigjej: «Jo, s'di asgjë... jo, nuk e di ku e kanë qendrën... s'kam shokë... E shtruan në dru... e munduan shumë... s'duronte dot... i dëfteu shokët... e futnë haps... atje u poq me shokët... i vinte turp t'i shihte e ata, i dukej, sikur theshnin: «Jazëk të qoftë, ne të dhamë besën e ti na more më qafë».

Në këtë kohë teshtiu dhe i largoi mejtimet. Kur shtiu sytë nga miqtë e pa që ishin gati të dilnin.

— Fjalën e nderit, që do të jemi gati të premtën, — u ndëgjuan fjalët dhe miqtë u larguan nga shtëpia e Taqos.

Piloja, kokëvarur dhe me çape të ngadalta, shkante udhës së madhe. U freskua nga era e ftohtë e natës dhe sikur u lehtësua nga mejtimet. Duke thënë: «Duhet të vdes për kombësinë» iu afrua shtëpisë dhe trokëlliti në derën e vjetër. Ja hapi e motra... hyri dhe u drejtua në odën e tij.

Llamba po digjej me fitil të unjur. Kandili i korës²⁾ ish i ndezur. E hapi llambën dhe duke ardhur

1) tagar-i = enë matëse — masin bereqet.

2) Kandili i korës = kandil i ikonës.

vërdallë nëpër odën, në këndin e së cilës i kishin shtruar për të fjetur, ra në mejtime. Mejtohej për kryengritjen dhe e pyeste veten: «Bëj unë për kryengritës? A do të duroj dot uri, të ftohtë, etje, ndjekjen e ushtërisë? Po të plagosem? Po të më vrasin?» Vdekja e turbulloi shumë se dhe ky i kish thurur endrat e veta: desh të martohej, ta gëzonte tëmën, se ajo nuk kish ditë të mos ngulte këmbë për këtë gjë. Ay desh ta martonte të motrën. Desh ta mbante mirë tëmën se ajo nuk kish parë asnjë ditë të bardhë në tërë jetën e saj. U mejtua për gjithë këto, i dhambi zemëra... u mejtua për Shqipërinë, për ndjekjet, për errësirën dhe u hëlmua shumë... dhe e pushtuan dy rrjedhje mejtime. Mejtimi i kombësisë me zë të fortë dhe pa frikë e urdhëronte: «E ke për detyrë, mos vështro asgjë, as nënë, as motër, as martesë... bëje veten kurban për mua». Mejtimi i nënës fliste me zë të unjtër, me lutje dhe, me lot ndër sy, i thesh: «Kombësinë e ke për detyrë... Puno për atë idhe, po mos më lerë dhe mua... se ja nëna do të mbetet vetëm pa përkrahje, dhe në duart e urisë... motra do të mbetet pa strehë... e pamtuar dhe kush e di se ku e shtyn nevoja».

Nuk dinte nga të shkonte, nuk dinte cilin zë të ndëgjonte? zërin e kombësisë apo të shtëpisë; i cili i lutej kaq shumë dhe ja kujtonte pësimet dhe vojtjet që do të hiqnin njerëzit më të dashur?

Pa mos mundur t'a zgjidhë këtë enigmë u çvesh. shoi llambën dhe u shtri në shtresën e butë. Desh t'i dbonte mejtimet që e mundonin. Po më kot se ato, tashti më të errët, më shumë dhe më shpesh e mundonin. Përpara tij, kur kish sytë e mbyllura, qëndronin shokët të armatosur dhe e prisnin të dilte. Pastaj i dukej sikur shkuan në mal dhe sikur i vërshenin plumbat. I dukej sikur u ndeshnë me ushtërinë. Gjaku u derth si lumë... nga të dy anët u vranë shumë. Pastaj, mbetnë pa bukë të rrethuar në një mal. Pastaj pa t'ëmën të ligur, të munduar dhe të sëmurë nga nevoja e madhe dhe nga uria. Pa të motrën të ligur, që kish rënë

më gjumë pranë s'ëmës, kish ngritur duart në qiell dhe i lutej Zotit t'u dërgonte ndihmë.

Bëri me dorë, përpara syve, që t'i dbonte këto pik-tura; desh t'i largonte këto mejtime dhe niste të vër-shëllente ose të këndonte nonjë këngë. Më kot, sepse pik-turat e liga, me pamje të tmerrëshme, nuk e linin rehat asnjë sekundë. Çdo minutë ose shihte vetëm të vrarë, ose miqtë që e prisnin, ose t'ëmë që qante... Iu larguan këto mejtime dhe i hynë të tjera, që nuk ishin të zeza strerrë, po të bardha si dëbora, si penda e patës. Tashi i dukej sikur, i veshur me rrobat e malit, doli te vendi ku e prisnin shokët dhe së bashku shkuan maleve.... U përpoqnë me ushtërinë, lëftuan dhe i mundnë. Pastaj një ndeshje tjetër, në të cilën ky dëf-teu trimëri të madhe, bëri yrysh dhe i thyen turqët. Pastaj, iu duk sikur bënë paqe. Ky ish bërë kapedan, kish marrë nishane dhe shumë ndere. E pa Shqipë-rinë të liruar. E pa veten të nderuar... Pastaj e pa sikur u kthye në Korçë me një shumicë. Ky ish përpara. Tërë bota e dëftenin me gisht... Të gjithëve u falesh me një mburësi.... Pastaj e pa veten nëpunës të madh të Shqipërisë, e pa t'ëmën të gëzuar dhe të lumtëru-ar. Pastaj, si do të kërkonte atë, të cilën nuk kuxon-te ta marrë se e ndanin paratë e shkreta. Do t'ja ip-nin me gaz të madh. Ja, tashi, po shihte shtëpinë e madhe ku do të rronte. Gruan e bukur. Dhe nisi të ndëgjonte zërin e saj të ëmbël dhe melodik.

Këto mejtime e dehnë. I kish dhënë fund të shkojë kryengritës, e hodhi jorganin mi kokë dhe u kthye nga ana tjetër, duke thënë me vete: «Po të fle tashi pa». Po, ç'fatkeqësi, me të kthyer, i rrëzovi mejtimet e bardha, se vëndin e tyre e zunë të zezat.

Herë i munduar nga mejtimet e zeza, herë i gë-zuar nga mejtimet e bardha, mezi, ndaj të gdhirë, e zuri gjumi, që ja largoi mejtimet.

Përgjithë botën ditët shkonin, mirëpo Pilos i dukeshin muaj. Mejtmet asnjë sekundë nuk e linin të qetë. Më në fund kur u gëdhi e premte i kish dhënë fund të mos vejë kryengritës se jo vetëm mund të mos e bënte dot, po dhe se nuk kish se ku ta linte t'ëmën dhe të motrën.

Ora kish vajtur 12 alla turka. Më një ish ora e pjekjes, prapa Shën-Thanasit. Pasi u tha të shtëpisë: «Tashi do të kthehem», pa ngrënë darkë, mori udhën nga Shën-Thanasi.

Dherin e kish pushtuar një errësirë e fortë. Qielli ish i kthjellët me gjithëse nuk kish hënë, dhe yjtë ndritnin pak që nga lartësia e tyre. Si nonjë qilim i math dukeshin vreshtat me fletët e tyre të dëndura. Pamje të bukur kishin malet që ishin pak larg, ku të veshur, ku të çveshur dhe dukeshin posi fortesa të kohës së vjetër. Një qetësi e madhe mbretëronte, të cilën e prishte cicirimi i shpeshëve që nga koria e largme, rrjedhja e ujit të mullirit që vinte që nga një vënt i lartë... Nuk frynte as nonjë erë. Si dukej asgjë nuk desh t'ja çqetësonte gjumin dherit. Në këtë hapësirë ndëgjoheshin çapet e ngadalëta të Pilos. Ay po shkonte duke u mejtuar. Nisi ta fajtonte veten që nuk u bë gati se tashi desh të vinte. Në zgjatjen e pesë ditëve, sadoqë dhe më parë ish i dobët nga trupi, u lig fare se as hante dhe as flinte.

Po shkonte bregut, mejtohej dhe shikonte tutje. Dukej karakollana, ¹⁾ përpara së cilës me pushkën në sup, me çapa të përtimëshme, një ushtar po bënte marshrutin. ²⁾ Piloja u droth dhe shkoi më mengadalë. E këmbëu udhën. Ushtari, pasi bëri dhe ca marshrute u sheshua mi sofatin që ish pranë derës dhe e zuri gjumi. Zuri të gërendej. Piloja po ngjitej.

1) karakollanë-a = vëndi ku rri roja.

2) marshruti = vajtje ardhje.

Kur u unj nga ana tjetër e bregut pa çesa trima të armatosur. Në mes të tyre ishin dhe shokët e tij. Që të gjithë gati për të ikur. Piloja u drothi iu këmbye ngjyra e fytyrës, dridhej dhe u afrua më pranë. Miqtë, kur e panë, që për së largu i thirrën: «Ç'u bëre se ty po të presëm». Kur u afrua dhe e panë të paarmatosur ja thirrë të qeshurit dhe i thanë me ironi:

— Oj, paska frikë Piloja!

Kjo fjalë ja humbi dhe atë çikë të kuq që i kish mbetur në fytyrë. Zuri të shikonte njërin mik pas tjetrit duke dashur të shohë në fytyrat e tyre ç'ndjenin. Dësh që të kish nonjë t'i ipte të drejtë. Vështrimi i tyre ish i mbushur me kuxim se nuk mejtonin asgjë tjetër përveç të mbaronin idealin e tyre. Piloja gjithë i vështronte dhe s'munte t'u fliste as gjysmë fjalë. Dukej si skelet. Këtë gjë e vuri re Raqi, që e desh më shumë nga shokët e tjerë. Dësh t'i ipte të drejtë, po kur pa Hysenin, që nuk ish më i shëndoshë, heshti dhe zuri t'i barabiste miqtë. Pa dashur, në trutë e Raqit, u fanit shtëpia e Pilos, me plakën e kërrusur dhe me të motrën, që ushqeheshin nga puna e djalit. Pastaj iu kujtua shtëpia e Hysenit, që ish në rafshëri nga të gjitha të mirat, me të vëllezërit më të mëdhenj, me t'anë e shëndoshë. Nga këto mejtime, prapë pa dashur, mori anën e Pilos. Dhe duke e parë shokët, tha:

— Mirë bëri që nuk ardhi Piloja. Nuk e shinni more ay me këtë udhë dhe u bë si i vdekur! Nuk ka fuqi, ja po gulçon sa ngjiti këtë të përperjetë. Po kur të ngjijnjë male të lartëra.

Miqtë nuk folë dhe as që e kuptonin që Piloja ish i dobët. Në këtë kohë secili prej syresh mejtonte malin, goditjet dhe luftërat.

Piloja e mori veten dhe u tha:

— Të dashur miq! Sa për ndjenjën që e kam si shqiptar, nuk besoj të dyshoni? Nuk mund të bashkohem me ju. e mejtovë shumë, po nuk do mund të mos

u sjell asnonjë dobi... — Në këtë hop në trutë e tij i qëndroi fjala «nuk je trim». Përnjëherej i lojti zemra, bëri një çap përpara, ish gati ta hapte gojën ohe t'u thesh që ish gati të shkojë. Përnjëherej iu ndëgjua një zë tjetër. «Po shtëpinë kujt do t'ja lesh» dhe e mblodhi veten. E mbylli gojën. Pa miqtë që po bëheshin gati për udhë dhe që ishin të mbushur plot me mejtimin e kombësisë, duke mos u lënë vent, në zemrat e tyre, në mejtimeve të tjera.

— Më ndjeni, udha e mbarë ju qoftë... Dhëntë Zoti e mbarofshi qëllimin.

— Dhëntë Zoti e mbarofshim, se dhe ti duhet të mos harrosh sa të thamë... — i tha Raqi, që foli çesa kohë me të dhe e porositi për shumë gjëra. — Njerinë nga java do ta dërgojmë. Me letra do të t'i shkruajmë ç'të na duhet.

— Besoj se do t'ju jem i nevojshëm. Detyrën do ta mbaroj, — u tha Piloja.

U folë dhe shumë në mes të miqve. Yjtë çapitnin në qiell. Hëna, që dukej si drapër, e dëftuë njerin bri që nga majërat e malit. Piloja, i pikëlluar që nuk mundi të vejë në mal dhe i lehtësuar që mori një barrë përsipër, u kthye në shtëpi. Ora ish më shumë se tre i natës. E ëma nuk flinte, gjith përgjonte. Sofra ish shtruar. E motra kish rënë pa ngrënë bukë. Kur ja hapti derën, e ëma e priti me një qërtim në të cilën çqumeshe kujdesje:

— Ku ishe gjer tashi, o bir! Po të presëm të hamë bukë.

Këto fjalë i kujtuan mejtimet e para. Tashi më nuk e fajtonte veten që nuk shkoi se ay e kuptoi që me atë gjë do ta vriste t'ëmën dhe të motrën.

Kokëunjur i shkoi përpara s'ëmës dhe, duke u drejtuar në dhomën e tij, i tha:

— Njëqind herë të kam thënë, po të mos vij gjer më një sahati, të hani bukë.

Kishin shkuar disa javë. Shumë herë kryengritësit ishin përpjekur me ushtërinë. Në këtë kohë në Korçë ish mbledhur një ushtëri e madhe dhe kishin ndër mënt t'i shuanin kryengritësit. Policia po kërkonte më të katër anët dhe i futte haps ata që u shpinin bukë, opinga e fishekë. Piloja kish frikë se mos e zinin, po kurrë në trutë e tij nuk i hyri mejtimi ta linte punën që kish zënë. Ngaherë bashkë me ca të tjerë, mblithnin para dhe dërgonin në mal ç'kishin nevojë kryengritësit.

Shokët e Pilos, në mal, e kuptuan që ay zgjodhi rolin më të math. Ay ish në duart e qeverisë dhe do të mundnin ta zinin kur ata ishin në mal. Ngaherë, kur rrinin rreth zjarrit, që e ndiznin në mal në netë e ftohta, në bisedimet, e kujtonin Pilon dhe theshnin shumë shpesh:

— Shiko more, Piloja po na bën shërbime të mëdha.

Punërat e kryengritjes nuk kishin vajtur dhe aqë mbarë se krerët po hanin kokën njëri me tjetrin. Po shpresa ish që ta ndreqnin.

Në Korçë u përhap lajmi se ushtëria të mërkurë do t'u binte kryengritësve. Këtë gjë me siguri e mësoi Piloja nga një kolonel që e kish mik, i cili blinte plaçka n'atë dyqan ku ay ish shërbëtor. Komitat, e dinte që ishin dy sahat lart Korçës, dhe spiunët ja kishin thënë qeverisë. Pilos nuk i rrihej më një vënt. E dinte që ata do të humbisnin që të gjithë, po të mos i lajmëronte. Nuk kish as nonjë njeri të besuar me të cillin t'i lajmëronte. Njeriu i tyre nuk kish asnjë ditë që kish ardhur dhe kish ikur prap. Lajmet i mësoi më pastaj. Të priste ngjer të kthehej, ish tepër vonë. Koha nuk priste. I mejtoi tashi këto që të gjitha. Bëri sikur t'i mirrte përsipër zëri i familjes, po nuk gjeti dot vënt. Tashi, nuk kish frikë dhe e quante më të madhen detyrë t'i lajmëronte.

Mori udhën dhe shkoi fshehtazi, mbrëmave, kur dherin e kish mbuluar errësira dhe qiellin retë e dendura dhe të zeza. Me shumë mundime e gjeti shtëpinë e kapedanit. Përnjëherej u muarën vesh si ta bënë planin. Po ushtëria e kish shpejtuar punën dhe u gjetnë të rrethuar. Piloja e mori martinin dhe lëftonte si trim. Në mëngjes ushtarët u shumuan. Komitat bënë yrysh dhe i çanë natën. Piloja i plagosur në këmbë mbeti në fshat. Ushtarët e gjetnë. E shpunë në Korçë ku, pasi e shëruan e gjykuan. E pyetnë për shokët, e rrahnë, e munduan, po ay nuk rrëfeu asnjëri dhe i duroi që të gjitha.

* * *

Kishin shkuar shumë muaj. Piloja po kalbej në hapsanë. Nganonjëherë i vinin ca të njohur ta shihnin. Shumë shpesh koloneli me të tallur i thësh:

— Po dhe ti ishnje nga ata, kurrë nuk e besonja.

Një ditë u hap lajmi se kryengritësit bënë paqe me qeverinë. Fituan shumë të drejta dhe amnisti të plotë. Piloja dolli nga hapsana.

Odesë, 1912

MARKO MJERI

Të zbrazurit e pushkëve më s'dëgjohej. Era zuri të frynte e qetë dhe e çpërndau renë e barutit që ish në përëndim.

Marko Mjeri rrinte prapa gurit dhe, me të drojtur, shumë shpesh e nxirrte kokën që të shihte, se kish frikë të dilte nga prita.

Kur nisi dyfegu, Markua ish vetë i pesëmbëdhjetë. Kur u përpoqnë me armikun që ish një shumicë e madhe, iu përhapnë shokët dhe iu përndanë. Mbeti vetëm dhe zbraste pareshtur që prapë gurëve, ku kishin zënë vend.

Dielli po afrohej në perëndim. Gjer në këtë kohë, e kish nxjerrë shumë herë gunën. Asgjë s'i përgjigjei. Hapësira kish rënë në heshtje; qetësia mbretëronte më çdo anë dhe s'kish as shpendë, as kafshë.

Duke ndënjur kështu, e ngriti kokën e tha me vete: «Do të kenë shkuar», dhe mengadalë mori udhën. Diellin pak nga pak e zaptoi ana tjetër e dheut dhe e pushtoi në krahët e tij.

Errësira ra më të katër anët... Yjtë, që ishin radhitur në një përegullim, ndritnin qiellin, i ipnin malit një pamje të bukur dhe i tregonin udhën Markos. E ay pasi bëri njëqind çape qëndroi, nëmëroi fishekët dhe, pas yjve, e mori udhën.

Ora shkonte. Yjtë çapitnin dhe i ndronin viset e Markua; pasi eci mjaft kohë, ndjeu të lodhur; u shtri, u zgjat, krisi këmbët e duart, prapë u zgjat dhe nga goja, duke psherëtitur, i duallë këto fjalë: «U lodha shumë... tërë ditën s'kam ngrënë asnjë thërrime bukë». Nxori trajsen, në të cilën i kishin mbetur ca kothere dhe një copë djathë. I hëngri. Ky ushqim s'i zuri as dhëmbët... dhe mori udhën. I ngriti sytë në qiell; pa yjtë dhe murmurisi: «Udhën e kam mbarë, po nuk e di sa larg jam. Kush djalli e di? atje mund të ketë rojtës? Dhe, duke u mejtuar mori udhën që i binte më të tatëpjetë.. kish gurë... gryka... Këmbët e tij nuk ndjenin të lodhur. Markua largohej dhe largohej... Uria e mundonte, po dhe etja nuk e linte të qetë. Pa më të katër anët, vuri veshin të ndëgjonte «a mos rrjeth ujë», po më kot, se vetëm një erë frynte, që ja prishte qetësinë malit.

Pa bukë, pa ujë, i pafjetur, i hodhi sytë larg-larg... Asgjë nuk dukej... Mori udhën... shkoi... mi veshin e tij qëndroi kënga e këndezeit. I qeshi buza se, atje ku mbarohej e zbritura e malit, pa një kullë. Me dyfekun në dorë, iu afrua dhe zuri pritë. S'dëgjohej asgjë. S'dinte ç'të bënte, të shkonte drejt, kish frikë mos ishin askerët¹⁾, e të mos shkonte e mundonte uria. Këndezi kish

1) askerët = ushtarët.

kënduar disa herë, po nuk ja priti as ndonjë tjetër. Nga kjo e kuptoi se katundi ndodhej shumë larg. Uria mori sipër; zbrazi dy tri herë, priti pak, u drejtua te kulla dhe i pa muret e saj te rrëzuar në shumë vise. Kjo pamje ja pikëlloi zemrën se muret nuk i kish prishur koha, po gjylet e atyre që u bënë shkaku i prishjes dhe i urisë. Kulla i solli ndër mënt fshatin e tij, gruan, djemtë e vegjël, të motrat dhe nënën plakë... I kish lënë vetëm në fshat. Kish një muaj që kish dalë nga shtëpia dhe nuk e dinte në ishin gjallë apo vdekur. Përpara kullës i harroi të gjitha: urinë, etjen, lodhjen, gjumin se fantazia e kish shpënë në fshatin e vetë, ku i shihte të shtëpisë të mbledhur tok me dyer mbyllur dhe të verdhur nga uria. Që të gjithë i kishin fytyrat si prej të vdekurish dhe nga sytë e tyre dilte një shkëndi e venitur, ku çquhej frika; e mi faqet u dukej një cipëzë e hollë, që ishin lotët e tharë.

I dboi fantazitë dhe u drejtua në kullë. Dyert ishin të hapura. Me të hyrë brenda, u droth e u tmerrua, se në dhomë ishin shtrirë pa shpirt dy gra, që dukej se ishin munduar shumë para se të vdisnin. Ca më tutje ish shtrirë, pa shpirt, një plak, të cilit i kishin prerë këmbët dhe duart dhe nuk e kish njerin sy, të cilin do t'ja kishin nxjerrë me goditjen e kamës. Ca më tutje ishin ca çiliminj të çarë për mezi. Në funt të kullës ish një nuse e re, me barkun e çarë, që ku i kishin nxjerrë një foshnjë të vdekur dhe të copëtuar. Sytë e nuses kishin mbetur të hapur dhe në to çquhej mundimi dhe lufta e madhe që kish bërë me egërsirat.

Markua u droth... s'duronte dot t'i shihte mizoritë e turqve. Duke u larguar nga vendi i tmerrit, i ra dyfeku nga dora dhe, duke nxjerrë psherëtima, tha: «Egërsira dhe nuk bën kaqë shumë». E zuri kokën me duar, u shtrua mi një gur dhe ra në mejtime: «Vallë kush do t'i ketë bërë gjithë këto?». Dhe pa vonim i tha një zë: «Po kush përveç turqve»? Ky zë i futi tmerrë të mëdha. Shtrëngoi grushtet, mori dyfekun dhe mori udhën, se kish harruar përse kish dalë maleve. Trutë e

tia ja kishin pushtuar këto pyetje: «Po të ketë hyrë në fshat askeri, vallë ç'do t'u bëjnë fëmijëve? Pa dyshim, do t'i bëjnë copra-copra...» Me shpejtim mori udhën.

* * *

Kishte shkuar shumë kohë. Yjtë e kishin humbur dritën. Dherin e kish pushtuar një erë e hollë. Agimi i dëfteu sytë. Tani Markua desh të vinte ca më shpejt në fshatin e tij... desh t'i mpronte fëmijën nga vdekja; shtiri sytë dhe tha: «Andej, andej duhet të jetë fshati im».

I munduar nga mejtimet e shuma pranë veshit i vërshtëlleu një plumb. Hodhi syrin dhe pa dhjetë aske-rië. Në këtë sekundë e harroi shtëpinë... U shtri për-dhe. S'kish arrirë të zinte vend, kur një batere plum-bash i vërshtëlleu mi krye dhe nisi lufta. E kishin rre-thuar liksh. Markua kish zbrazur shumë dhe i kishin mbetur vetëm pesë fyshekë. Dielli kish shkuar disa ostena e askeri as ndër ment nuk kish të hiqesh. Mar-kon e pushtuan mejtimet, i pa pikurat e zeza, i lojti zemra, u pikëllua dhe zbrazti atje ku pa që dolli tym. Prapë shkonte. Përsëri e pushtuan mejtimet dhe zëri «çdo të ngjasë me fëmijën, po të hyjë askeri në fshat» e shtyri të bëjë yryshin duke thirrur:

— E, dilni bre qena, dilni të vritemi si burra.

Ushtarët u ngritnë më këmbë dhe filloi lufta. Plu-mbat i vinin përmi kokë... bamb-bumbi ndëgjohej pa-reshtur... Markua largohej e largohej duke zbrazur... Po na, një plumb e goditi mu në krahëruar... U plagos rëndë... U zvaros..., mori dyfekun në dorë, e zbrazti dhe një herë. Plaga zuri të ftohej... i ra dyfeku nga dora dhe u shtri i vdekur përdhe. Askeri iu afrua e pa të vdekur, i muar mauzerin dhe e çdukën.

VDEKJA E MARËS

Në Korçë, e cila është rrethuar me male që duken posi fortesa, në një shtëpi të unjtër, në odën e parë,

nga ana e djathtë, ish shtrirë një grua e thyer. Gruan e quanin Marë dhe ish shumë e ligur.

Kjo grua kish disa vjet që mundohej nga sëmundja: kur më këmbë kur në robat. Më në fund, sëmundja e shtiu poshtë dhe tani kish një muaj të tërë që s'luante nga shtrati.

Rreth saj, shumë shpesh, s'kish asnjeri. I shoqi i kish vdekur në kurbet; të dy djemtë, që kishin marrë kurbetin, nuk dihej ku gjendeshin; e nga të tri çupat i mbeti vetëm e vogla: e madhja i kish vdekur, dyta ish martuar në Vllahi dhe e treta në Korçë. Më parë s'ish kaqë vetëm; ajo rronte tok me të kunatat, me fëmijën... Po ahorej ish e shëndoshë dhe as që e sillte ndër ment se do të vijë një ditë që të jetë shtrirë dhe të mos ketë kush t'i apë një pikë ujë.

Vetëm e bija e saj, Tasoja, ish pranë saj, pasi mbaronte punët e shtëpisë. Kështu shkoi muaji i parë që ish shtrirë; e sëmura s'kish të kthente për mbarë, kolla gjithë e mundonte, etja dhe dëshira për gjellëra të ndaluara prej shëronjësit¹⁾, dita me ditën i shtoheshin.

Një ditë, kur e bija i ish pranë, Mara i ngriti sytë, e pa të bijën, u mundua të ngrihej dhe, me fjalë që mezi i dilnin nga goja, i tha:

— Bijë!... dëgjomë... dua të të pyes... ç'thotë shëronjësi?.., a do të shërohem?

Së bijës s'iu mbajtnë dot lotët. U kthye nga ana tjetër, i fshiu sytë dhe i tha:

— Shpejt do të shërohesh, moj nëna ime e dashur. Pas një jave kemi triarhondët dhe do të vemë bashkë në kishë.

Një shkëndi gazi ndriti nga sytë e Marës dhe i tha së bijës:

— Do të ish mirë të shërohesha... po... dhe e mbylli gojën se, në sytë e saj që dukeshin si të shuar, ndritnë pikat e lotëve.

E bija e qëtoi dhe i tha:

— A, dhe ti mos nëno! Ty mendja gjithë në të

1) Shëronjësi = mjeku.

liga të vete. Ja dhe Stefanësja, ish më keq se ti e sëmurë, po u shërua.

— Vërtet, — i tha Mara së bijës — Mjerisht nuk shërohen të gjithë...,

Në këtë kohë hyri shëronjësi, u përshëndosh, xhveshi pallton dhe e pa të sëmurën, pastaj shkrovi reçetë, mori pagën dhe, duke thënë «natën e mirë», shkoi. Tasua u ngrit ta përcillte dhe, kur duallë te pragu i portës, i tha:

— Zoti shëronjës, ju lutem të më thoni, a ka rrezik nëna ime?

Shëronjësi, pasi u mejtua pak, i tha:

— Zonjë, nëna juaj është e sëmurë rëndë... Duhet t'ju them...

— Si, s'ka shpresë? — përnjëherej i dolli nga goja Tasos.

Shëronjësi ja preu fjalën dhe i tha:

— Duroni pak; dua t'ju them atë që kam kuptuar me anën e shkencës...

— Zoti shëronjës, thujmëni, ju lutem, më shkurtër. S'kam durim. Po vdes.

— Më ndjeni, zonjë! — i tha shëronjësi. — Këtu s'ka ç'tju them më shumë fjalë. Për nënën tuaj mund të ketë shpresë, po, mjerisht, nëna juaj është e sëmurë rëndë dhe ka sëmundje të ligë.

— Sëmundje të ligë! — thirrë e bija e të sëmurës dhe nisi të ulërinte: Obobo unë e zeza, unë korba, qyqja unë, murga unë, nëna më ka sëmundje të ligëto». Dhe pushtoi faqet, kryqëzoi duart dhe shkuli leshrat.

Shëronjësi e qëndroi dhe i tha:

— Me të thirrura dhe me të qara s'bëhet asgjë. Kini durim dhe dëgjomëni:

— Do të më thoni që do të vdesë, — briti Tasoja.

— Jo, zonjë! Vdekjen që të gjithë e kemi për detyrë, po, ju lutem, nemni radhë t'ju flas. Dua t'ju them se nëna juaj është e sëmurë prej oftike dhe duhet të ruhi.

— Dhe këtë s'e prisnja... Fytyra iu verth dhe, kur

shëronjësi shkoi, pasi u qetua pak, u kthye te e së-
mura.

* * *

E sëmura ish squar. Kolla e mundonte e Tasoja i rrinte pranë dhe e shikonte në sy. Kur s'e ngiste më kolla, kërkoi ujë. Tasoja i dha kupën me qumësht: e sëmura piu vetëm disa gllënqka. Kur edhe s'e kish lënë kupën me qumësht, e zuri një kollë e fortë dhe nga goja i teptisi gjaku. E bija s'e humbi, e mbajti dhe, pasi i ndreqi jastëket, e pyeti:

— A je më mirë, nëno!

Koha shkonte. E sëmura u bë si dyllë, mirrte firo-
me me pahir dhe s'fliste fare.

Pas ca kohe i hapi sytë, pa rreth e rrotull, i ho-
dhi sytë nga konizma, ku ish kandili i ndezur. hapi
gojën, se desh të fliste, po s'nxori dot asnjë fjalë.

Kështu shkoi dhe mjaft kohë. Llamba ish ndezur
qëkur dhe shëronjësi, te i cili kishin dërguar djalin e
fqinjës, s'kish të vinte.

Më në fund e hapi gojën dhe, me fjalë të këpu-
tura, tha:

— Bijë... ku janë të gjithë... të sojit tënë?... Ku
është yt shoq? Ku janë niprit... mbesat?... Thua: më...
ku janë se mua po më afrohet vdekja.. Po ti... — vazh-
doi e sëmura — moj bija ime... pse s'më thua... pse
s'më vështron në sy?... Pse s'vijne të më shohën... E
kuptova... E di... se kam sëmundje të ligë... kanë frikë...
mirë bëjnë...

Pasi heshti pak kohë tha:

— Po ti, moj bija ime... për mua... le burën... fë-
mijën... s'më le vetëm... Patsh uratën time c të Perën-
disë... Ja... moj bija ime... ruaju... Kij kujdes fëmijën...
Duaje burrin... tërë njerëzinë...

Tasoja pas çdo fjale i thesh s'ëmës:

— Mos folë kështu, moj nëno; të shpejt do të shëro-
hesh..

E sëmura ngriti sytë dhe pa më të katër anët e
odës. Më në fund ra në mejtime, pastaj pa të bijën, ha-
pi gojën dhe me zë të unjtër tha:

— Ti më mbete e vetëm... Thina vdiq... Marga është në Vllahi dhe s'di asgjë... s'e di që unë po vdes... Po Mitri me Rabin?., — S'mundi të vazhdonte dot, se sytë iu mbushnë me lot. Kujtimet për djemt e humbur ua lënduan zemrat grave. E sëmura, pas ca kohe, vazhdoi:

— Vallë ku do të jenë?... A do ta mësojnë që po vdes me ta në gojë... O zot, ruaji bijt e mij... shpëtoji... ruaji dhe bëji të mbarë...

Syri pa dashur i vajtj te kandili, që n'atë hop nisi të kërciste se iu mbarua vaji. Të sëmures i qeshi buza dhe i tha së bijës:

— A e sheh se si po kërcet kandili? Ay kërcet se s'ka vaj dhe shpejt do të shuhet. Ashtu dhe jeta ime do të këputet, se m'u mbarua vaji i gjallimit.

Kështu shkoi dhe ca kohë... kandili gjithë kërciste se asnjeri s'i shtinte vaj, dhe e sëmura gjithë kollitej se asnjeri s'i hithte gjallërim.

Po, na, kandili pushoi së krisuri, u shua dhe nga fitili dolli tymi, që e mbushi odën me kujtimin e fundit. Në këtë kohë, e sëmura u koll çesa herë, pa më te katër anët, e pa të bijën, u zgjat dhe u shtri mi shtresën; e hapi gojën, i vagulloi sytë e nga krahërori, i doli, bashkë me shpirtin, dhe psherëtima e fundit.

PLAKU I MOTSHËM

Ish dimër. Tomori i shenjtë zbarthte nga dëborat. Drurët dukeshin si të mbuluara me jaka. Era frynte si e marrë. Nëpër monopetet, ngadalë, shkante një karvan me mushka. Unë, i çkëputur nga ushtëria e thyer, kërkonja strehë. Tingëllimi i zileve, që lëshonte oshëtime, ndëgjohej me një zë i fshehtë. Po shkonja, bashkë me karvanxhinë, duke folur e duke kërkuar nonjë vend të ngrohtë.

— S'e kemi mirë udhën. Na humpnë gjurmat. Vetëm instinkti i mushkave do të na nxjerrë në rrugën që duhet. Ngjer më sot edhe s'kam parë të tillë dimër, — më tha karvanxhiu. E unë në sytë e tij këndova frikën që e kish pushtuar. Të ftohtët sa vinte po shtohet.

Mua më mundonte dhe uria. E karvanxhiu vazhdoi: — Këtu afër duhet të jetë një kasolle... Ja, e sheh, atje nga herë është i ndezur një kandil, po sot sepse s'duket dritë...

Shkuam me tahmin ¹⁾ dhe shumë kohë duke e ndjekur mushkat. Isha si i lenë dhe i hapnja këmbët si automat. Zëri i karvanxhiut më shkundi nga mejtimet e rënda dhe të shumëta që më kishin pushtuar. Fjala e tij u përpoq në mal dhe oshëtima u kthye si më e fortë..

— Ja, a e sheh?

Që tutje ndriti një kandil si i venitur. Muarrmë udhën nga drita. Rreze malit ish një kasolle: Trokitmë dhe hymë brënda. Ish vetëm një odë. Muret, trualli dhe dy vrimat, që ishin si penxhere, ishin të shtruara me lëkurë egërsirash. Vatra ish plot me prush. Te dera na priti një plak i zbardhur si pata, i hollë si plepi dhe i rrudhur si nonjë këmishë e larë, po e pahekurosur. E vura ré me kujdes: desha të kuptoj: vallë sa vjeç do ish. Në fytyrën e tij s'i kish mbetur as nonjë nga shenjat e njerëzve që rrojnë. Me të na parë, u kthye në odë, na dëfteu viset pranë vatrës, ndenji dhe na tha:

— Ngrohi! Dru kemi sa të duash. Nga buka jemi si ngushtë po. atë që kemi, me njerëzit e mirë do ta ndajmë.

Iu falmë nderit. U ngopmë dhe u ngrohëm. Koha jashtë s'kish të ndreqej. Mushkat, vajti karvanxhiu t'i vendoste në katua e unë iu lutshë plakut të më rrëfejë nonjë gjë nga jeta e tij. Dhe ay nisi:

— Do të ta mbaroj lutjen tënde. Mos të mbetet hatri. E shoh, nga sa folmë, se je shqiptar i mirë. Unë i kam parë që të gjitha punët siç rrodhë në Shqipëri. E kam njohur dhe Skënderbenë. I kam vajtur vetë në Jemen dhe ja kujtova detyrat të birit të Gjon Kastriotit. Në atë kohë, ay ish dhënë i tëri pas luftërave dhe pas famës. E kish harruar Krugën e bukur, gëzimet e foshnjërisë, përkëdheljet e s'ëmës, traditat e gjyshëve

1) me tahmin = me mënd, me hamendje.

dhe s'e dinte që atdheu i ish robëruar... Nderimet që e rrethonin, bashkë me bukuritë dhe me qefet, që i kish n'atë vend me çdo çast që të desh, ja kishin humbur kujtimet dhe mallin për Shqipërinë. Ja kujtova që të gjitha. Iu droth zemra... I solli ndër mënd. Ja dhashë mandatën për tanë, i thashë për të vëllezërit që ja kishin vrarë sulltani dhe i tregova që e ëma, bashkë me të motrat, muarr arratinë... U ndez.. Zemërimi e pushtoi përnjëherej. Sa i bukur dhe madhështor që është në atë minutë! S'u mejtua aspak. E shkundi pluhurin e Anadollit nga këpucët e tij dhe, bashkë me mua, u kthye në Shqipëri.

Lëftoi si dragua... E shoi armikun dhe e vuri në vend nderin e Vatrës së tij dhe të Shqipërisë. Kam qënë kurdoherë bashkë me të. E vinja re si parësia zihej në mes të saj dhe si, për ambicie personale, i solli shumë dëm Skënderbeut dhe përparimit shqiptar. I mbaj mënd që të gjitha tradhëtitë dhe tradhëtorët... Po, ay kurdoherë, doli faqebardhë. Skënderbeu ka patur më shumë armiq se sa miq nga parësia... Po, jam që nga ajo kohë dhe e kam shëtitur Shqipërinë anëmbanë. E kam mbjellë farën e dashurisë sonë dhe jam përpjekur për shpëtimin e racës së madhe që të mos shuhet... Kemi mbetur pak?...

Po, se parësia është kurdoherë pas interesit personal dhe kurrë s'ka dashur ta bëjë veten kurban për atdheun... Populli? I shkreti popull, ay kurdoherë ka qënë gati ta ndjekë parësinë!.. E di... mos ma thuaj... Mos m'i kujto... ata, për në, kurdoherë do të mbeten të huaj. Jo, s'janë shqiptarë se ata kanë punuar për dëmin e Shqipërisë dhe për fitimin e armiqve të atdheut... Kanë qënë ca që e kanë dashur vendin e tyre... janë munduar t'i mbarojnë poristë e mia po, të tradhëtuar, ca janë vrarë dhe ca po kalben nëpër hapsanet. Mos m'a prej fjalën. Unë e kam parë diellin më parë nga ti dhe e njoh botën më mirë: Duhet ta dish se bota e madhe kurrë s'ka patur interes për të na ndihur; qëllimi i saj është t'i mjetë dhe përdorë popujt e vegjël. Dije, pra, o biri im, se Shqipërinë, si dhe çdo popull të vogël, e ka ma-

rrë më qafë parësia. Ja, nga ky shkak dhe populli ynë ka mbetur pas... I vetëm ish ay që e ka dashur popullin tonë... Ay ish Skenderbeu.

Kur ish i sëmurë dhe e pa që s'kish më shpresë të rronte, s'i zuri besë as njeriu prej të parësisë, që t'ja linte amanet flamurin dhe nuk gjeti as ndonjë të zotin t'i zinte këmbën. Aherej më thirri dhe, sy-ndër-sy, më tha:

— A e sheh atë flamurin që po valon atje mi kalanë e qytetit... Unë, nesër pas nesër, do të vdes, po ti unje vetë që të mos bjerë në duart e turqve... Mbage me kujdes... prit... kij durim... dhe gjuaje rastin që ta ngresh përsëri... Kur vdiq Skënderbeu, unë e unja flamurin... E mbarova porosinë e tij... e parësia, kur trupi i tij édhe s'ish futur në dhé, kish marrë udhën për në Stamboll, ku u bë shërbëtore e sulltanëve... Djalin e tij e përcolla përtej detit... Që nga ajo ditë e gjer më sot kam bredhur nëpër tërë Shqipërinë: kam pritur rastin që ta ngrë përsëri flamurin e bekuar dhe çdo ngjarjeje ja kam vënë veshin me kujdes. Ora e mirë s'kish të vinte. Kishin shkuar disa qindra vjet që po jetonja mbi dhé. Kam parë shumë luftëra... E pashë dhe luftën e Ballkanit. Në atë kohë instinkti im më thesh se roli im po afrohet. Ngjer më atë ditë pandehnja se do të vdisnja pa e mbaruar porosinë e Skënderbeut. Shëtijnja, si i marrë, nëpër malet, ku nuk ish vënë vala e robërisë dhe më gëzohej zemra. Një ditë, kur isha i mërziur, zbrita te çipi i detit. I vura re valët e tërbuara, qiellin e mvrëjtur dhe horizontin që bashkohej me detin. Pa dashur m'u kujtuan ato gjemitë me të cilat e përcolla të birin e Skënderbeut për në viset e huaja. Atë djalë e prita shumë kohë, po më kot, se ay s'u kthye ta mirrte trashëgimin e t'et. Në këtë kohë, në çip, plasi një valë dhe një zë plot me melodi më tha:

— Mos u bëj merak; mos u dëshpëro se ky uji i bekuar, te i cili raca e madhe e ilirëve, e gjyshëve të kombit tënd, e shtroi gunën, do t'ju shpëtojë nga çdo robëri.

Fjala e valës më vuri në mejtime dhe ma shtoj shpresën... Ushtëritë e ballkanasve po hynin në Shqipëri. Në këtë kohë nuk dinja ku të fshihesha dhe mora udhën për në Tomor. U ngjithshë në majën më të lartër; rashë mbë gjunjë dhe iu lutshë qiellit dhe yjve. Në lutjet e mia m'u dëftyen tri fatia ¹⁾, që ishin si të bukurat e dheut.

E para më tha:

— Sot është dita për punën tënde. Shko... merr udhën për në Vlorë... Atje po të presin dhe ngrije flamurin, mbaroje porosinë e Skënderbeut.

E dyta më tha:

— Thuaji parësisë të heqë dorë nga zakonet e vjetra; të mos bëjë intriga: ta dojë popullin; t'i vijë në ndihmë vendit dhe t'i bindet më të zotit.

E treta më tha:

— Që sot e tutje në kasollen tënde, që e ke rrëzë këtij mali, do të ndizet një kandil; kur të shuhet drita e tij të shpejtosh ta marrësh flamurin dhe ta ruash për nonjë rast tjetër.

Fatiat, me të mbaruar fjalët, më humbisnin njera pas tjetrës. Fërkova sytë se m'u duk si ëndër. E mbloodha mëndjen dhe mora udhën për në Vlorë. Arriva me shumë mundime. Më prisnin... Kjo ditë ish 28-ta e vjeshtës së tretë 1912. Ishte si do zot sot. Kanë shkuar shtatë vjet...

— Djalë, verë dru në vatër — më tha plaku kur mbaroi — mos i kurse dhe i shtiu sytë te kandili, drita e të cilit ish e venitur. E vura re plakun që u verth.. Rrëmbeu gunën dhe, duke shtyrë derën me rrëmbim, më tha:

— Jam për udhë... Shkoj tutje... Ju rrini këtu se ini të lodhur... Mund që shpejt të kthehem... Ja tek janë drutë... Shkova...

Kur u ngritshë më të nesërmet, se më kish zënë një gjumë i rëndë, plaku ish kthyer. E vura re se xheç mbante fort në gj...

1919

1) fatia — fallxhesha.

D Ě S H M O R I

Gjoni kish më shumë se një orë që po shëtiste nëpër dhomën e tij që e kish të vogël, të bukur, po të mobiluar me shie fshataraku. Në këtë kohë, ay mejton-te për punërat e Shqipërisë, që vinin keqemëkeq. I solli ndër mënt që të gjitha sa rrodhë dhe si u krijua Shqipëria. Iu kujtua dita kur priste, në limanin e huaj, që të hiqej bllokada dhe të vinte në Shqipëri. Gjoni ahorej ish plot me shpresë; ay desh të bëhej, në mos ministër, dobare nonjë drejtor. Kish besim të math mi veten se, sadoqë s'kish mbaruar nonjë shkollë, kish kënduar shumë dhe ish mbushur me teorira të larta, të cilat dëshëronte t'i vinte në praktikë. Që të gjitha këto i dukeshin të lehta, dhe, me cilindo që piqej, vetëm për këto bisedonte.

Bllokada s'kish të hiqej; paratë, që kish sjellë me vete dhe që i kish fituar me mundime të mëdha, iu mbaruan; miq s'kish; desh t'u shkruante letra ca kushërinjve, po, duke patur shpresa të pakta e la mënjanë këtë mejtim. Kish për të paguar në hotel dhe në restorant... Kish disa dit që s'kish ngrënë me rregull. Flinte tërë ditën dhe shpirtin e tij e mbante me ujë... Dhe një ditë, kur kish mbetur i parrojtur, kur kish dy dit që s'kish vënë në gojë erën e brumit, poqi një nga të njohurit e rinj që ish nga komitat e Shqipërisë. Kë-tij ja tregoi hallin, iu qa për vojtjet dhe i lypi hua ca para. Ja, ky e njohu me ata që duhej... Ky ja bëri ndërmjetimet dhe Gjoni shpëtoi nga hallet.

Duke mejtuar gjer këtu, Gjoni e kuptoi se, dhe ay, ka gjisht në prishjen e Shqipërisë. Trutë iu mbushnë me mejtime dhe nga goja, pa dashur, i dual këto fjalë:

— Epiri u doq e u çkatërrua; Shqipëria u prish dhe ra në duart e komitës turkomane... Ah, dhe unë kam gjisht në këtë punë të pabesë kundër kombësisë sime.

Atij i dukej sikur kish mi zemër nonjë gur mulliri. Mesdita kish arrirë; Gjinit s'i vinte mëndja për bukë: ay po kujtonte ditën dhe orën që e bëri i mallku-

ari me vete. Në trutë e tij hynin dhe dilnin shumë gjy-
kime, që kundërshtoheshin në mes të tyre. Ca prej sy-
resh ja lehtësonin fajin dhe ja zbarthnin ngjyrat e ze-
za. Në këto minuta i thesh vetes:

— Pse ta mundoj veten? S'ndej të kem bërë gjë
kundër atdheut? Kisha nevojë për para; u ndodhë një-
rëz të mirë dhe më shpëtuan nga nevoja dhe uria.
Pagova borxhet, u vешa, u mbatha.... Vallë ç'mëkat
kam bërë? Kur i mora paratë, s'dhashë as ndonjë zo-
tim, vetëm më kërkuan të përpiqem për Shqipërinë,
të bëj propagandë kundër armiqve të saj...

Gjykimi i fundit e liroi nga dyshimet; dolli jash-
të dhe, i çkujdesur, shëtite nëpër skelën e qytetit të
bukur që ku me fantazi shikonte Shqipërinë e da-
shur.

* * *

Kishin shkuar shumë dit. Bllokada ish hequr e
Gjoni rronte i çkujdesur sadoqë nuk bënte nonjë punë.
Shokët kishin dyshime dhe s'i zinin besë, po atë s'e mun-
donte asgjë. U mësua, dhe paratë e muajit i mirrte gjy-
thë me atë qetësi që i merr punëtori, zyrtari, agjenti...
Mirëpo, lajmet që këndonte nëpër gazetat zunë ta turbu-
llojnë pak se, pas syresh, kuptohej që Shqipërisë po i
pregatitej vdekja. E kuptoi dhe qëllimin që kishte qeve-
ria nga e cila paguhej dhe ra në mejtime. Zuri t'i shante
shkaktarët, po jo sheshit. Miqtë e kishin kuptuar dhe e
kishin lënë vetëm. Ja, pas gjithë këtyre, nisi ta kuptojë se,
duke mbrojtur një qeveri që pregatit prishjen e Shqi-
përisë, bën tradhëti. Po një zë e qërtonte duke i thënë:
«Mos u nxito se ajo do ta këmbejë taktikën». Në minutat
që i mbushej mendja se bën tradhëti, ish gati t'i refuzonte
paratë, mirëpo i kujtohej qiraja e odës, restoranti, thea-
trot dhe ja rrëzonin vendimin me qërtime.

Tirana, Elbasani, Berati dhe shumë vise të tjera ki-
shin rënë në duart e rebelëve. Ushtria e veriut u çakër-
dis pa lëftuar se, siç thesh Gjoni, u hyri djalli në mes:

Korça dhe viset e tjera të Jugës ranë në duart e kryengritësve epirotë. Këto ngjarje e bënë Gjonin të mejtohet, dyshime më s'i kishin mbetur që dhe ky vetë kish gjisht në prishjen e Shqipërisë.

Dita që e mirrte rrogën kish shkuar qëkur. Në xhep s'kish as një metalik. Tani s'mejtonte për urinë as për qiranë, as për theatrot, po si do ta vinte nderin në vënd. Po uria është shumë e fuqishme, ajo ja prishi vendimin e parë dhe e shtyri të vejë të marrë paratë. Atje i zgjatën një dëftesë për të nënshkruar. Gjoni e pa zyrtarin dhe iu duk vetja se mos është Judha. Në sytë e zyrtarit këndoi këto fjalë:

— Ja, dhe ti, si Judha që e shiti Krishtin për para po e shet atdhenë.

Paratë i mori me mundime të mëdha, po kur e pa zyrtarin në sytë e tij këndoi dhe këto fjalë:

— Gjersa të ketë në Shqipëri njerëz që do të ma trokëllasën derën për të lypur të holla, ne do ta mbarojmë qëllimin tënë.

Iu errë sytë; e në veshët iu ndëgjua një zë:

— Për ca para të shkreta po më tradhëton! Të zëntë qumështi që ke pirë nga gjiri i nënës!

Ky zë e liroi dhe nga tronditja e fundit. E rrëmbeu dëftesën e bëri copra; paratë ja hodhi zyrtarit fytyrës dhe, i lehtësuar e i shkundur nga çdo barrë, doli jashtë.

* * *

Krisi lufta pranë Vlorës. Patriotët po përpiqeshin ta mbanin të lirë këtë qytet ku valoi flamuri për të parën herë pas skllavërisë. Gjoni kish ardhur vetëdësh dhe sulej në radhën e parë. Shumë herë i theu rebelët dhe u zaptoi pika me rëndësi. Po në një goditje, që ngjau te pragu i Vlorës, ra i vdekur për idealin e shënjtë. Dhe rebelët, duke shkelur mi trupin e Gjonit, hynë në qytet, unjë flamurin e Skënderbeut dhe ngritnë të babës.

Korçë, 1927

USTAI DHE ÇIRAKU

Kur dolla nga shtëpia, ora ish dhjetë; dolla që të mblihnja ca ndihma për gazetatat. Shtytjen, për këtë gjë, ma dhanë të qarat e gazetarëve.

Planin e kisha vendosur që mbrëmave po, duke parë kohën e ligë, — binte dëborë dhe ish shumë ftohtë, — desha ta linja për një ditë tjetër. Nga që s'kisha ç'të bënja mora librin e Tollstoit «Qarku i këndimit» dhe këndova këto në faqja që m'u hap. «Njeriut që të kërkon ndihmë, dhe që e kupton se ka nevojë, mos ja shty për nesër ose për pasnesër se, po të vdesë, mëkati të bie ty». U drodha nga kjo frazë. Përnjëherej u veshva me pallton dhe kapellon e beharit dhe, pa vënë ré as erën, as furfurinën dhe as cikmen, dolla nga shtëpia. Udha ish e largme po, duke ditur «përse vetë», këmbët s'më ndjenin të lodhur.

Kur arriva te shqiptari i parë isha mbuluar më dëborë. I njohuri im kish ndënjur mi një fron dhe po këndonte gazetën e vëndit. Passi nxora kalloshet, që i kisha të grisura, i zgjata dorën dhe i thashë:

— Mirë mengjez, Zoti Thanas!

Zoti Thanas ma zgjati dorën me të ftohtë dhe më tha:

— Mirsardhe... po pse qenke lodhur?

E pashë që iu këmbye fytyra dhe s'desh të më flishte. E unë i thashë:

— Zoti Thanas, jam munduar gjer këtu që t'ju kërktoj ndonjë ndihmë për gazetatat. Kanë nevojë të madhe. Z. Thanas më shihte sikur desh të më hante.

E unë vazhdova:

— Ja, kombet e tjerë po përparojnë se nuk kursejnë asgjë. Kështu duhet të bëjmë dhe ne që të përparojmë.

— Po, po, ashtu është, ke të drejtë, — më tha Z. Thanas, — po ne nuk kemi njerëz.

— Si nuk kemi njerëz?! — ja rrëmbeva fjalën.

— Njerëz kemi, po duhet t'i ndihmojmë që të mundin të punojnë.

Z. Thanas u zëmërua, u skuq, luajti nga vëndi dhe më tha:

— Gazeta, gazeta, gazeta; ndihma, ndihma, gjithë për të tilla na vini! U lohtmë de se dhëni! Ja, nuk ka as tre muaj që mblotmë për atë gazetën që nuk vjen. Dhe më pa drejt në sy.

E unë, duke dashur t'a qetojë, i thashë:

— Zoti Thanas, ju lutem, mos u zëmëroni se nuk kini të drejtë. Gazetari i varfër përpiquej gjer në fund, duke harxhuar ç'ka, për ta parë të lirë e të përparuar kombin shqiptar. Ne i ndihim vetëm me ca para, kurse ay bën kurban tërë jetën.

Zoti Thanas as që më ndëgjoji; e unë i thashë:

— A do të më ipni gjë?

— Jo, unë s'jap dot asgjë se dhe kshu u batërdisa me këtë shqipen.

— Detyra jonë është t'u ndihim, pa ju bëni si t'ju pëlqejë. Dhe si u vësha, duke shkuar i thashë: Rrini me shëndet.

— Ecë më shëndet, po kshu nuk kemi njerëz ne, jo. Po me mendje thesh: «Ku e solle kokën, mos vafsh shëndoshë»!

Më pushtonin mendime të ndryshme kur barisnja rrugët e mbushura me dëborë. Vajta te tjatri, te tjatri. gjithsecili kish psikologjinë e tij, gjithsecili përdorte arësytet e tij dhe gjithsecilit duhej t'i flisnje dhe ta ndëgjoje. Kur u kthyesh në shtëpi, ora kish vajtur dy i natës. Uria më mundonte. Restoranti ish mbyllur. Kisha në shtëpi ca bukë e ca djathtë dhe i kollofita si ujë i urtuar.

* * *

Më të nesërmet u gdhishë i sëmure se të ftohët e ditës më qe futur në kockat. Kisha kollë dhe të nxehtë. S'dolla dot këtë ditë. Ora kish vajtur shtatë. Në këtë hop u hap dera dhe hyri shërbëtori i Z. Thanas. Ky i

kish mësuar që të gjitha. Ma shtrëngoi dorën fort: ky shtrëngim ish i një djali që nuk mejtonte asgjë tjetër, në këtë botë, përveç atdheut. Dashuria për atdhenë e kish pushtuar për zemre Raqin dhe ish gati ta bënte veten kurban për Atdhenë. Ky ish nga të vetmit që më deshnin e më nderonin për idenë se unë, ngaherë, u këndonja historinë e Shqipërisë e të Skënderbeut. E kisha mësuar të shkruante e të këndonte. Ky djalë i mirrte që të gjitha gazetatat që dilnin dhe ndihte në çdo rast.

— A mblodhe shumë? më pyeti si me turp Raqi.

— Sa pandeh ti Raqi se mblodha?

— Po, nonja 300-400 franga, m'u përgjegj me rrëmbim.

— Kha, kha, kha. — ia thirra të qeshurit dhe i thashë:

— Pas numrit që jemi duhej të mblithnja më shumë po nuk mblodha as një të tretën. Të trokëllasësh 130 dyer e të mbledhësh vetëm pesëdhjetë franga!

— Vetëm pesëdhjetë, vetëm pesëdhjetë...

— Dhe këto, me njëmijë mundime se duhet të ndëgjosh mendjen e cilitdo prej tyre.

Nga që desha të di ç'tha i zoti, e pyeta:

— As më thuaj, Raqi, ç'tha yt zot kur shkova?

Raqi unji sytë dhe m'u përgjegj:

— Mua s'më tha asgjë po tërë ditën thërriste, shante shqipen, gazetatat dhe thesh se ato e kanë batërdisur. Por kur erdhi posta dhe më solli gazetatat e Korçës i hapi dhe i këndoi.

— Si the? — ja rrëmbeva fjalën. — I hapi dhe i këndoi? Këndon gazeta shqipe yt zot?!

— Po, i këndon se mëson kush është martuar, kush ka vdekur, kush ka lindur dhe sa është pjaca e Korçës.

— Ndëgjomë, Raqi, këtu duhet bërë një punë, shkruaju gazetarëve të ta dërgojnë në një drejtim tjetër dhe yt zot, meqë do të këndoje, do të shtrengohet të pajtohet më ndonjë gazetë.

Bisedova dhe shumë me mikun e vogël; më dha dhe ay dhjetë franga, vura dhe vetë dhjetë dhe ua dërgova gazetarëve.

* * *

Kishin shkuar më shumë se dy muaj. Zyrat e gazetave e kishin ndryshuar drejtimin e Raqit. Zoti Thanas, meqë nuk i binin në dorë, zuri të brengosej se desh të mësonte ç'ngjet në Korçë. Kish dhe një muaj që nuk kish marrë letër nga shtëpia dhe nuk e dinte ç'ngjiste poshtë.

Një ditë, Zoti Thanas thirri Raqin dhe i tha:

— Përse më s'të vijnë gazetat shqipe?

Raqi, si finke që ish, i tha ustait:

— Se nuk i kam paguar për këtë mot dhe ata, pa para, nuk i dërgojnë. Unë dua t'ua dërgoj pajtimet, po s'mund se e kam hakën të vogël, po dhe atë që e kam marrë, ju e dini se e kam dërguar në shtëpi.

— He, — tha zoti Thanas, — po sa duhen dhe si dërgohen?

— Dhjetë franga në mot dhe paratë dërgohen në postë.

Zoti Thanas krojti kokën, futi dorën në xhep, nxori kuletën, zgjodhi biletën më të vjetër dhe ja dha Raqit duke i thënë:

— Na, dërgoja më së mirës, po jo të jashtmet, po nga ato që dalin në Korçë.

Raqi shkoi me shpejtim në postë, se kish frikë mos i pendohej ustai.

Pas disa ditësh, posta e solli gazetën në adresën e Zotit Thanas. Ay, kur e mori në dorë, qeshi, e grisi kartën që ish shkruar adresa dhe tha:

— Dhjetë franga në mot, një gazetë në javë, bie 20 qindarë ar copa, shumë shtrenjtë.

Raqi s'e mbajti dot të qeshurën, u fut në dhomën tjetër dhe u mejtua: «Po të kishin ardhur gazetatat e mija në dyqan, im zot, as sot as mot, do të mos ish pajtuar. Kështu u bë pak shqiptar se i ndihu shtypit me dhjetë franga.

II. PLAGËT E KURBETIT

PASHKA NË SHQIPËRI.

Kumonimi i kabanave më zgjoi nga gjumi. Të ngrihesha, përtonja se gjumi i mëngjezit ish aq i ëmbël sa më kish lidhur për shtrati. U zgjata, dy-tri herë, hapa gojën dhe më zuri gjumi përsëri.

Në këtë hop erdhi im' më dhe më spërkati me ujë. U trempshë dhe u ngritshë. Përnjëherej m'u kujtua që ish dita e Pashkës dhe hadeti i të squarit me të spërkatur. U ndërruash me shpejtim, veshat robat, e reja, që m'i kish sjellë pranë im'më, dhe kështu i zburuar mora udhën për në kishë. Qielli që i mbushur me re. Frynte një erë e hollë dhe vise-vise cërkonte¹⁾. U kujtuash që duhej marrë umbrellë se, po të më zinte shiu, do të më bënte si nonjë mace të lagur.

Kisha ish mjaft larg dhe pas ca minutave arriva. Kishin ardhur njerëz plot, po edhe nuk ish kënduar «Krishti u ngjall».

Priifti, i cili ish i thinjur dhe plot me rrudha, me një zë të ngjirur po këndonte lutjet, të cilat gjindja i ndëgjonte me një evllavi²⁾ të madhe. Sa më shumë afrohej koha që do të thuhej «Krishti u ngjall», aqë më shumë më pikëlluhej zemëra se, 35 vjeç njeri u bëshë ngjer më sot, nuk e kam ndëgjuar nonjë mot shqip.

1) cërkonte = pikonte.

2) evllavi = nderim i veçantë, venerim.

Koha erdhi dhe prifti e këndoi gërquisht «Krishti u ngjall». Unë, në vënd që ta drejtonja vërejtjen time mi këndimin e priftit, u pushtuash nga mejtimet se m'u kujtua e ngrata Shqipëri dhe thashë: Ja, shkoi dhe një mot si të parët! Sa liksht, t'i ndëgjosh lutjet e zotit në gjuhë që nuk e kupton! Sa liksh që nuk kanë arrirë ta kuptojnë që të gjithë dhe t'i japin shkelmin qarkut të errësirët që i rrethon!

U bëshë si i marrë, pa ditur ku gjëndem dhe ç'bëj, iu afëruash priftit dhe i thashë: «Uratë, këndojeni dhe një herë shqip!»

Uratë u zëmërua, u mvrejt në fytyrë dhe më pa me sy të lik. Nga që ndodhej në shërbim e sipër, nuk m'u përgjegj; e kuptova që e malcova¹⁾ shumë me fjalët e mia dhe që ish gati të më çgjakësonte në rastin e parë.

Mesha mbaroi. Njerëzit u çduknë, pasi u çokitnë vezët, gjithkush mori udhën e tij. E unë si nonjë i lënë, automatikisht hyra në shtëpi, u drejtuash në dhomën dhe rashë mi shtratin si i vrarë.

II.

Retë, që ishin të dëndura, u përhapnë dhe rrezet e diellit u futnë në dhomën time. Im'më kish ardhur nonja pesë herë të më sqonte, mirëpo unë isha si i lënë dhe s'muntnja t'i mblithnja mëntë në kokë. E kisha humbur aqë shumë sa s'mbanja mënt ç'kish ngjarë. Nisa t'i kujtonja, po s'munda se mejtimet më ngatërroheshin aqë shumë, sa m'a errësonin të vërtetën. I pushtuar nga mejtimet, më zuri gjumi dhe pashë ëndër sikur ish Pashkë dhe unë shkonja më një udhë të gjërë, që ish e zbukuruar më të dy anët me drurë. Automatikisht u futshë me një sallë, ku pashë që hynin gjithë djem të rinj. Vura

1) e malcova = e preka, e lëndova.

veshin të ndëgjoj më ç'gjuhë flasën. Përmi veshin tim qëndruan ca fjalë të mbytura, nga të cilat s'munda të kupëtoj dot asgjë. Po, na, erdh një njeri dhe që të gjithë u ngritnë më këmbë. Njeriu që erdhi ish i veshur me rroba të zeza, kish mjekrën dhe mustaqet të zeza sterrë; s'ish aq i bukur në fytyrë dhe nga boja ish mesatar. M'u duk sikur vuri gjishtin për të bekuar, u drejtua të katedhra, hodhi ca vështrime rreth-e-rrotull, dhe tha: «Paqje ndër ju», heshti, i ngriti sytë përpjetë dhe me të pëshpëritur, si më dukej, po këndonte lutjet e Zotit.

Një fjalim i dy zotërinjve, që ishin pranë meje, qëndroi mi veshin tim: «Ky është prifti i parë i shqiptarëve», dhe u ndëgjua zëri i priftit, që m'i shurdhoi fjalët e zotërinjve. Kur ktheva sytë e pashë uratën më këmbë dhe, me zë të fortë dhe melodik, tha:

— Të uruar e të bekuar! Sot po lusëm Pashkën. Është e kremte shumë e madhe për të krishterët. Po për ne shqiptarët nuk është dhe aq e madhe, jo se nuk e mbesojmë ose nuk jemi të krishterë po nga që nuk kemi fatin ta ndëgjojmë më gjuhën tënë. Se ja dhe na dëfteu neve — vetëm kjo pakicë ka fatin ta ndëgjojë shërbimin e shenjtë më gjuhën e vetë, kur qindra mijë nga vëllezërit tanë nuk e kanë këtë fatbardhësi!

Vëllezër të dashur! Mejtimi del nga një njeri, po kur është i drejtë i pushton mendjet e të gjithëve dhe përhapet. Kështu do të përhapet dhe mejtimi për shërbimin e lirë me gjuhën e vetë në kishë. Dhe, në mos shpejt, vonë, do t'i pushtojë që të gjithë ndenjësit¹⁾ e Shqipërisë.

Vjet, nuk e kish fatin as nonjë shqiptar, ta ndëgjonte «Krishti u ngjall» me gjuhën e vet, kurse sivjet janë përmi 500 që e dëgjuan. Po mot? Mot kam shpresë se cilido nga ju do të bëhet një apostull që ta ungjillëzonjë²⁾ gjuhën tonë në Shqipëri...

1) ndenjësit = banorët

2) t'ungjillëzonjë gjuhën = predikoj për gjuhën.

Një trokitje e tërbuar më sqoj dhe ma humbi embëlsirën dhe sërën e endrës. Malkova të gjallë e të vdekur se aq shumë u dhashë pas saj, sa desha të ish e pasosur.

Kur hapa sytë, ç'të shoh? Përpara meje qëndronte një xhandar, që më tha se më duan në polici.

U mvesha dhe, bashkë me xhandarin, që e kish sfyngjinë ¹⁾ nxjerrë, u drejtuash në polici. Nuk e dinja përse më suallë po, duke parë ca njerëz të njohur dhe priftin në mes të tyre, e kuptova që nuk më deshnin për sytë e zes.

Në këtë kohë nuk kujtonja asgjë tjetër, por vetëm atë pakicën që patnë fatin ta ndëgjonin «Krishi u ngjall» më gjuhën shqipe.

III.

Kështu ndenja shumë kohë. Sa që ishin në dhomë u futnë në këshillët dhe më lanë vetëm me xhandarin, i cili në pyetjen që i bëja «përse më suallë këtu», nuk më përgjigjeshe, po heshtëte si peshku.

Nuk dinja ç'të mejtonja. E shihnja lirinë time të humbur, se e linja sa rëndë i gjykonin të dyshimtët për çështjen shqipe.

Shkoi më shumë se gjysmë orë që po këshillohe-shin, gjer kur dolli një njeri i veshur me shallvare të gjëra, me feste të zgjyrosur dhe i tha xhandarit të më shpinte brenda.

Zëri i egër i xhandarit më luajti nga vëndi dhe u drejtuash në këshillë...

Kadiu po rrinte mi katedrën. Ky qe një njeri tepër i shëmtuar, me mjekër të verdhë, me sy të shtrëmbër, me hundë si qip ²⁾ prej shqiponje, me gojën pa masë të madhe dhe fytyrën ja kishin mbuluar krundet. Ish i veshur, pas sistemit anadollak me një palë pan-

1) sfyngjëja = bajoneta.

2) qip = sqep.

tallona të gjëra dhe të shkurtëra sa i dukeshin gjelmitrit¹⁾ e çorapëve të bardha. Këpucët i kish fino anadollake, jelekun, që e kish të murmët, si dhe zaketën i kish të qepura pa mjeshtëri. Mezë ja shtrëngonte një bres tëtëmbëdhjetë kut i gjatë, si dhe festen ja shtrëngonte një sërëk²⁾, që nga qielli ngjer mbërdhe i gjatë. Ja, gjithë këto ishin stolitë e gjykatësit otoman.

Kur hyra, ay mori mvrojtësinë që ja lypte ofiqi dhe, me anën e terxhumanit, më pyeti.

— As më thuaj në ç'kombësi nëmërohesh?

Heshta pak. E dinja që i ndjekin shqiptarët po, nga që e dinja se është turp ta mshehësh kombësinë, pa frikë iu përgjeqshë:

— Jam shqiptar!

— Ç'fe ke?

— Orthodhoks!

— Mos je dhe ti nga ata që duan të shkruhet gjuha shqip?

— Nuk ju kuptoj, z. kadi?

— Si nuk më kuptoni?

— Po, nuk ju kuptoj se më flisni për të këtilla gjëra. Po, meqënëse jam shqiptar, që të gjitha ato që i sjellin të ligë i lëftoj.

— A — ha... ahorej nuk na duhen shahitër, se ti vetë e dëshmove këtë gjë për të cilën të kanë padisur.

— Po si të mos them se jam shqiptar, kur nuk di tjetër gjuhë? Ahorej pas mendjes suaj ç'të jem?

— Meqënëse je i krishterë duhet të quhesh rum³⁾. Po ti, siç e dëshmove më sipër, je nga ata që duan të lërohet gjuha, të hapen shkolla, të mësohet kjo gjuhë... Këto i kuptojmë siç e kuptojmë që nesër, pas nesër, do të doni të bëni dhe mbretëri më vete.

U zëmëruash pa masë kundër gjykimit të kadiut, që drejtoheshe mi mua, po ca më shumë se zuri të m'i

1) gjelmitri = gjalma.

2) Sërëk = çallma.

3) Rum = quheshin të krishterët në kohën e Turqisë.

lose ato tela të zemrës, që më sillnin më të mbëdh-
të dhëmbje. Tërë këtë kohë po e ndëgjonja kadinë me
kokë unjur. E kuptova që gjyqi do të më bëheshe
shumë i rëndë, u mbajta, desha t'i derthnja që të gjit-
tha ato hidhërime që ma mundonin zemrën. E ngrita
kokën përpjetë, ja ngjita sytë kadiut dhe, me zë të
fortë, që lëshonte oshëtimë dhe tingëllinte posi kumon-
nim i kambanës, i thashë:

— Zoti Kadi! Zotëria juaj jini mësuar të gjykoni
dhe, në kohën e gjatë që jini përmi këtë katedër, kini
gjykuar shumë njerëz: ca i kini dënuar dhe ca i kini
nxjerrë të pafajshim. Me të këtëlla ndodhira është
mbushur libri i jetës s'uj. Sot mi fronin e fajtorit më
kanë vënë mua se jam i paditur nga një prift. Ju po më
gjykoni dhe po rrëmoni nyjet e kodit¹⁾ gjyqsor që të
më dënoni pas ligjit. Faji im është se dua që gjuha
ime të shkruhet dhe të mësohet.

«A më ndëgjuat, o njerëz, përse më gjykojnë?»
— Këto ua thashë ndëgjonjësve. Heshta pak minuta.
Fshiva sytë se, nga zemërimi i madh që më kish push-
tuar, nisnë të më pikonin lotët. Pastaj u kthyesh nga
kadiu dhe i thashë:

— Zoti Kadi! Unë e di fort mirë që ju kini bërë
be, përpara kuranit, të mos dënoni njeri të pafajshëm.
Po mua, përse më sualltë këtu dhe më sheshuat²⁾.
mbi fronin e fajtorit?... Vallë, pas nomit, ç'faj kam
bërë? Cilën nyjë kam shkelur? Ju lutem kërkojeni,
rëmoni në kodin, po të këtëllë nyjë nuk ka. Jo, të kë-
tillë nyjë nuk ka dhe, siç kini dënuar shumë të pafaj-
shëm, ashtu do të më dënoni dhe mua. Jam gati t'i
duroj që të gjitha: si gjyqnë tuaj të shtrëmbër, si kall-
zimin e njerëzve të Perëndisë, që veprojnë kundër
porosive të Tij. Ju gjykoni shumë liqsh! Po, mos pan-
dehni se me të dënuar mua, vëllanë, kushërinë, do ta
humbisni mejtimin e drejtë që u mbuall nga theme-
llonjësit e shqiptarësisë? Krahërorë, që i presën me

1) nyjat e Kodit = nenet e Kodit.

2) më sheshuat = më vutë, më vendosët.

gaz plumbat e armiqve për trashëgimin e ndjenjës së shejtë, ka shumë, aqë shumë se as që e pandehni.

Kadiu po kthente fletët dhe po ndëgjonte terxhimanin i cili ja kthente turqisht. Unë isha si i tërbuar se vështrimi i tallshëm dhe ironik i priftit më xhindosi fare dhe i thashë kadiut:

— Vallë ç'rremoni? (Flisni, jepmëni dënimin? Shtoni dhe një nyjë mi të cilën do të mundni të kini mbështetje që të më dënoni.

Kadiu u ngrit më këmbë dhe këndoi dënimin:

— Me urdhërin e N.M. së tij Sulltan Abdull Hamidit, Qirjakoja dënohet me dhjetë vjet burg për ndryshimin që kërkon të sjellë në mbretëri.

Isha si në gjumë kur e ndëgjova dënimin. U ngritshë më këmbë dhe me grobësi ¹⁾ i thashë kadiut:

— Të gjithë e vulosë?

— Po, u vulos nga të gjithë, — m'u ndëgjua një zë.

— Jo, nuk e kanë vulosur të gjithë, — u thashë me tërbim.

— Mjaft lehe — m'u ndëgjua një zë, i cili ish i xhandarit dhe dora e tij e fortë më zuri për krahu dhe më drejtoi në burg, ku duhej të rrinja dhjetë vjet.

«Dhjetë vjet — thashë me vete — do të mos munt t'i shërbej shqiptarisë» dhe nga sytë më pikuan lotë që ishin të rëndë dhe të shpeshtë.

IV.

U përhap revolta e xhonturqve.²⁾ Ushtëritë e sulltanit u thyen. Mbretëria Otomane mori koshtutën.³⁾ Burgjet u hapnë dhe unë u liruash bashkë me gjuhën shqip, pa mbushur as tre muaj.

Odesë, 1912

1) me grobësi = me arrogancë.

2) Është fjala për lëvizjen e turqëve të rinj të vitit 1908.

3) koshtuta = kushtetuta.

NËNA

I

Kishin shkuar shumë vjet që nga dita që Keli e la Shqipërinë. Nevojat e shtëpisë, kusarët që brithnin nëpër qarkun e katundit të tij, varfëria e vëndit dhe tirania turke e shtrënguan të marrë mërgimin.

Në kurbet i shkonte ditët duke punuar. Fati kur e ndihte e kur jo, dhe kurrë nuk e linte t'i mbushte qëllimet e tij. E koha, njëra stinë pas tjetrës, shkonte me rrëmbimin e ujit.

Keli kish nisur të fitonte shumë para dhe e vuri ndër mënd të kthehej në atdhe e ta shohë nënën, të shtëpisë dhe t'afërmit se nga koha e gjatë i kish harruar kusarët që brithnin në qarkun e tij. Mirëpo, paraja është si uji i kripur: sa më shumë të pish aqë më shumë të shtohet etja. Dhe Keli zuri ta verë mënjane njëren mijë pas tjetrës; zuri t'i nëmërojë nga ditë, me kujdes dhe t'i fshehë në turli vrime. I kish dhënë fund të nisej për në atdhe kur ta mbushte mijën e njëzetë. Keli e kish kuptuar, nga koha, nga pësimet, nga uria dhe nga goditjet që kish pësuar në jetën e tij, se gjithë lidhjet dhe zgjidhjet e kësaj bote janë në duar të parasë.

II.

Moti nuk e di se si ishte, se Keli s'kish nge ta vinte re. Ay ish bërë vrer. Udhë ia pre. Lufta ja përmbysi qëllimet. Tani, ay, e kish mbushur mijën e njëzetë. Dësh të kthehej në atdhe, ku kish ndër mënd të bënte tregëti, t'a ndërtonte shtëpinë, të lumtëronte t'ëmën...

— O botë e keqe! — tha Keli duke psherëtitur, — kur i kam që të gjitha sa më duhen dhe jam gati të nisem, na doli lufta që m'i përmbysi qëllimet.

E zjarri i luftës sa vinte po përhapej, shumë e më shumë. Keli mbeti pa punë se lufta e qëndroi gjithë

industrinë. Atij zunë t'i treten paratë njëra mijë pas tjetrës. Koha shkonte. Udha sa vinte po mbyllej keq e më keq. Letra s'mirrte se u pre dhe posta e nuk e dinte si ndodhej e ëma. Nuk e dinte në ish gjallë a vdekur. Mejtimet e mundonin pa masë. Kish dërguar disa letra me para, me turlish mënyra, po s'mori as nonjë përgjigje. Koha shkonte, lajme nga shtëpia s'mirrte dhe paratë i treteshin. Keli s'dinte ç'të bënte. Më në fund hapi një dyqan. Puna s'i eci dhe e humbi tërë sermenë¹⁾. E koha shkonte dhe shkonte se ajo s'ka punë tjetër dhe s'di ta vrasë mëndjen për botën. Tani që e kish shitur dyqanë po e mundonin mejtimet ca më shumë. Malli e hante. I këndonte gazetat nga ditë dhe si nonjë strateg i mirë e ndiqte rrjedhjen e luftës se interesohet për frontin e vëndit të tij, ku ndodhej e ëma dhe dëshëronte që të zптоhej dhe t'i hapej udha.

III.

Kur çeli agimi, Keli ish ngritur dhe po pinte kafënë. Mori gazetën dhe pa që ish shkruar me shkroja të mëdha: «Ofensiva në frontin N.N.». E shtrëngoi gazetën me duar, me sytë e ndritshëm, dhe, pasi e këndoi gjer te fjala e fundit, thirri: «Lavdi ty, o Zot! Tani do të mund t'a shoh nënën». Po kjo gjë që iu duk kaq e lehtë ish tepër e rëndë, se në çdo çap që bënte për të marrë leje gjente ndalime të mëdha. Më në fund, me shumë mundime, me shumë ryshfete dhe me ndihmën e një miku me influencë munda të marrë leje për të shkuar në atdhe.

IV.

Me të nxjerrë pashaportën u nis. Kur hyri në kufirin e pa që viset ishin ndryshuar. Malet ishin gërvishtur. Fushët ishin punuar mirë...

— O Shqipëri s'të njoh dot, — thesh Keli duke shkuar me automobil nëpër shosetë²⁾ e reja të Shqi-

1) Serme = kapital.

2) Shose = rrugë automobili.

përisë. Dhe nuk lërente së vëni re me ڪuresht e me çudi.

Po, lufta ka dhe faqen e bukur, ka dhe anën e mirë. Më parë, në kohën e babës duhej të shkonin shumë vjet gjer të bëheshin gjithë këto; kështu megj-tonte Keli dhe pa dashur iu kujtua ajo legjenda shqipe kur Perëndia zbriti e vizitoi botën dhe që më të katër anët iu desh ڪallauz e në Shqipëri e gjeti vetë udhën. Dhe në këtë hop tha Keli:

— O Perëndi, sot, në Shqipëri s'e gjen dot udhën!
— dhe plot gaz, plot nënshtypje e shkoi në një ditë atë udhë, që e bënje më parë në gjashtë ditë.

V.

Malet qëndronin kryelartë dhe tregonin ashpërsinë e Shqipërisë së moçme dhe të shqipëtarit të asaj kohe. Rrëzë malit ish katundi i Kelit. Iu afrua. Edhe ish i pari; shtëpitë e gurta qëndronin njëra përmi tjetrën të rrethuara me gjethin e pyllit dhe me barin e luadheve. Xheku dukeshin drurë të frutshëm me degë të epura ¹⁾, xheku këcenin fëmija që nuk dinë ta vrasin mëndjen.

Keli e mbante mënt fshatin. Iu kujtua koha e miturisë... ditët e foshnjërisë iu ngjallë dhe me padurim priste të shihte t'ëmën. Ja tek u duk shtëpia... Ja tek është gardhi... Ja tek duken odat me penxheret e vogëla pa xhamë. Ja tek dolli dhe qeni i math i cili lehu me zë të trashë dhe, më ta njohur, tundi bishtin.

Keli ecënte përmes luadhit dhe desh ta shtrëngonte nënën, ta puthte... E hapi derën... Maçoku ish shtrirë në vatër. Keli dridhej i lëri dhe me lakmim vuri re në të katër anët. Ju errë sytë se përveç shtresës së trashë, nga ana e djathtë, s'pa asgjë tjetër. E humbi durimin dhe thirri:

¹⁾ degë të epura = degë të përkulura.

— A ka njeri këtu?

As nonjë përgjigje. U ndëgjua vetëm një e kollur e trashë dhe e thatë. Vuri re mirë kush ish shtrirë. Nga zëri pandehu se do të ish gjyshja. U drejtua te shtresa dhe, duke zbuluar jorganin, pa një grua të tretur si sqelet: lëkura e saj i qe futur dhe ngjitur në koskat; sytë i qenë futur, duart i qenë bërë kleçka... Keli s'duroi dot dhe pyeti.

— Cila je ti, moj grua?

Sytë e të sëmures zunë të lëvizin dhe e panë Kelin me shpejtim. Ay s'dinte ç'të mejtonte dhe tha:

— Thuajmë cila je? — dhe pasonte ta vinte re. Në dritën e venitur të syve të saj njohu sytë e s'ëmës...

E sëmura e pa djalin dhe, sadoqë faqet dhe buzët e tij ja kishin mbuluar qimet, e njohu po s'munte të fliste. Sëmundja ja kish mbyllur gojën. Nxori një zë që ngjet me klithmin e zogut të plagosur, u hoth nga shtrati me sulm, e pushtoi Kelin në qafë dhe me zë të gërvishtur tha:

— O biro! Tani që të pashë, do të mund të vdes e lumtur! Edhe dheu do të më tretnjë se, gjer më sot, vetëm malli për ty më ka mbajtur të gjallë.

Dhe ja dha frymën Zotit.

Vienë, 1918

MALLI PËR NË ATDHE.

Dielli mënt perëndonte. Ish e ejte e madhe, dita që ngjyejnë vezët orthodhoksët. Ngjeloja, që të shtunë, me mundime të mëdha dhe, për se liri, e shiti topin me samaroskut ¹⁾ që kish dhe, me paratë që mori, bleu njëzet ve, një shami koke, ca bakëm, dhe një okë mish. Miell mori veresie nga një burrë që ish miku i të birit, i cili shumë shpesh e besonte plakën. Kur ndezi zjarrë, plaçka nuk mejtonte gjë tjetër, po të birin që kish pesëmbëdhjetë vjet në kurbet. Dësh ta shihte dhe, në mëndjen e saj, i lutej zotit,

1) Samaroskut = plaçkë prej leshi që vlen për të bërë samarë.
e pillënka për fëmijë.

me fuqinë dhe ndihmën e të cilit ajo nuk e humbiste shpresën. I biri ja kish prerë qëkur dhe letrat dhe paratë. Plaka kurrë nuk e nxirrte nga zemra, po e kujtonte me dashurinë e parë. Tashi, i dhimbej ca më shumë se, nga që u plak dhe priste vdekjen, desh t'a shihte që të shkonte në botën tjetër e lumtur. Në kohën e fundit nuk e dinte as ku gjendej, se nuk i kish shkruar qëkur. Plaka, sa herë që shkruante meshë në kish, e kujtonte të birin dhe i lutej priftit që, ta këndonte për shëndet. Më të shumë e atyrej që vinin nga kurbeti, kur i pyeste Ngjeloja për të birin, theshin gjëra që ja sëmurnin zemrën plakë. Kush i thesh se u martua, kush se është birbo, kush se lot kartrat, pi, dhe shumë të tjera. Po plaka e priste të birin, se një gjë që mbrënda ja thesh këtë dhe zemra sikur ndjente një lumtëri të afërme.

Kur u valua uji, plaka zuri brumët dhe mi zjarrin vuri tenxheren që të zjente bakëmin.

* * *

«Pesëmbëdhjetë vjet m'u bënë në kurbet», murmurisi Kidhi duke baritur udhët e ngushta dhe të shtrëmbëra të Bukureshtit. «Duhet vajtur në atdhe, ta shoh nënën plakë, së cilës i është plagosur zemra nga hidhërimet e ndarjes së gjatë, nga pikëllimet e vdekjeve që kanë ngjarë gjatë kësaj kohe dhe nga malli që ka për mua».

Këto mejtime nuk i shkuan si era që fryn dhe nuk le as gjurmë, po iu rrënjosnë në trutë e tij dhe e mundonin çdo sekondë. Desh të largohej që nga vëndi i mërgimit, ku shkoi djalërinë. Kidhi nuk ish as pianik, as kartalozës¹⁾ dhe as birbo si e përshkruanin bashkatdhetarët, po nuk i kish ecur. Fati ish kundër tij. Vuante shumë se, çesa vjet, kish mbetur pa punë. Kriza ja kish vënë vulën. Nga këto, nuk i kish dërguar gjë plakës. Më parë i dërgonte letra, po, në përgjigjet, ajo ngaherë i shënonte për para. Ky sëmureshe se nuk kish. Kërkonte hua po nuk gjente dot as sa për jetën e tij. Tashi, kish dy vjet që kish zënë një punë më vete. Nuk i kish dërguar nga mukajeti se

1) kartalozës = kumarxhi.

desh, si-e-si, ta ndreqte punën. Zuri ta fajtonte veten dhe s'i ipte dot përgjigje për fajin që bëri. Dësh ta ndreqte fajin me çdo sakrificë. Në trutë e tij çdo sekondë ish e ëma. Ky desh ta gëzonte... ta gëzonte sa më shumë me ardhjen e tij, e ta shihte dhe një herë. Nxori pashaportën dhe, pasi la të njohurin e tij në punë, u nis për në Shqipëri, për në Korçë.

* * *

Në udhën e madhe të Korçës po rrëkllehej një haraba, prapa së cilës ishin varur disa djem. Në atë rrinin katër zotërinj.

Shamata e rrotave dhe e potkonjve të kuajve tër-hoqnë shumë të kureshtëshëm, nga të cilët është plot Korça, që u sulë nëpër portat, duke lënë punërat, që të shihnin cili u kthye nga kurbeti.

Harabaja ish e hapur, nga që ish mot i mirë me qiell të kthjellët dhe diell që, me shkëndit e tij, e ngrohte dhe rin e lagur. Mijëra vështrime e përcillnin harabanë. Çesa njohne tre zotërinjtë që ishin tregëtarë nga Korça e që kishin vajtur në Selenik për të blerë mall.

— Cili do të jetë ay djalë? — tha një plakë e shkur-tër, e thinjur dhe shumë e shëmtuar.

— Nuk e di as unë, moj gjyshe, po si kurbetlli më duket, — i tha gruaja e bukur dhe e re që ish pranë saj me llërë të përveshur.

Harabaja qëndroi përpara derëzës së Ngjelos. Një plakë që kish dalë te porta, që ish karshi shtëpisë së Ngjelos, i tha së resë:

— Ky do të jetë djali i Ngjelos, ay që ish i haruar.

— Do t'ja gëzojë zemrën së mjerës, — i tha e reja dhe shkoi me shpejtim. Si duket do të kish bakë-min në zjarr.

Kidhi i zbriti harabasë, iu afrua derëzës dhe, i mbushur me gaz që shkeli dherin prindëror, trokëlliti gjithë me atë mënyrë që trokëlliste më parë.

E ëma, kur ndëgjoi, tha me vete «kush do të jetë» dhe, me duar në brumë, dolli e hapi derën dhe, nga që nuk e njohu, i tha:

— Ç'doni, ç'kini të më thoni?

Ajo ish dhënë e tëra pas brumit dhe nuk e vuri re harabanë. Kidhi e humbi, u turbullua shumë se kurrë nuk e priste që të mos e njihte e ëma. Nga sytë i pikuan lottë. I fshiu me shaminë, e pa t'ëmën me mall dhe i tha:

— Jam yt bir, Kidhi, djali yt!

E njohu. Iu derth, e pushtoi për qafe, e puthi dhe i mbushi sytë me lot nga gazi i papritur. Kidhi ja rrëmbeu dorën që kish me brumë, e puthi dhe i tha:

— Ndjemë, nënoçkë, ndjemë, se jam fajtor përpara teje. Të lashë... të harrova... nuk të dërgova kaq kohë.

Kush, kush, po zemra e nënës është gati t'ja falnjë fëmijës së vet me çdo sekundë! Ajo dëshëron ta shohë dhe ta ketë pranë kreaturën e barkut të saj. Ngjelloja ish i lumtur që e pa djalin të rritur, të bukur dhe të shëndoshë. E pyeti për kurbetin dhe për viset e largme. Ajo desh ta martonte. Qëkur ja kish gjetur nusen dhe, ja tashi, i erdhi rasti ta plotësonte idealin e saj.

* * *

Kidhi pasi u ndërrua, u la, u vesh, dolli jashtë pa i thënë gjë s'ëmës, që po mbaronte punët e shtëpisë. Ay i mbante mënt që të gjitha udhët dhe, tashi, me gas të math i bariste sërish pas pesëmbëdhjetë vjet mërgimi. Më të shumat ishin ndërtuar me gurë. Vetëm shtëpia e tij kish mbetur ashtu siç e la kur shkoi. Ay nuk dolli të vinte në kafe, as që të shihte nonjë nga miqt e vjetër. Duke parë vobekësinë që i qarconte shtëpinë, pa i thënë s'ëmës përse del, dolli të blinte nga të gjitha që ishin të nevojëshme, të cilat i bleu dhe i dërgoi me një hamall. Dhe vetë, duke baritur në treg dhe duke parë ndryshimet, mori udhën për në shtëpi. Në këtë hop e qëndroi një burrë, i veshur me një dclloma prej shumë vjetsh të palarë e

që kish mbathur një palë opinga me xhufka, dhe i tha:

— Mirsardhe, Kidhi! Kur paske ardhur?

Kidhi u habit. Nuk e njohu. Koha i kish këmbyer që të gjitha. E pa drejt në sy dhe mezi e njohu që ish një nga miqtë e tij, i cili shumë herë i kish ndihur s'ëmës. Ay e kish mësuar që ardhi Kidhi se, në qytetin e vogël, lajmi hapet shumë shpejt.

— Mirë se të gjeta, — i tha Kidhi, — si je, a je mirë?

I kujtuan që të gjitha kujtimet e foshnjërisë dhe u ndanë.

Kur plaka i pa gjithë ato që i dërgoi i biri, u habit se ajo nuk e besonte që të kish sjellë shumë para nga që rrobat nuk i kish të shtrenjta dhe kish vetëm një baulle të vjetër.

* * *

Pas kumonimit të kabanave, njerëzit vozitnin nëpër udhët e Korçës. Më të katër anët ndëgjohej një shamatë dhe zëra... Në shtëpinë e Ngjelos po bëheshin gati dhe, që nga penxherja e katit të dytë, dilte dritë, që ku fqinjët kishin shumë vjet që s'kishin parë. E atje po bëhej gati! Atje bëhej gati Kidhi dhe Ngjeloja po vishte fustanin e ri, sakon e re dhe po mbathte këpucët e reja. Që të gjitha këto ja bleu peshqesh Kidhi, që erdhi nga kurbeti.

Plaka ndritte nga gazi dhe dukej më e re. Kur duall mbë udhë, plaka kish një qiri kulaç¹⁾ dhe Kidhi një llambadhe. Iu afruan kishës dhe u ndanë se Ngjeloja shkoi nga gratë e Kidhi nga burrat.

Lutja po vazhdonte. Prifti, i thyer nga vjetët dhe i bukur në fytyrë, me zë të ëmbël po këndonte. Kidhi po lutej dhe po falej. Vështrimet e njerëzve po

1) qiri kulaç = qiri në formë kulaçi.

e mundonin, se bëhej një shamatë nga të murmurisurit që pyesnin njëri tjetrin: «Cili është ky?».

Gratë, me të parë Ngjelon të veshur bukur, shtrenjtë dhe me të gjitha të reja, u çuditën. Ato që të gjitha e quanin Kidhin të humbur për plakën. Tashti, shumë nga to i kishin zili, se dhe ato kishin djem në kurbet dhe i prisnin me padurim. Gjithsecila e shton-te fjalën e saj për Ngjelon dhe për Kidhin; në zemër ndjenin një helm të math se mejtoheshin: «Përse të mos më vinte dhe djali im».

Kur u mbarua kisha dhe u këndua «Krishti u ngjallë», po dihet gërqisht, Kidhi bashkë me t'ëmën u kthye në shtëpi, ku i çokitnë vetë dhe u purbuletën me të gjitha të mirat.

Tërë ditën u vinin miq. E uronin plakën se i erdhi djali shëndoshë dhe e uronin Kidhin. Përnjëherej u hap shtëpia e plakës; shumë e pyesnin dhe i theshnin:

— Shyqyr që të ardhi shëndoshë!

— Perëndia të shpëtoftë! — u thesh Ngjeloja.

— Tashti dhe nonjë nuse. moj Ngjelo, të dhëntë zoti pas zemrës.

— Më rrofsh sa malet, — i përgjigjej plaka. Kidhit i qeshte buza se zëmra e tij atë kërkonte.

Shumë nëna që kishin vajza, nga që e mësuan se Kidhi u kthye me shumë para, deshnin t'a bënin dhëndër. Cilado dërgonte mbleskën te plaka. Po ajo edhe nuk kish folur me djalin për këtë punë dhe u thesh:

— Jo, moj bijë, atje nuk është dora jonë. Ata i kanë punërat e lartra. — E më zemrën e saj desh ta bindte djalin të mirrte atë që e kish pëlqyer ajo vetë, që ahorej kur i dërgonte para nga kurbeti, dhe e prishte me padurim që të kthehej.

Odesë, 1912

MALLKIMI

Ish dimër. Disa miq po rrinin pranë zjarrit, rreth e rrotull vatrës, duke pirë verë e duke ngrënë gështenja të pjekura: plaku i shtëpisë, me vetullat e dëndura e të thinjura, i ati i Mitit, sapo mbaroi të treguari ca kujtime të djalërisë së tij. Në këtë kohë, Stefani, që ish një burrë i kërrusur nga mosha, me kupën në dorë e duke u mbllaçitur, tha:

— Do t'ju tregoj për disa gjëra që kanë ngjarë këtu e shumë vjet: këto janë edhe të gjalla në zëmren time. Unë, ahorej, isha trembëdhjetë vjeç djalë. Im atë kish dy vjet që më kish vdekur. Kish shumë vjet në kurbet sa që, unë, as që e mbaj mënt mirë. E sjell ndër mënt vetëm kur më kujtohet ajo dita që shkoi për në kurbet, për herën e fundit, se më dha pesë grosh dhe më tha: «Hapi sytë, ta ndëgjosh nënën e të mësosh në shkollë!»

Ne, ahorej, rronim në Drenovë dhe kishim mësonjës një çalamal e kurrisdalë. Ngaherë, kur na e kthen-te kurrizin, që të dilte nga dera ose të shkruante gjë në dërrasën e zezë, qeshnim me shëmtimet e tij dhe shumë shpesh i nxirrnim dhe gjuhën... Në këtë kohë na pushtoi vobeksia. Nëna hoqi një sëmundje të madhe. Pastaj, se ku na u gjent dhe një gjyshe, e cila u çkarkua në shtëpinë tënë. Ishim tre veta që desh-nim të hanim. Unë edhe nuk e kisha kuptuar ç'dome-thënë nevojë se, sa herë që më hahej, kërkonja dhe kurrë nuk e ndëgjonja fjalën «s'kam», po, ngaherë, më ipte nëna një copë bukë me një copë djathë. E unë e mirrnja dhe dilnja jashtë, e hanja mengadalë se, shumë shpesh, kërkonja bukë jo se më hahej, po nga që nuk kisha ç'të bënja. Shumë shpesh mirrnja tulin e bukës, e dërmonja bashkë me djathin dhe e bënja si topë në çipin e këmishës. Herë e hanja, po më shumë ua hitnja pulave ose rabeckave se mblidheshin mi ferrat që ishin jashtë shtëpisë. Dhe kështu më dukej se mos kjo botë ish krijuar për mua. Ngaherë

brithnja më të katër anët e fshatit... Vallë ku e ku nuk vinja bashkë me shokët e mi prej të cilëve sot nuk ka mbetur as nonjë i gjallë.

Posi sot e mbaj mënt, zotërinj, atë ditë kur i vajta nënës e i kërkova të më blinte opinga prej telatini e me xhufka, se t'atilla kish fqinji ynë, i biri i plakut të fshatit. Për herën e parë ma prishi im'më, po jo me të keq. Më kujtohen lottë që ja kishin mbushur sytë e saj të kaltërt... Ajo më qetonte me sy e më thesh: «Mos kërkko gjëra që s'bëhen dot!» Po unë nuk kuptonja asgjë nga vështrimi i saj. Pak më vonë e përsërita kërkimin tim duke përpjekur këmbët, duke thirrur e duke shtrembëruar buzët: «Dua, moj, dua opinga!» dhe ja thirra të qarit. Nëna e gjorë më qetoi me fjalë të buta, duke m'i ngrohur faqet me buzët e saj. Kur i ngrita sytë e përplotura, se sjellja e sim mëje ma dboi nopranësinë, e pashë dhe më erdhi keq për të. Im'më më pushtoi në krahët e saj dhe më tha:

— Ja, u bënë dy vjet që vdiq yt atë; tani s'ka kush të na dërgojë para. Unë s'kam... se s'më mbeti asgjë.

Gjer më ahorej as që e vinja re dhe as që e vrisnja mëndjen që çdo javë kur çdukej pula, kur këndezi, kur lopa, kur kali, kur kau, kur viçi... Fjala e sim'mëje m'i shtroi këto pyetje dhe përpara syve të mij qëndroi gjendja e shtëpisë sonë. Pa i thënë as gjysmë fjalë nënës, u ngrita dhe, pasi fshiva sytë me shaminë e madhe që e mbanja lidhur në bres, dolla jashtë i mbushur me mejtime. Tani nuk mejtonja për opinga, po desha të mirrja kurbetin, se e kuptova që kishim mbetur të varfër... Në fshat, kish ardhur prej kurbetit djali i plakut të fshatit, te i cili vajta dhe fola për punën e kurbetit e i kërkova mejtim. Puna pothuajse u mbarua: E binda dhe nënën se ajo nuk desh të më linte. Unë e pandehnja se mos Vllahia ishte gjer në Korçë, prandaj dhe nuk e vrava mëndjen për para. E kur i biri i plakut të fshatit ish gati për t'u nisur, më pyeti:

- E more, a u bëre gati?
- Po ç'gatira të bëj? — iu përgjeshë unë.
- Po paratë e udhës a i ke? — më tha ay.
- Pse duhen shumë a? — i thashë unë.
- Po nonja katër napolona do të duhen, — më

tha.

E kisha kuptimin e parave; e dinja ç'domethënë çereke, mexhite, po nuk e dinja ç'domethënë napolone.

E kur i thashë, si me të drojtur, nënës për paratë e udhës, ajo mënt qau, po i kish bërë gati, se kish thirrur fqinjët, e njërit i shiti kazanin e rakisë për dy napolona, tjatrit lopën për 150 grosh dhe të tretit cjapin për 50 grosh. Kështu m'i bëri paratë e udhës, të cilat s'm'i dha mua, po djalit të plakut të fshatit... Më në fund arriu dhe dita. Im' më më vuri në një baulle të vjetër, po të shëndoshë që ish prej njeriu që pëlqen plaçkë të vyer, të gjitha gjërat e nevojëshme... Mund t'ju betohem, zotërinj, se, që nga ajo ditë e gjer më sot, kanë shkuar shumë — shumë vjet. Para se të iknja brodha më të katër anët e fshatit; u ngjita në majën e malit... vajta në Shën-Kostandin ku u fala dhe iu luta Zotit të më nxirrte faqebardhë... Kur u kthyesh në shtëpi, dielli kish perënduar dhe bagëtia ishin kthyer prej kullotës. Hyra në katua ku pashë vetëm dy dhenj e një dhi. Përnjëherë e solla ndër mënt kohen pa vdekur im atë, kur kishim shumë dhenj e dhi, tri lopë, një, me nder jush, gomar... e një kalë... E tani s'na kish mbetur asgjë. Nuk do t'ju tregoj se si më përcuall, se cilido prej jush s'besoj të mos e ketë ngrënë kurbetin. U nismë me qeraxhinj dhe pas njëzet ditsh ardhmë në Bukuresht... Djali i plakut të fshatit ish çirak në një kërcmë¹⁾, ku më futi dhe mua... Atje punova tre vjet me radhë... po ç't'ju them: kishim aqë punë sa nuk kishim nge të hanim bukë, po dhe atë e kishim me masë se, siç duket, ustaj do të kish haber nga dituria e shëndetësisë dhe na e kon-

1) Kërcmë-a = pljetore.

trollonte bukën që të mos na binte rëndë. Megji'hto, s'mund të qahem: më paguante 120 franga në mot e nga këto të zbriste 60 franga për kupa, pjata e të tjerëra që thyenja. Paratë, nga mot, ja dërgonja nënës, së për vete nuk kisha nevojë për asgjë: të gjitha m'i bente im zot. Një palë këpucë të rënda e të trasha, një palë rroba pa xhëp dhe dy këmbëshë prej ushtari. Dhe, duke punuar nga 19-20 orë ditën, shkuan të tre vjetët. Ngahera e kujtonja nënën dhe nga mot i dërgonja para si dhe letra shumë shpesh... Kur u mbaruan të tre vjetët do të mund të them se vllaçen e dinja shumë mirë dhe, nga që shokët e mij mirrin më shumë rrogë, një ditë i thashë ustajt që të ma shtonte. Po ay m'u përgjegj me grushte në kuris e me shumë të shara që nuk i zë kalemi. Dhe kështu e lashë punën e me pesë franga në xhëp, që kisha mbledhur prej bakshisheve zura t'i nëmëroj sokakët e Bukureshtit. Një ditë, kur s'më kish mbetur asnjë pesësh dhe nuk kisha vënë në gojë erën e brumit, më doli një punë më e mirë nga e para. E quajta veten të lumtur dhe fillova nga puna me zell. Nënën nuk e harronja; i dërgonja ngahera dhe, nga që e kisha rrogën më të mirë, i dërgonja çdo muaj nga dhjetë franga. Kishte shkuar mjaft kohë kur më pushtoi një lakmim për paranë: nisa të kursenja dhe për nënën. I kisha harruar që të gjitha të shtëpisë dhe as nëna më lottë e saj, as lumi i fshatit, as mali, as koha e foshnjërisë e as katoi nuk po ma largonin maninë që kisha për paranë. U kisha zili të pasurve, dhe desha, me doemos, të bëhesha i pasur.

Kishin shkuar dhe disa vjet. Në këtë kohë munda të ve mënjane njëmijë franga. Isha mjaft i shkaf-të, e dinja ku dilte bakshishi, se e kisha kuptuar të fshehtën e mjeshtërisë. Në këtë kohë e lashë punën dhe hapa në vete një kërcmë të vogël. Puna më vajti mbarë. Që nga dita që u bëshë usta, nuk mejtonja asgjë tjetër, po vetëm: para, para. Vjetët shkonin e unë dita-ditës ngrihesha si nga paratë ashtu dhe nga

nderi, se këto të dyja janë lidhur shumë pikë në mes të tyre. Në bangë kisha me mijëra franga, kisha shumë para në befara ¹⁾ e me fajde; kisha pesë fabrika të alkolit; kisha sjellë nga Korça e nga fshatrat djem me dyzina, që i paguanja nga pesë franga në muaj e që u bënja rroba pa xhepa, se e kisha kuptuar «përsënë». I mundonja, ua zbrisnja jo vetëm gjysmën e rrogës, po të tërë dhe, më në fund, po të më kundërshtohesh nonjë si më i squar, e hitnja jashtë të çveshur e pa pesësh në xhep...

Dhe kështu u bëshë milionar... Tani, ata që nuk më flisnin me gojë kërkonin të më bënë dhëndër dhe më bënë. Besoj ta dini. Mora të bijën e Rapi Mburros... Më dha 200.000 franga prikë, se paraja e merr paranë. Puna sa vinte më shtohesh. Me gruan rronim të lumtur dhe na dha zoti një vajzë e një djalë. Plakën e kujtova vetëm pas gjashtë vjetsh; në letrat e mia nuk më përgjigjej asnjëri. Më në fund i shkrova priftit, që m'u përgjigj se im më kish katër vjet që kish vdekur. Nuk e vrava dhe shumë mëndjen se tani kisha të tjerë të dashur; përveç parave desha gruan, po ca më shumë fëmijën. Para kisha shumë, po kurseja ca më shumë dhe tani e kuptoj se paraja qënka po si ujët e kripur prej të cilit sa më shumë të pish, aqë më shumë të shtohet etja. Po, në këtë botë, asgjë nuk mbetet pa ndryshime; m'u sëmur djali prej ethesh, pastaj prej tifoje, dhe, sado që rreth e rrotull tij bëra fortesa prej floriri, prapë nuk e shpëtova dot nga kosa e vdekjes... E desha pa masë... Po shkoi dhe kjo. Pas kësaj plage, në një behar, m'u mbyt vajza kur lahej në Tunë. Që të mos e zgjat, pas ca vjetsh puna m'u shtua ca më shumë. Ime shoqe, nga merakë që humbi fëmijën, u sëmur dhe iu çpif oftikë. U mundua, u dergj shumë e më në fund vdiq. Kishin shkuar dhe shumë vjet. M'u duk sikur u qetuash: vallë ç'gjë nuk harron njeriu i mjerë? Punërat i kisha shitur dhe rronja i çkujdesur me disa milionë kapital duke u

1) në befara = hua me hipotekë.

zhgryer nëpër qarqet e qejfit. Edhe isha i ri, mund të them, isha edhe dhëndër se nuk i kisha mbushur të pesëdhjeta. Kisha shumë propozime për martesë. Po unë as që i shkonja ndër mënt këto propozime, se e kuptonja që një mallkim i bashkuar me një uratë më ndiqte pas, pa mos më lënë vetëm asnjë minutë. E kuptova se këto ishin të nënës: Urata m'u dha kur ajo shiti kazanin e rakisë, lopën, cjapin, kur m'i dha të katër napolonat duke më puthur, duke më thënë: «Hapi sytë!» Sytë i hapa, u bëra i zoti, fitova shumë para, po nuk i hapa dot sytë që të mos harronja nënën, e cila e shkoi jetën në nevojë dhe fundin e saj në uri... Shkuan dhe shumë vjet që i kalova duke shëtitur botën. Vallë ku s'vajta? Në Paris, në Romë, në Milano, në Lago Mazhore, në Londër, në Berlin, në Svicerë dhe në Monte-Karlo ku, unë këna,¹⁾ desha t'i hithnjam një kartë të gjitha paratë që kisha fituar. Po, për të fituar para kisha uratën e nënës dhe ngahera fitonja, po nuk gjenja qetësinë e prehjen e shpirtit. Bukuritë e Parisit, operat e ralla, romansat e pëlqyera, orkestrat melodike, shantanët pa cenzurë dhe gjithë zbatvitjet, ku tymosen të pasurit e dheut, më dukeshin të mërzitëshme. As gjëkund nuk më rihej dhe vinja, si nonjë kurbat, që nga njeri qytet te tjetri. Ky ish mallkimi i nënës që ma dërgoj që nga fshati në orën e vdekjes, kur nuk kish ç'të hante; kur nuk kish se çush t'ja shuante etjen. Më në funt, pasi u mejtua, e gjeta për të mirë dhe erdha këtu ku jamë, pranë fshatit; pranë vëndit ku çlodhen eshtrat e asaja që më dha uratën, kur më nisi për në kurbet, po të cilën unë e harrova. E ajo nga vuajtjet e pësimit që hoqi, në orën e fundit, më dërgoi mallkimin. Mos pandehni se nuk kam vajtur në fshat; U poqa me priftin, e pyeta, e kërkova varrin e saj, po nuk e di asnjëri. Dhe prifti nuk është i pari. Koha i ka ndryshuar që të gjitha.

Më të mbaruar tregimin, Stefani rrëmbeu pallton,

1) këna = koprac.

shkopin dhe shkoi. Miqtë ja thirrë këngës dhe pinë verë se ky tregim i futi në mbretërinë e pikëllimit.

Odesë, 1912

KOLENDRAT

Në Katavaroshin e Korçës, andej nga shkon lumi, kundrejt kishës së Shën-Mërisë, ishte një shtëpi e ndërtuar me plitharë, e mbuluar me qiramidhe të vjetra e të thyera, prej gurëve që hithnin djemkat. Kur binte shi ose tretej dëbora, pikonte në odën e vetme e pa tavan, ku, përveç magjes së vogël në të cilën, nga që s'kishin miell, kishin shumë kohë që nuk kishin gatuar, nuk kish asgjë t'jater... Po, se mënt harrova: mi murin e nxirë nga tymi që përhapëj kur nuk hiqte oxhaku. ish varur një fotografi; kjo tregonte një burrë të hieshëm të cilin, siç thësh Rina kur e pyesnin, e kish burrë. Ky nuk dukej të ish më shumë se 30 vjetsh, po kish plot dhjetë vjet që nuk kish dhënë as nonjë shënjë gjallimi që nga kurbeti. Më parë ay dërgonte letra dhe para... E tani, kur e pyesnin fqinjët për të, ajo u thësh:

— Do të ketë vdekur në kurbet.

Rinës i kish mbetur një djalë i mbarë, që e quanin Pilo dhe që ecte të dhjetin mot. Rina e desh shumë Pilon, vdiste për të dhe rronte vetëm për të, se desh t'a rritte e t'a martonte duke shpresuar se ahorej do të rronte e lumtur. Dhe kështu Rina duke larë rrobat, portë-më-portë ku kish të njohur, paguhej njëqin para, një çyrek me bukë dhe një misur me gjellë. Këto i hante bashkë me djalin, me shpresën e saj.

Kështu e kish shkuar këtë kohë të gjatë, që nuk i dërgonte i shoqi. Po më parë ajo rronte e lumtur, se i shoqi i dërgonte mjaft para. Siç thoshnin fqinjët, ay e desh shumë Rinën. I shoqi i saj ish një i ardhur nga Vakëfet dhe kish bërë mjaft kurbet në Ianaros, ku kish vajtur që i vogël. Kish sjellë shumë para, që i

kish fituar duke punuar me mushka. Kur u kthye ish 30 vjeç. Blevi një shtëpi në qendrën e qytetit. Solli t'ëmën nga fshati. E mbushi shtëpinë me gjithë të mirat. U martua me Rinën që e pëlqeu kur e pa një ditë që zgjati kokën nga porta gjysmë e hapur. Ndenji gjashtë muaj sa porositi Pilon, mori hua katër lira, prej të cilave një ja la së shoqes dhe shkoi në kurbet.

Po dhe prindërit e Rinës rronin mirë. Ata kishin mjaft gjë dhe një dyqan. Me këto fitime e rritnë Rinën, e martuan dhe mundnë t'i japin një qind napolona prikë e t'ja bëjnë pajën si më të mirës. Si e martuan vajzën, iu prish puna dhe humbisnin nga ditë, se kishin hyrë në fajde. Kur vdiqnë i lanë Rinës shumë borxhe, të cilat ajo, pakngapak, i paguante se nuk desh t'ua linte më qafë prindërve.

Lumtëri për Rinën ishin vetëm vjetët e para të martesës, po dhe në atë kohë ajo kurdoherë ndodhej në zi, se i vdiq i vjehri, e vjehra, i ati, e ëma. Po dobare nuk kish nevojë, se kish me se të blinte ushqim, të vishej e të mbathej. E kur i shoqi më nuk i dërgonte, zuri të futej borxh dhe, pakngapak, aq iu shtuan borxhet, sa u shtrëngua ta verë shtëpinë penk. Pastaj shiti dengun e tërë që e kish gjer në tavan dhe më në funt, nga që iu shtua shumë fajdeja, ja shitnë shtëpinë. Që ahëre u mbajt në Katavarosh, në atë shtëpinë e vogël, për të cilën paguante dy qind grosh qira në mot... «Kështu qënka thënë për mua», thesh nga-hera Rina dhe, sadoqë dëshpërohej për fatin e saj të keq, kish një shpresë të fshehtë: «Ja, sa të më madhohet djali, pa...».

* * *

Ora kish vajtur pesë. Qielli ish mbushur me re dhe po binte një dëborë e hollë. Nuk ish dhe aqë ftohtë. Rina nuk ish në shtëpi, e djalit sepse nuk i rrihej mbrenda. Të nesërmet ish dita e kolendrave. Piloja i kish baritur që të gjitha udhët. Kish lozur nga sheshi i çezmave të arave.¹⁾ Kudo që shkonte shihte

1) Ishin 4 çezma. Quhesh sheshi i çezmave të arave vëndi ku sot në Korçë është Biblioteka dhe quhet kopshti Th. Gërmenji.

djem në vërsën e tij, më të mëdhenj e më të vegjël, me çomage në dorë. Ata ishin veshur me rroba të reja, me breza të bukur, me festë të vëna në kallëp dhe ca ishin me kapella. Që të gjithë mbanin fort çomaget në dorë dhe dukeshin shumë të gëzuar në fytyrë, e cila u ish skuqur prej thëllimit.

Piloja, pasi shëtiti mjaft, u kthye në shtëpi. Rëmoi më të katër anët duke kërkuar nonjë çomage, po nuk gjeti dot dhe dolli sërish jashtë. Te çipi i udhës i hodhi sytë duke dashur të shohë t'ëmën, së cilës do t'i lutej t'i blinte çomage. Po ajo nuk dukej. Fytyra i ish skuqur aqë shumë, sa nuk i çquhej vula e pikëllimit. Pa dhe një herë a mos e shihte t'ëmën dhe mori udhën për nga Mitropolia. Hyri në oborrin e kishës dhe nga sytë e tij dukej sikur se kë kërkonte. Po ay nuk kërkonte asnjëri, se shoqët i kish në Kattavarosh e e ëma ish në shtëpinë e Zagros, ku bënte punët nga muaj. Piloja e dinte që nuk kish asnonjë afëri, se sa herë që e kish pyetur t'ëmën për t'anë, ajo i kish thënë se ay kish vdekur në kurbet. Dhe ky u kish zili atyre që kishin baba, se ata, pas mëndjes së tij, i kanë të gjitha të mirat.

Plot mejtime për varfërinë e tij, u fut në hajatin e kishës dhe ndënji mi sofatin e gurtë, mi të cilin kishin bërë një yç e një damë¹⁾. Ra në mejtime që nuk bëri as dolloma e as këpucë të reja. Në këtë hop, përpara tij shkoi një djalë i veshur me dolloma të re prej basmeje, me vija të mëndafshta. Ish ngjeshur me një bres të bukur, xhufkat e të cilit valonin kur bariste. Festën e kish vënë mënjanë dhe i rrinte pak si e madhe, se sapo që e kish vënë atë ditë në kallëp. Pallton e kish prej coheje dhe me jakë me qime. Këpucët i kish prej konduraxhiu e me llastika anës e në dorë kish një çomage nga ato të tavanxhinjve, që janë të lyera me dy ngjyra e që duken si ngjyrat kom-

1) Lodra që losnin djemtë e shkollës në atë kohë në sofatet e hajateve të kishave.

bëtare. Piloja me ta parë djaln, u ngrit më këmbë, iu afrua, se u kujtua që s'ka çomage, dhe si me turp, po përnjëherej i tha duke ja vështruar çomagen me lakmim:

— Nëma mua këtë çomage, — dhe e zuri me dorë, — ti mund që ke tjetër në shtëpi.

Djali i veshur mirë e pa Pilon me sy të keq, ja hoqi çomagen nga dora dhe, nga që ish i veshur me një dolloma të grisur e i ngjeshur me një rryp pël-hure, me këpucë të grisura e më të mëdha nga këmba, u trëmb e i ardhi ndot, se iu duk sikur e shtiu poshtë mburësinë e të pasurit. U sul me vrap që të mos ja rrëmbente çomagen Piloja. Po kur e pa, se ky nuk luajti nga vëndi, u kthye dhe i tha:

— Në pazar ka shumë çomage, ka sa të duash. E shtrëngoi çomagen më fort dhe shkoi me sulm duke kthyer kokën, se kish frikë mos e ndiqte. Kur arriu te porta e kishës e pa Pilon dhe zuri të priste t'ëmën që të dilte nga mbrëmësorja e t'i blinte vula dhe simite.

Piloja, me të ndëgjuar fjalët e djalit të pasur, u pikëllua shumë dhe u pendua që e shtiu veten aqë poshtë përpara atij «afendikoçkës». Dolli nga hajati, e la oborrin e kishës dhe mori udhën nga Shën-Thanasi. Shkonte si i lënë me duart në xhepet, që i kish copë e kothere. Në këtë hop i ra erë bukë të ngrohët dhe qahi. Kjo erë ja qëndroi këmbët përpara furës së Tondozit, ku pa plakun e zeshkë e të thinjur, që ish edhe mjaft i mbajtur, që po nxirrte bukët me qiçra dhe tepsitë me qahi. Era e bukës ja shtoi urinë dhe zuri t'ja lëngëzojë gojën. Piloja i nguli këmbët, i hodhi sytë në furrë dhe, nga që kish tërë ditën pa bukë, desh t'i kërkonte një copëzë një gruaje që ish e veshur me sako¹⁾ me millo²⁾ të ngrënë e me dy shami. Siç dukej kësaj do t'i kish vdekur i shoqi, ose i biri, ose i vëllai dhe do t'a kish marrë mandatën nga kur-

1) sako = një lloj xhybeje.

2) millo = qimja e sakos.

beti e do të kish shumë vjet që do të mos e kish parë. Kështu u mejtua Piloja për gruan. Po, kur u lirua prej mejtimeve e iu afrua gruas që t'i kërkonte, përnjëherej iu kujtua «afendikoçka», e pa dhe një herë gruan, i pa dhe një herë qahitë dhe shkoi, duke rendur, për në shtëpi, pa mos vënë re as djemkat me fytyra gazmore, as gratë me qahi e me kuleçë, as çirakët me trajstat plot, as dëborën që zuri të binte përsëri e as të ftohtët që i futej që nga këpucët e mëdha e që i përhapej në tërë trupin e tij. I pikëlluar dhe me zëmërim i ra me këmbë derës së vjetër të shtëpisë, ku rronin, dhe e hapi pasi hoqi gjalmin, me të cilin ish lidhur rezdeja. Hyri brenda dhe u shtri te këndi, mi shtresën e nxiruar dhe, nga që nuk kish as çomage, as qahi, as kulaç e as bukë, zuri të qajë.

Kështu shkoi shumë kohë. Ky po priste të kthehej e ëma, së cilës do t'ja thësh që të gjitha dhe do t'i lutej t'i blinte një çomage, se dhe ky desh të vinte portë-më-portë ditën e koledrave.

* * *

Dëborë s'kish të pushonte. Dhenë e kish pushtuar një çarçaf i bardhë e i trashë gjer më nonja katër gjishtërinj. Ish mjaft ftohtë dhe nuk frynte as nonjë erë. Rina i kish mbaruar gjithë punët dhe, kur kish kohë që ish errur fare, me fenerin në dorë u kthye në shtëpi. Kur hyri, e gjeti derën hapur dhe Pilon që po flinte. Ajo, për hatrin e ditës së nesërme, përveç çyrekut me bukë dhe misurit me gjellë, kish sjellë dhe njëzë qahi, të cilën u mejtua t'a linte për ditën e Kërshëndellave. Ajo ish lodhur e këputur. Shtëpia ish e paspërnditur. Asaj i pëlqente paqllëku dhe nuk e duronte dot paregullën. Kur mbaroi se spërndituri e ndezi zjarrin e me kotheret e coprat, që kishin mbetur, bëri një përshesh me fasule, e sqoi djalin, i cili mori u ngrit dhe hëngër bukë. E ëma e kuptoi që ay kish qarë dhe e pyeti:

— Pse ke qarë, o biro?

— Se nuk kam çomage, moj nëno, — dhe ja tregoi që të gjitha s'ëmës.

Ajo i dha durim duke i thënë se do të ketë mot. I dhimbte zëmra që nuk mundte t'i blinte, se e kuptonte sa e shtrenjtë ish për Pilon çomageja. E dinte ajo që dhe ay duhej të gëzohej, të dilte portave me shokët që të kërkonin kolendra e të këndonin këngën e kolendrave. Me gjithë dëshirën e madhe që kish, nuk mundte t'ja plotësonte se nuk kish me se t'ja blinte. Ajo nuk kish me se të përbuletej ditën e shënuar e jo të blinte çomage. Përnjëherej iu kujtua dita kur i kish blerë çomage, po ahorej Piloja ish aq i vogël sa nuk kuptonte asgjë. E për fatin e saj, as nga Zagroja, ku punoi katër dit, nuk ja paguan. Ajo, me ato para, do të mundte të mbaronte njëmijë halle. I bënin për të marrë dhjetë *gros*h. Ata ja lanë t'ja paguanin tjetër *herë*. *Atyre* u dukej se mos tërë bota kanë si dhe ata. Nuk e dinin se Rina nuk kish me se të përbuletej, se nuk e kishin njohur varfërinë. *Atyre* u dukej se Rina do ta kish sofrën të shtruar me të gjitha të mirat; djalit do t'ja mbushte xhepat me arra, me gështenja dhe te dera e kishës do t'i blinte bukësheqeri. Dhe qahinë do të mos ja ipnin, po ja dhanë se u ndoht në ashef kur i suallë nga furra dhe u ardhi turp.

Rina, pasi e ndëgjoi historinë e Pilos, ra në mejtime, e pushtoi të birin në krahët e saj, e puthi dhe, duke u falur, i tha:

— Falu, biro, falu se Perëndia është e madhe dhe do të na ndihmojë. Dhe ranë të flenë. Rina u mejtua dhe shumë, se iu kujtua koha e shkuar, kur ish e lumtur te prindërit e saj. Po i mori përsipër të lodhurit dhe e zuri gjumi. Piloja ra pranë s'ëmës. Kur i hapte e kur i mbyllte sytë. Shihte t'ëmën që ish e mejtuar, nuk i fliste, po mejtohej për qahitë, për «afendikoçkën» që s'ja dha çomagen, prapë shihte t'ëmën, që e kish zënë gjumi e po gërindej. Me shumë mundime mezi e zuri gjumi dhe pa ëndër sikur një plak i thinjur i solli mish të pjekur. qahi, kuleçë dhe një ço-

mage të bukur. Në këtë hop u squa e ëma, Piloja po thërriste nga gazi, dhe i tha:

— Ç'ke shpres-o, gëzim-o, ç'ke që thërret?

— Nëno, pashë, pashë shumë gjëra, shumë... po ku janë? — dhe i mbylli prapë sytë.

* * *

Kur hapi mëngjezi i Kërshëndellave, Rina ish ngritur. Këtë ditë nuk kish punë jashtë shtëpisë. E sqoi Pilon. I veshi një dolloma tjetër, sado të vjetër e të arnuar, po të pastër. I mbathi një palë çorape të reja që ja kish bërë me kursimet. I mbathi një palë këpucë të tjera, që ja kishte falur një zonjë e mirë e që ishin pak të vogla. Kësaj zonje i vinte shumë keq për Rinën e për Pilon, se dhe ajo kish mbetur pa baba e kishte hequr shumë sa ish e vogël. Rina vetë veshi fustanin e dytë, që e kish fare të ri se e kursente, sakon me nafe¹⁾ të krojtur prapa dhe mbathi këpucët më të mira që kish e që ishin të çpuara në shuall. që ku i futej dëborra dhe të ftohtit.

Kur ish e veshur, vajti te polica, mi të cilën ish konizma, mori dhjetshin e fundit, që e kish mbluar, mori Pilon pas dore dhe shkoi për në kishë. Kur hyri, bleu një pesësh qirinj; ndezi njërin sapo hyri, me evllava të madhe duke bërë kryqe. Pastaj u afrua, në mes të kishës së grave, ndezi qiririn e fundit dhe iu afrua kafazeve. Që atje me kujdes e me besim të math ndëgjonte zërat, të priftit e të dhiakut, që këndonin meshën, e të psalltërve që këndonin, njëri pas tjetrit, psallmat. Sado që nuk kuptonte gjë, sytë dhe veshët i kish drejtuar nga Jodhima ku shërbeheshe mesha. Sa herë që e shihte priftin me dhjakun që bënin kryq dhe ajo e bënte tri herë e kur mbaronte, e vinte dorën në zëmër, duke thënë «Shpëtona o Zot!» Piloja rrinte pranë s'ëmës dhe e shihte me çudi fytyrën e saj të verdhë. Ngjyra i kish humbur fare dhe dukej sikur bëhej gati të qante. Dhe ay, sa herë që e shihte t'ëmën që bënte kryqe, bënte ca kryqe të më-

1) nafe = qimet e sakos.

dha duke thënë «O Zot, o Zot!» Me këto fjale ay i kërkonte ndihmën Zotit.

E zeza Rinë falej, lutej, bënte kryqe, vështronte priftin e dhiakun, ndëgjonte psalltrit, vështronte konizmat, kandilet e fytyrat e grave të gëzuara që i kish pranë. Ato shumë shpesh harronin të faleshin se kishin fjalime në mes të tyre se gjithsecila tregonte për letrën që kish marrë nga kurbeti prej djalit ose burrit; tjatra tregonte për qahitë e për kuleçët, që i duallë shumë të goditur; tjatra tregonte për qiqrën, që nuk i ardhi mirë e që nuk iu goditnë qahitë dhe shumë fjalime të tjera. Këto e pikëllonin pa masë Rinën, se ja lëndonin plagët. Prifti vazhdonte këndimin e dhiaku, duke lidhur e duke zgjidhur brezin, me zërin e tij të fortë ua çkëputte fjalimin grave për ca kohë. Rina vështronte fqinjët dhe mejtonte fatkeqësinë e varfërinë që e rrethonin: mejtohej që nuk kish me se të përbuletej se në shtëpi kish vetëm një gjysmë çyrekë bukë dhe njëzë qahi e një misur me groshë pa vaj e asnjë copë mish.

Po kush e kujton mishin kur nuk ka bukë sa të ngopet?

Mejtohej që nuk i kish mbetur asnjë pesësh që t'i blinte, dobare, një simite djalit, se atë që ja dhanë kusur prej qirinjve e hodhi në dhisk ku dolli epitropi. Mejtohej dhe shumë gjera, të cilat e munduan të shkretën sa kohë që zgjati mesha. Kur u mbarua, mori naforë dhe dolli.

* * *

Njerëzia po dilnin me tërbim dhe po e shtynin Rinën e mjerë. Ata shtyheshin pa mëshirë posikur i kishin futur me pahir dhe me padurim prisnin fundin. Rina priste radhë dhe, me Pilon pas dore, dolli në oborrin e kishës, ku djemkat tregëtarë thërrisnin me zë të lartër: «Vula, mende dhjetë në pesësh!... portokalle... portokalle... e mollë të mira!... Gjevrecka... gjevrecka!...» (thërriste Tafili me perustinë¹⁾) e tij të bukur në dorë.

1) perusti = kamjet

Pilos i kullonin jargët nga gjithë këto mirësira që shihte te porta e kishës. Ay me zë të ëmbël i thesh s'ëmës t'i blinte, po ajo nuk e ndëgjonte se dhe ajo mejtonte gjithë për ato, desh t'i blinte, po nuk kishte me se. Zembrën e kish të skërfitur e mëndjen si të lënë.

— Blimë, nëno, blimë simite... gjevrecka, — i thesh Piloja. Ajo shkante pa kuxuar t'i hedhë sytë mi sepetet e tregëtarëve që përpiqeshin kush të shesë më shumë. Më në fund, doli në xhade. Piloja, i pikëlluar e, duke murmurisur, e zuri t'ëmën pas çipit të sakos dhe bashkë me të u drejtua në shtëpi.

Rina, me të hyrë mbrenda në odë, u drejtua te kornizma. bëri dy kryqe të regullta, ra mbë gjunë, bëri dy metanira. i ra krahërorit me dorën e djathtë, bëri dy kryqe të tjera dhe tha:

— O Zot, o Zot, ndihmomë mua fatzezës, kërcures dhe nëma fucinë e nevojëshme sa ta përkëmb, ta drejtoj në një udhë të mbarë djalin!

Piloja nuk i ndëgjoi fjalët e s'ëmës. Ay nuk u mbajt, iu afrua, ra mbë gjunjë pranë saj dhe, me zërin e tij të hollë, tha:

— O Zot, o Zot! Ndiha, o Zot!

Me këto fjalë ay i thesh shumë Zotit: i thesh që t'i ipte ato që kish nevojë, po që nuk dinte se si t'i kërkonte.

Rina e mbaroi lutjen, u kthye nga Piloja, e pushtoi në krahët e saj të ligur po të ngrohtë dhe, duke e puthur, i tha:

— Shpresa ime, ti do të ma zbardhësh pleqërinë!

Odesë, 1911

DHURATA E MOTIT TË RI

Një ditë, Thina, i tha kushëririt të saj që ish tregëtar i vogël në Korçë:

— Gjithkush ka hallet e tij... Ah, unë e zeza, unë korba që s'ka të m'i dalë nonjë kësmet çupës. Ja, e bija e Ristos, që ish vërsnike me çupën time, u martua që-

kur dhe bëri djalë... S'ka mbetur as nonjë nga vërsniket e saj pa martuar... Ah, unë e zeza që nuk kam se kush të më kujdeset.

— Mos u bëj merak, moj e bekuar, se çdo njeri ka kësmetin e tij. Ku ta dish se ku i fshihet kësmeti Marës, — iu përgjegj Lipi.

— Vërtet ashtu është... po dhe kësmeti duhet kërkuar se pa i shtyrë drutë nuk ndizen, — i tha Thina.

— Mos u bëj merak... çupën e ke si dritë... shtëpresë ¹⁾ pa shoqe dhe kësmetin do ta ketë të mirë.

Biseduan gjer-e-gjatë mi këtë punë dhe, më në fund, Lipi iu zotua Thinës t'i gjente një dhëndër të mirë.

* * *

Që nga kjo ditë, Lipit iu bë merak kjo punë dhe ditë-natë për këtë gjë mejtohej. Thina kish të drejtë se çupa iu bë për mi njëzet vjeç... Ajo vetë ish grua e ve dhe pa përkrahjen e nonjë burri. Djalin mezi e kish pesëmbëdhjetë vjeç. E ajo, me të ardhurat e paka, që i mbenë nga i shoqi, mezi e ngryste motin. Po dhe vetë ish punëtore e mirë: punonte çorape, qilime, levenxe, e me këto fitime e mbante mirë shtëpinë, i bëri Marës pajën dhe i mbante, si çupën si djalën, të veshur e të mbathur.

Lipi, pasi i shkoi ndër mënt gjith këto, ra në mejtime të thella; dhe pinte njëren cigare pas tjetrës. I solli ndër mënt gjithë të njohurit që kishin djem për të martuar po asnonjë nuk ujdiste për këtë vlesërim. Më në fund, iu kujtua Kola i Gjokës. Ky kish një djalë të mbarë në Amerikë. Dhe një ditë, kur mejtohej se si ta fillonte punën, ç'të shohë! Hyri Kola, e përsëndoshi dhe ndenji. Pasi pinë nga një cigare, ay i tha Lipit:

— A e di përse kam ardhur? Më ngjan se ti e ke t'enden Thinën. Ti e di që unë kam një djalë në Amerikë. Ay kërkon të më vijë për t'u martuar dhe më shkruan që t'i gjej nuse. Marën e Thinës ma kanë lëvduar shumë. Prej teje e dua të ma mbarosh këtë punë.

1) Shtëpresë = amvisë.

Folë dhe shumë... Kur u poqne pas disa ditësh, e bënë për hair dhe e vlesëruan Marën me Raqin, pa e caktuar ditën e dasmës.

* * *

Kishin shkuar tre vjet e ca që nga dita që Mara u vlua. Të gjithë, farefisi e të njohurit e kishin uruar, si dhe krushqia i kish shkelur shtëpinë. Çdo mot të ri, i ati i Raqit i shpinte Marës peshqeshe. Po Raqi, sadoqë i kish dërguar disa dhurata, më s'kish të vinte. Nga këto hidhërime, Mara ish tretur fare. Ja, po afrohej dhe moti i ri, i katërti pas vlesërimit, po këtë mot Mara e kish humbur shpresën për ardhjen e të vluarit, se ay, në letrat që dërgonte në shtëpi, shumë shpesh harronte t'i shkruante të fala dhe kurrë nuk kujtonte për të ardhur. E këto hidhërime ja shtonin dhe bisedimet e disa strinove¹⁾, që thoshnin: «Këta djaj kanë nga nonjë morozhe, pa harrohen e nuk kujtojnë as prindër e as të vluara e as gratë me fëmijën». Këto i shkonin ndër mënt dhe s'ëmës së Marës. Një ditë ja hapi zemrën s'emtës dhe i tha:

— Ç'eshtë kjo e zezë? Sa s'e kisha të vluar, kisha një merak, po kisha dhe një shpresë, kurse tani kam shumë merake, po nuk kam asnjë shpresë. Kam frikë se mos i kanë bërë magji që të mos kthehet në atdhe.

— Nuk e besoj t'i kenë bërë magji. Po ja se ç'të bësh? — i tha e emta. — Kam ndëgjuar se ajo kisha e Barçit bën çudira. Shpjere atje çupën dhe ndisni nga tre qirinj të mbëdhenj, ndisni dhe nga tri kandile, e çupa le të falet me gjithë zemër, le të bëjë disa metanira dhe le t'i lutet Shën-Kollit të ndërmjetojë përpara Shënmërisë e Zotit Krisht që ta kthejë të vluarin në atdhe.

Thina nuk e shtyri këtë punë: më të nesërmet vajti dhe u fal të Kisha e Barçit bashkë me të bijën dhe bëri ashtu siç e mësoi e emta.

1) strino = llafezanet, që bëjnë intriga.

2) morozh = (rusizëm) e dashura.

Raqi e kish harruar që ish i vluar. Ay, në qytetin e tij, ish njohur me një spanjolle të bukur dhe me të e shkonte tërë kohën e lirë. Nga ky shkak i kish rralluar letrat. Vërtet e kish njohur Luçinë. Në letrat që i shkruanin për të vajtur në atdhe, u përgjigjej që do të vonohej dhe ca vjet se kish punë me fitime të mira dhe i vinte keq ta prishte. Ky ish i dehur prej dashurisë dhe i kish harruar: nënë, baba, të vluar dhe atdhe. Vetëm Luçia ish për të. Dhe një herë, ditën e Shën-Endreut në qytetin e afërmë, bëhej një panair. Luçia iu lut të vinin mirëpo, Raqi kish shumë punë. Iu lut shoqëve, po asnjë prej tyre nuk desh të vinte në këmbën e tij. Luçia u zemërua, qau dhe shkoi e zëmëruar. U pikëllua pa masë dhe, kur po rrinte kështu, i erdhi një shok dhe i tha:

— Çapu, Raqi, shko në panair e bëj qejf, pa e shoh unë punën.

Raqi u gëzua pa masë dhe me rrëmbim vajti në shtëpinë e Luçisë. Ajo nuk ish në shtëpi. Mori trenin dhe vajti në panair. Po ç'të shohë! Në sallën e restorantit po rrinte Luçia me një Irlandes, po qeshte e po koxëtonte me të. Ndenji pranë një tryeze, larg tyre, iu ndesnë rrëmbat... u furos dhe u ngrit më këmbë me qëllim t'u sulej e t'i zinte për grykë. Në këtë hop iu ndëgjua një zë i hollë e i butë: «Po mua ku do të më lesh?» dhe prej tymit të cigares u thur fytyra e së vluarës. Përnjëherej iu ftoh gjaku... rrëmbeu kapellën... u kthye në dyqan dhe, përnjëherej e pa vonesë, filloi përgatitjet për të vajtur në atdhe.

Kolë Gjoka kot priste letra nga i biri. Thina me Marën ishin në merake të mëdha. «Ja, — thesh Mara, — ditën e Shën Vasilit mbushen plot katër vjet që jam e vluar dhe s'duket asnjë shenjë që të vijë». E më të nesërmet

prisnin krushqinë me dhuratat e motit të ri. Këto i kishin bërë gjithë përgatitjet dhe po prisnin. Po kur krushqia ish in gati të niseshin për te nusja u ndëgjua një zhurmë automobili. Fëmija, që nuk e dinë se ç'është hidhërimi, u sulë te porta për të parë. Këta u sulë mbrenda dhe thirrë:

— Myzhdenë ¹⁾ se erdhi Raqi.

Vërtet automobili qëndroi te porta e tij dhe një djalë si drita zbriti e u ngjit për në shtëpi. U puthnë... qanë e qeshnë dhe së bashku u nisnë për te nusja. Thina kërcente nga gazi e Marës i ndritnin sytë. Përnjëherej iu kthye bukuria e humbur. Gazi bën çudira.

Mara këtë mot mori dhuratën më të mirë e më të shtrenjtë.

Korçë, 1926

U NGROH KOHA

Ish dimër. Bisedonim për punërat e fshatit dhe, duke ngrënë arra, pinim verën e vjetër, të mirë e aromatike. Fjalët zgjateshin, se njeriu, kur bën qejf, tregon dhe shumë ngjarje të interesatëshme. Fjala ish mbi punën e kurbetit; po qanim hallin e udhëve të këqia të asaj kohe, kur njeriu duhej të shkante me kalë gjer në Stamboll. Një plak, që i tregonte ngjarjet e fshatit shumë bukur dhe që psallte çdo të diel ose të kremte në kishë, na tha:

— Po flisni shumë për punërat e kurbetit dhe kujtoni vetëm ata që arrinë në kurbet dhe që u kthyen. Siç duket do të mos e mbani mënt punën e Lace Kobos?

U ndodhë disa që e kishin ndëgjuar këtë ngjarje, po asnjëri nuk e mbante mënt mirë këtë punë. Iu lutmë plakut të na i tregojë, e ay, pasi mori një qëndrim me rëndësi si kadiu kur bëhet gati të gjykojë njeri, pa rreth e rrotull, duke dashur të na thotë «ndëgjomëni me kujdes», na tha:

— Kjo punë ka shumë, shumë vjet që ka ngjarë.

1) myzhdea = peshqeshi që jepet në rast sihariqi.

Unë ahorej isha djalë i vogël. Gjok Koboja, i ati i Laçes, kish shumë vjet në Stamboll ku, siç thonë, e vrau një kapadai turk. Në shtëpi i kish mbetur e shoqja me djalin që ish i vogël. Këta hiqnin shumë keq, se nuk kishin kush t'i përmbante. E veja e Gjokës me njëmijë mundime e rriti djalin gjer u bë katërmbëdhjetë vjeç: tërë dimrin e dërgonte me rregull në shkollë, dhe tërë beharin e mirrte me vete nd'arë. Fqinjët zunë ta këshëllonin nënën e Laces që ta dërgonte djalin në kurbet, ku do të fitonte shumë para dhe do t'i dërgonte ta mbante. Këshillat e fqinjëve ishin të mira dhe të ëmbëla. Dhe Laces na i ish ngritur mëndja se kish parë disa djem që ishin kthyer nga kurbeti, që ishin veshur mirë, që kishin sahat të argjendë, rroba e këpucë të bukura.

* * *

Ish duke gdhirë e martë. Më të nesërmet — kali ish gati ta shpinte Lacen në Korçë, që ku, të mërkurën në mëngjes, nisej karvani për në Stamboll. Në shtëpinë e Laces qe mbledhur afëria: Hanin, pinin e këndonin dhe, duke i ngritur kupat, i uronin Laces udhën e mbarë. Prifti, me rasat e gjëra e të krojtura, ja këndoi urimet dhe e këshëlloi t'i hapë sytë, të mos bjerë me shokë të liq, të shohë punën dhe ta kujtojë t'ëmën me letra e me para. Lacja, me lot ndër sy, ja dha fjalën priftit.

Tërë ditën kish rënë dëborë. Kur ranë të flinin u ngrit një furfurinë e madhe, shamata e së cilës futej mbrenda. Lacen nuk e zinte dot gjumi: ay tani ëndëronte kurbetin dhe Stambollin që i dukej më i math e më i bukur nga fshati i tij. E shihte veten çirak... pastaj kallfë dhe më vonë usta me punën e tij... Më pastaj iu duk sikur u kthye në fshat, i veshur me poture, me xhamadan të qëndisur me ar dhe me sahat të argjentë e me zinxhir me shumë fije. Do të ëndëronte dhe shumë, po e ëma, e cila nuk flinte së shihte kohën e ligë, se kujtonte të zitë e kurbetit, vuajtjet, punërat e rënda dhe shumë shpesh «gratë e zeza» e «kapadainjtë turq», i tha me zë të butë:

— Po fle, o shpres-o?

— Jo, édhe nuk më ka zënë gjumi, moj nënoçkë.

— Flij, shpres-o, flij, se nesër do të jesh në udhë. Flij që të jesh i çlodhur.

Ay u kthye nga ana tjetër pa i thënë asgjë s'ëmës. Tani, kujdesja e s'ëmës që do të mos e kish në kurbet, i pikoi në zemër. I ngushlluar «jam burrë tani», u kthye nga ana tjetër dhe, i nanuruar me kësmetet që do të gjente në kurbet, e zuri gjumi. E ëma, duke mejtuar keqësitë e ndalimet e jetës, vetëm ndaj të gdhirë mbylli pak sytë dhe pa ëndër sikur iu kthye i shoqi, e mori Lacen në krahë, e puthi dhe fluturoi bashkë me të në qiell.

* * *

Kur ja thirrë këndezat, nëna e Laces ish më këmbë. Ajo ja kish bërë gati plaçkat. Miqtë e squan. Kali ish te dera dhe një miku i shtëpisë, që ish kushëri i dytë i Laces, po ujdiste kalin, ja vuri hejbetë dhe zuri mirë me qëngëlzën¹⁾ levenxen e madhe dhe të trashë.

— Nuk ish mirë ta nisin sot, — tha një plakë, që nuk i ipte besë së martës.

— Perëndia ja ruajtë e ja shpëtoftë, se e ka të vetëm, — iu përgjeq një plakë tjetër.

— Ah, ky kurbeti nuk ka lënë asnjë zemër pa djegur, — tha një grua e thyer.

— Ç'të bëjmë, moj bijë, kur nuk na mban vëndi, — tha plaka e parë.

Lacia ish ngritur. Një gjysmë napoloni dhe çesa çereke e groshe, që i kish mbledhur nga bakshishet, i futi në qesenë e vogël. Jashtë ish shumë ftohtë dhe zoqtë u sulë nën këmbët e kalit duke rëmuar bajgat. E ëma e mori kalin prej kapistrisë dhe e shpuri mënjanë ku, nën

1) qingëlza = rripi i mezit që i vihet kalit.

dëborën, ish ca bar i gjelbër. Pranë saj u mbloodhë çesa babo ¹⁾ dhe gjithsecili hithte para përdhe. Lacja i mbloodhi të gjitha.

— Patsh uratën, biro. Perëndia të nxjerrtë faqebardhë, — i tha një plakë, që i binte si emtë.

— Udha e mbarë, more sheret, që më ke thyer xhamet, — i tha një plakë, që dukej sikur të ish e motra e Verzevulit.

Lacja iu afrua kalit; kushëriri ja spërkati kalit kokën dhe vithet me verë. E ëma e pushtoi për qafe, e puthi, ja thirri të qarit dhe, me zë të dredhur, i tha:

— Udha e mbarë, o shpreso, Perëndia të ruajtë nga çdo e ligë... Shëko... t'i hapësh sytë... fë ma gëzosh zemrëm e nxiruar, të ma ndritësh pleqërinë dhe gjithë qante. Lacja i rrëmbeu dorën, ja puthi me lakmim dhe, duke qarë, i tha:

— Mbarë patsh, nëno. Mos kij frikë... do të të nxjerr faqebardhë...

Ay nuk e dinte ku gjëndeje. Iu errë sytë. Një nga fshatarët e mbajti. E hipi kalin... E në erë u ndëgjua. «Udha e mbarë... Të fala Gjokës... Të na shkruash... Mbarë patsh...»

* * *

E përcuallë. Që të gjithë u kthyen në shtëpinë e Laces. Prifti me plakun e fshatit ndenjnin pranë gllanikut. E ëma e Laces vuri në zjarr xhezven me raki, që t'u bënte ponçin. Flaga përhapej më të katër anët. Ponçi në shtëpinë e Laces ish gati dhe miqtë rrëkllenin njëri-njëri kupë pas tjetrit duke e uruar vejushen:

— Na vaftë djali shëndoshë... Sikur u ngroh koha...

¹⁾ babo = gra plaka.

— Po u ngroh, dhe mjaft, — tha prifti, duke e hedhur kamillafin mënjanë.

— U ngroh koha, u ngroh, — tha kushëriri i dytë : Laces, — na vafte Lacja shëndoshë...

* * *

Kali me Lacen u largua. Më s'dukeshin shtëpitë. Era frynte si e marrë. Kali shkonte dalngadalë. Duallë në majën e malit. Udhë ish e mbuluar me dëborë, asgjë-kundi nuk çquhej nënjë shënjë. Të ftohtët po shtohesh. Lacja, mpështjellë me gunët, i binte kalit që të shkonte më tutje. Nuk dukej asgjë: dheri kish veshur rrobat e bardha. Lacja nuk mundi të shkonte më tutje. Dësh të kthehej. Kalit i qenë futur këmbët në dëborë gjer mbë gjut. Zuri t'a hiqte pas kapistrin, po ay nuk luante. I vetëm, në hapësirë, desh të kthehej më këmbë. Nuk gjeti dot asnonjë gjurmë. Dëborë po binte dhe furfurima e marrë e luante si fletë. Cikma sa vinte po shtohesh. Kali nuk luante. Dherin e pushtoi errësira. Këmbët, duart dhe tërë trupi iu thanë nga të ftohtët. E humbi mëndjen dhe ra përdhe.

* * *

Pas disa ditsh u hap koha. Fshatarët duallë në mal për dru dhe, duke ngjitur udhën, e gjetnë kalin të gulosur. Ca më tutje gjetnë dhe Lacen të ngrirë e të vdekur. E njohën. Kur i a shpunë s'ëmës, prifti, plaku i fshatit dhe kushëriri i dytë rrinin pranë vatrës, po pinin pëng dhe po e uronin:

— U ngroh koha... na vafte djali shëndoshë.

Odesë, 1914

ZILIA E TËRBUAR

Në shtëpi nuk më rrihej dhe, me që koha ish e mirë, vajta te një nga soji im. Atje, pas shumë fjalësh, nismë bisedimin e martesës. Në këtë bisedim u ndamë në dy mejtime; ca lëvdonin kohën e vjetër, kur djemtë martoheshin që të vegjël, dhe, nga që nuk i mbante dot vëndi, kalbeshin në kurbet, që ku ktheheshin pas shumë vjetsh, vetëm kur ua sillte fati mbarë; e të tjerët lëvdonin kohën e re, kur djali martohej pas dëshirës së vet.

— E po, a është punë kjo të më martojë mua nëna e babai, me një vajzë që as e kam parë e që as s'e njoh? — tha një djalë që kish parë botë e desh t'i çkulte adetet e vjetra.

— Lini ata, — tha një tjetër, — po në martohemi. ne gruan në Shqipëri e kemi skllave dhe shërbëtore të nënës! Se mos i gëzojmë ne gratë, a?

— Ja, tashi, gjithkush po i mer pas dhe po ua shohën katandinë, — tha një që mbante me mëndjen e vjetër.

U folë dhe shumë, se gjithsecili mpronte tezën e vet. Njëra anë thesh për dëmet që ka sjellë qytetërimi e për prishjen e adeteve; tjetra thesh për ligësitë dhe mjerimet e kohës së vjetër. Asnjëra anë nuk i bindej tjetrës.

Në këtë hop, u ndëgjua zëri i një plaku, që mbante më shumë me reformën dhe tha:

— Zotërinj, do t'ju lutem të më ndëgjoni. Do t'ju tregoj një ngjarje te e cila do të mundni të shihni më mirë dëmet që sjell adeti i vjetër: Në katundin tonë kish ardhur prej Boshnje një djalë i ri, kish sjellë ca para dhe desh të rrinte pak kohë e të çmallej me t'ëmën që e kish plaçë, me fshatin, me miqtë, e të shkonte prapë në kurbet. Këta na kishin pak mall, ara e luadhe, që s'kish se

kush t'i punontë. Dhe mbrëmave, kur rrinin pranë zjarrit, i thesh e ëma djalit:

— Martoju, biro, martoj! Gëzoma zemrën plakë, se unë, ja, një këmbë e kam nën dhe e një këmbë mi dhe. Martoju, patsh uratën!

Djali e desh shumë t'ëmën. Sadoqë kish karakter të fortë, prej lutjeve e lotëve të saj, u shtrëngua të bindet.

— Ja, po të duash, bëjmë të bijën e Ristos, ose të Ndrekos, ose të Gjëlit. Cilën të duash? — i thesh e ëma, kur e shihte që po bindej.

Puna u mbarua: djali na u martua dhe ja gëzoi zemrën s'ëmës. Ndenji ca muaj dhe, meqë iu mbaruan paratë prej harxheve të dasmës e të tjerave, u shtrëngua të shkojë në kurbet duke marë hua për harxhet e udhës. E shoqja qau... ajo e desh shumë... dhe u ngushëllua, se gjykoj me mëndjen e saj që ashtu ish e shkruar.

Dhe kështu, biri i nënës e burri i nuses shkoi për në kurbet me qëllim të fitonte para e të kthehej për së shpejti. Po në kurbet, me shumë mundime gjeti punë me një rrogë shumë të vogël sa nuk i arrinte as për harxhet e veta. Këmbët më nuk i zinin vënd, se shkonte që nga njëri qytet te tjetri, duke e kërkuar fatin. As letra e as para nuk kish dërguar në shtëpi dhe as kish marrë letra, se vala e jetës ish shumë e fortë dhe ja kish humbur kurajon. Ky desh t'u dilte të shtëpisë ashtu siç u ish zotuar... Pas shumë vjetsh, mezi i eci fati dhe, në një kohë të shkurtër, bëri shumë para. Tashi iu kujtua fshati. gruaja, nëna dhe desh t'i shihte. Ay ish i sigurtë që gruaja do t'i kish mbetur besnike. Në këtë kohë unë ndodhesha në fshat se e kisha siguruar jetën dhe, sadoqë isha 65 vjeç, kisha vetëm 10 vjet që isha martuar. Dhe kështu ky djali, që kish nisur të plakej, desh të kthehej në shtëpi papandehur dhe qëndroi në hanin e fshatit. E ëma kish shumë vjet që kish vdekur dhe varri i saj ish mbuluar me hithra e me lëpjetra. Shtëpia e tij, sadoqë

ish e meremetisur, ish gjithë ajo e para. Duke e parë shtëpinë të ndrequr zuri t'a mundonte kureshti, se u çudit. Po kur pa të hyjë në shtëpi një djalë të hijëshëm, iu ndesnë rrëmbat prej zilisë. Duke u dredhur, mengadalë iu afrua portës, vjedhazi u fut në kopsht dhe u fsheh prapa trandafilin të shtëpisë. Ky e dinte mirë ç'u ishin sobat dhe, mengadalë, iu afrua penxheres për të përgjuar. Kur hodhi sytë mbrenda pa: Pranë gllanikut po rrinte e shoqja e cila, sadoqë ish mjaft e shkuar, e kish mbajtur bukurinë e parë. Pranë saj ish shtruar djali i ri, që se ç'po i tregonte gruas. Pas ca e vuri kokën e tij në prehërin e saj. Gruaja zuri ta përkëdhelte duke folur mengadalë, sa që fjalët nuk ndëgjoheshin jashtë:

— Eh, biro, u rrite e u bëre 20 vjeç, u bëre burrë, e yt atë edhe s'të ka parë. Kush e di se ku do të ketë vdekur? Që kur shkoi, nuk mora asnjë letër... më humbi përnjëherej... Nuk dha asnonjë shënjë — Në këtë hop, prej syve të saj pikuan disa lot, që ranë mi faqet e djalit. Pasi i fshivi sytë, vazhdoi: — Ti, ahërej kur shkoi yt atë për në kurbet, ishe një muajsh në barkun t'im. Yt atë, as që mësoi që linde. Po, biro, patsh uratën time e të Perëndisë. gëzoma zemrën e shkretë, martoj, se ti e ke punën këtu e do të mos ja nxirosh jetën s'at shoqeje. — Dhe e pushtoi të birin duke e puthur në ballë.

— Ah, e poshtëra, më pas ka tradhëtuar! — tha me vete i shoqi i saj që prapa penxheres dhe u sul me vrap e me tërbim në odë. Atje, pa gjykuar e pa pyetur ja futi në zemër thikën e mprehtë... Gjaku u derth si lumë... Gruaja e humbi dhe po dridhej duke e parë të ardhurin në sy. Nuk e njohu. E kish parë vetëm dy muaj, po ahërej nuk kuxonte ta shihte mirë, se nuk i kish dalë turpi. E ay, me zë të egër, me kamën në dorë duke iu matur, i thesh:

— Thuajmë, e poshtër, thuajmë që kur e ke zënë këtë jaran që tani po i mban kufomën?

Asaj iu kujtua dita e kurorës, po ca më shumë dita e ndarjes. Kështu, i egërsuar e i tërbuar, ay ngjiste më shumë me atë djalin e ri me të cilin u martua. Nuk gjen-te dot fjalë ç't'i thesh, se iu turbullua mëndja. E ay, me zë të egër e duke u matur me kamë, pasonte:

— E poshtër! Kështu ma ruajte nderin!? Unë po pi-qem, po dergjem në kurbet për nderin e shtëpisë e ti kë-tu. . dhe ja futi kamën në zemër.

Ajo i hapi sytë dhe, me zë të ngadalëshëm, i tha:

— Ah, ç'bëre kështu, more derzi, more Gjokë... Vra-ve t'ët bir, more i shkretë!?

Odesë, 1915

AGONIA E FUNTME

— O burra, o burra përpara! — thërrisnin ushtarët vetëdashës kur kryengritësit i ranë Durrësit.

Dielli édhe s'kish dalë. Drita e hollë e agimit e zbar-dhëlloi tokën e kodrave dhe ujin e kënetave, që këu dilte zëri i bretkosave, i cili, i bashkuar me zbrazjen e push-këve, ndëgjohej si nonjë copë muzikale.

Trimat, që të gjithë, u veshnë, i ngjeshnë fyshekët. rrëmbyen armët dhe, pasi zunë viset, nishnë të zbraznin kundër armikut. Zërat bamb-bamb-bamb, bumb dhe kërrrr-kërrr, e mbushnë atmosferën. Tymi i barutit u ngrit përpjetë dhe ja zuri shkënditë diellit¹⁾, i cili shë-konte punën e tij, pa e çarë kokën se vret vëllai vëlla-në.

Hysniu, që ish kapteri i një togu kosovas, e kish zë-në pusinë. Gjendja e tij ish e keqe. E shihte mirë se kry-engritësit mbaheshin. E pa që, jo vetëm që s'i thyenin

1) Shkënditë e diellit = rrezet e diellit.

dot, po ata me ca yryshe do t'a zënë Durrësin. U ngrit më këmbë dhe u thirri trimave me zë të fortë:

— O burrani, përpara se na piu komita! — dhe u sul me pushkë në dorë përmes plumbave, që i vinin si breshër. Pas tij u sulë dhe shumë të tjerë, Kryengritësit qëndronin dhe me nxehtësi e me tërbim zbrasnin mi ushtarët. Dukej sikur komita, ja, i korri që të gjithë ushtarët. Hysniu s'u tut, e vazhdoi yryshnë¹⁾ shkoi më tutje dhe u dha zemër, komitave, duke u thënë shokëve:

— Përpara, o burrani, përpara se lëftojmë për Shqipërinë, për Atdhe!

Ay e dinte shumë mirë përse lëftonte: e kish kuptuar se me fanatikët s'bën dot punë dhe e dinte që po t'a mirrte komita Durrësin, ahorej humbi Shqipëria; përpara fantazisë së tij i qëndroi Shqipëria e ndarë, andaj shkoi përpara duke thirrur si i marrë:

— O burra, përpara, përpara, — dhe i priste plumbat, që i vinin si breshër.

Armiku u trëmb, iku se u thye. Po na, një plumb që i erdhi tërthuar, si nonjë thikë e zjarrtë, ja çau barkun, dhe e shtriu gjysmë të vdekur përdhe. Kur mori fund lufta, e shpunë në spital dhe ja qepnë barkun. Me t'i ardhur mendja në kokë, pyeti:

— A u thye komita?

* * *

Hysniu kish marrë pjesë në gjithë kryengritjet e Kosovës dhe e kish kuptuar idealin «Shqipëria më vete». Ky e dinte shumë mirë ç'domethënë «vetqeverim». se i kish parë sundimet e huaja. Përveç tiranisë turke, shkretimeve të Turgutit dhe Xhavidit, kish ngrënë dhe

1) Yryshi = sulmi.

sundimin sërb. I kish parë, me sytë e vet, fshatrat e djegura, fëmijët e pjekurë dhe shumë të tjera. Aherej ja vranë të vëllanë, që kish marrë pjesë në kryengritje dhe të cilin e zunë pas goditjes së Kumanovës. Dhe vetë Hysniu mezi shpëtoi nga thonjt e tyre. Kur shkeli më tokën e Shqipërisë së lirë, kur pa flamurin e bukur me shqiponjën me dy krerë, kur pa vetëqeverimin shqiptar. e ndjeu lirinë dhe tha:

— Jam gatë ta bëj veten time kurban për të mprojtur këto të drejta që s'i kam patur asgjëkundë dhe i kam në atdheun e dashur, në Shqipërinë e shtrenjtë.

* * *

Dielli kish përnduar dhe drita e hënës si nonjë hajdut hyri përmes penxhereve të spitalit dhe e ndriti odën. ku ish shtrirë Hysniu. Ay po rënkonte dhe, duke parë rreth e rrotull, mirrte frymë me mundime. Iu afrua motra e hirit ¹⁾ e cila, mengadalë, dhe lehtë, i ndreqi jastakët. Hysniu, me zë të unjtër, mengadalë, me fjalë të çkëputura njera prej tjetrës, i tha:

— Ku e kam pushkën? Po fishekët?

Motra ja solli dhe, pas dëshirës së tij, ja vuri rreth tij. Hysniu me t'i parë armët, e shikoi motrën me kënaqësi dhe zuri të bënte sikur drithte cigare. Motra s'e kuptoi dhe i tha:

— Para lyp, a?

Ay e vuri dorën në gojë, bëri sikur pinte duhan dhe sikur nxirrte tym. Motra e kuptoi dhe i ana nje cigare l plagosuri e hiqte me shumë mundime dhe, kur e mbaroi. i tha motrës:

— Të lutem... armët... armët... t'ja ipni... djalit tim... që e kam... në Kosovë... T'i thoni... të lëftojë... për Shqi-

¹⁾ motrat e hirit = motrat e spitalit.

përi... për flamur:.. për gjuhë... të bëhet... trim... — dhe kërkoi një kupë ujë. Pasi e piu ujin, me shumë mundime u ngrit më këmbë dhe thirri me gjithë forcën që i kish mbetur:

— Rroftë Shqipëria, rroftë flamuri! — dhe si ndonjë lis i prerë ra mi shtratin e tij.

* * *

Hëna e fshehu dritën e saj... Ndëgjohej një shamatë e vogël që bënin valët duke u përpjekur mi zallin e detit. Era e hollë luante fletët e ullinjve. Në odën e spitalit mbretëronte një pikëllim e jashtë ndëgjohej: Bamb-bamb-bumb... Tërrrr-Tërr...

III. PLAGËT E ZEMRËS

DASHURIA E MATILDËS

Më në fund na u hoq dhe ngrica... Dëbora u tret. mirëpo na u shtua balta: udhët u bënë të pakalueshme. Kur dolla për t'u freskuar pak, qielli ish fare pa re.

Njerëzit, më të katër anët, ecnin me shpejtim, se gjithsecili shkonte në punën e vet. Unë shkonja me çape të ngadalëta e të regullta e plot përtim, se kështu gjëja zbavitje. Pas pak kohe arriva në rrugën kryesore të qytetit, ku e kisha bërë fjalë që të piqesha me një mikun tim. Arriva më parë e, duke ecur, ëndëronja dhe fandarizonja ¹⁾ bukuritë e qytetit të huaj, duke i barabatur me bukuritë e qyteteve të vegjël të Shqipërisë. Ky ish një qytet me bukuri të rallë: rrugët i kish të gjëra, të gjata e të shtruara me granitë katrorë; shtëpitë i kish të mëdha e me arkitekturë të rrallë dhe... ç'ta zgjat se kushdo, që ka parë ndonjë kryeqytet ose qytet të math, e kupton vetë. Po, me gjithë këto bukuri, një zë i fshehtë ma çfaqte Shqipërinë e më shpinte atje që t'i shihnja bukuritë e atjeshme. Dhe përnjëherej thashë me vete: «Jo, jo... kurrë nuk do t'i këmbëj gurët e Shqipërisë së shtrenjtë me parajsën e çdo qyteti të botës së madhe».

Shkova më tej. Tani isha i çliruar prej mejtimeve se i kisha dhënë funt që Shqipëria është shumë më e bukur prandaj, sytë e mij me lakmim kullosnin më të djathtë e më të mëngjër dhe panë... panë... panë goca të bukura, shu-

1) fandarizonja = fantazoja.

më të bukura... flokëmëndafshita, fytyrëmbra, mes-holla, gojëvogla, hundëqiriçka, vetullgajtanka dhe... dhe... sepse përnjëherej... u drothshë prej një ndjenje të panjohur gjer më atë ditë. U drotha dhe, si automat, i fola një vajze. Përnjëherej i kërkova ndjesë, e, me sytë e mij, i lutesha të më hidhte një sy... Desha t'i flas e t'i thosha që zemra ime m'u bë skllave prej bukurisë së saj, që e dua pa masë e që jam gati të vdes për të, por vetëm «urdhë-rë». Duke ecur e duke mejtuar kështu e arriva po, përnjëherej, qëndrova meqë e ecura e saj më pikoi mu në zemër. Tani vura re dorën e saj, që e kish të bardhë, si prej mermeri e gishtërinjtë i kish si të skalisur.

E mblodha veten dhe iu sulshë pas. Iu afruash... Ajo, nga ana e saj, porsi kur desh të ma thyente kurajon, ngriti fustanin sikur kapërxeu ndonjë pellk me baltë. Ja pashtë dhe këmbën e saj të vogël, të bardhë e të bukur e cila, kur ecte, porsi kur më ndillte pas. Shkova më tej dhe, kur e arriva të çipi i rrugës, ajo u kthye. Duke u kthyer më hodhi një sy, mirëpo unë nuk e kapa dot dhe sërish i rashë prapa duke u sulur. E arriva... po, vetëm ay që ka qëndruar përpara nonjë goce, vetëm ay mund ta kupëtojë gjëndjen t'ime se, me t'u afruar, u memecosa,¹⁾ nuk dinja ç'të flas dhe i thashë vetëm: «Zonjushë! Zonjushë!...» Pas këtyre fjalëve ajo filloi të më shohë me habi. Shkoi mjaft kohë gjer e mblodha veten. Në këtë kohë, pa ditur ç'po bëj, shkronja baras me të. Më në funt, kur m'u zgjith goja, i thashë:

— Zonjushë! Bukuria juaj më bëri t'ju ndjek pas dhe ajo më dha zemër t'ju flas. Më ndjeni se, vërtet, sjellja ime nuk është e pëlqyer po, kur njeriu është nën urdhërin e Kupidonit²⁾, nuk ditka se ç'është sjellja e mirë, nuk ditka fisnikëri, nuk ditka rregulla shoqërie... E kuptoj shumë mirë që sjellja ime është fare e keqe... po... në këto raste. njeriu nuk ditka turp, meqë i janë errur sytë e gjykimit. Zonjushë, prapë. iu kërktoj ndjesë. po ndë-

1) memecosa = u bëra memec.

2) kupidoni = perëndija e dashurisë që rri me hark e shigjetë në dorë. Perëndi romake.

gjomëni... ndëgjomëni... Mirëpo, ajo nuk desh të më ndëgjonte e, që të gjitha këto ja thashë duke shkuar pranë saj.

Po ajo shkonte shumë shpejt. Kur e arriva prapë, i thashë:

— Zojushë, ndëgjomëni... po ju flet një zemër e papërlyme... — S'munda të flas dhe më, se para syve të mij më qëndroi një hije. Fërkova sytë po, prapë, para meje ish një grua e gjatë, flokëllëshuar dhe e veshur me rroba të zeza; sytë i kish të zes, ballin të gjërë, hundën të drejtë, gojën mesatare, faqet e rrumbullakta e të zbeta, mjekrën të plotë dhe vetullat të zeza e të shpeshta. Në krye thashë se mos ish gjithë ajo vajza që e ndiqnja pas. jo... kjo ish një hije... një hije si e gjallë.

Duke parë këtë çudi, nuk e humba, po vazhdova të sulem pas asaj që m'i futi në zemër shtizat e dashurisë. që nuk ish dhe aqë larg. Me ta bërë çapin e parë, grua ja më pushtoi pas krahu dhe më tha:

— O bir! Ku kërkon të mbetesh dhe pas cilës po sullesh kështu? Nuk më sheh që nuk i këmbej dot këto rrobat e zeza, që kam kaqë kohë që i kam veshur e që po i mbaj kaqë shekuj? Pse nuk po përpiqesh të m'i këmbesh e të më veshësh nër të bardha, po vetëm po e shkon kohën duke ndjekur, ja, të tilla si ajo! O bir, o bir! Ju këtu po i harxhoni fuqitë në vënd të huaj! Eh unë e mjera! Edhe nuk po më njeh? Nuk do të ta them se dua të më njohësh vetë, dua të pendohesh se, po të të heq unë nga kjo rrugë, nuk do të quhet pendim. Vërtet, more djallë, dhe ti ke zemër të nxehtë, vërtet... e kuptoj shumë bukur, meqë dhe unë kam qënë një herë e re, po a do të mund të t'a fal këtë punë që të zësh vajzat e një kombi të huaj e të harrosh vajzat e vëndit tënd! «O Fat, o fat, sa liksh që na ke ndarë, sa keq që na ke përndarë, sa ndyrë që na ke hedhur në vise të huaja! O fat... o fat!»:

Këto i tha me vajtëm, pastaj më shtrëngoje me të dy duart dhe më tha:

— Mallkimin tem do ta kesh kurdoherë, more djallë. po të vazhdosh së adhuruari e së dashuri vajza të huaja!

Tani do të largohem... Mirëpo... po të jetë nevoja do të vij prapë. Dhe gruaja e veshur ndër të zeza u çduk pa thënë se cila ish.

E vrava mëndjen shumë kohë, po nuk dinja se cila ish. Vetëm një gjë më çqetësonte: më kujtonte vëndin ku u linda. Në këtë hop thashë me vete: Ç'e ha malli këtë për vëndin t'im?» e me sy kërkonja vajzën, e cila nuk dukej... Si i xhindosur, i rashë gjithë rrugës gjer në fund... e pashë dhe desha t'i afrohesha, mirëpo m'u kujtuan fjalët e zonjës se veshur ndër të zeza dhe nuk guxova. Kështu shkoi shumë kohë dhe, kur po kthenim çipin, na u bashkuan sytë, e buza e saj i vajti në gas. Ju afruash... nuk m'u kundërshtua... kështu u njohmë dhe filluam bisedimin për kohën, për teatrot, për modat, për muzikën, për letraturën e për shumë të tjera. Isha i lumtur dhe nuk mejtonja asgjë, se më dha leje ta përcillja gjer afër shtëpisë së saj. Me t'u kthyer në odën t'ime, u shtriva mbi shtresën dhe po ëndëronja për atë që e kisha në zemër e që e quanin Matildë. Më dilte përpara me buzëqeshjen e saj të ëmbël, më dukej e bukur si Perëndeshë e mbi veshët e mij ndëgjohej zëri i saj i hollë që më thesh: «Të dua, të dua!»

E ndjeja veten krejt të lumtur dhe thashë: «Fleta e parë e dashurisë është dita e sotme, se fitova gjithësinë!» E kur rinja kështu, duke ëndëruar, padashur e solla ndër mënt atë gruan e veshur ndër të zeza dhe, padashur, m'u ndëgjjuan fjalët e saj të fundit.

«O Fat, o fat sa liksh që na ke ndarë, sa keq që na ke përndarë, sa ndyrë që na ke hedhur në vise të huaja! O fat, o fat!»...

Ky kujtim ma ktheu gazin në pikëllim e fillova ta vras mëndjen që ta gjenja se cila do t'ish ajo zonja e veshur ndër të zeza.

II

Kishin shkuar më shumë se dy muaj... Nga ditë piqesha me Matildën. Bukuria e saj nga ditë po i shtoej;

e fjalët e saj të ëmbëla më dehnin. E quanja veten të lumtur e më dukej se kjo lumturi do të mos kish të sosur. Mbrëmave, ngahera piqeshim në parkun e math, nën burët e dëndur, ku nuk hynte as drita e elektrikur. E kisha ndëgjuar prej gojës së saj fjalën e ëmbël «të dua» dhe isha i sigurt se ish e gjithë e imja.

Këto pjekje i mbanim të fshehta, se as ajo nuk u kish thënë prindëve e as unë nuk u kisha thënë miqve; po as që e kishim ngarë fjalën për martesë gjer në këtë ditë. E kjo ish një e dielë pas dreke. Ish ditë vere, nga ato me të cilat mund të mburrej Palmira e Jugës. ¹⁾ Kë të ditë ma kish ndarë pjekjen me letër të veçantë dhe unë nuk dinja ç'të thesha se, në të shtatëdhjetë e pesë ditët që ishim të njohur, nuk kishim nxjerrë asnjë psherëtimë. Në vëndin e pjekjes vajta i pari dhe ndenja mbi fronin që e kishim quajtur tonin. Zoqtë po këndonin, mirëpo kënga e tyre ish pak e dredhur e me pikëllim. Nuk i dhashë nonjë rëndësi dhe fillova të shoh qiellin, i cili shkëlqente; po, me të kthyer nga ana tjetër, pashë që në të po ngrihej një re e zezë sterrë: me një fjalë po afrohej shtërgata, se reja gjithë po madhohej e po madhohej. Era e hollë, që frynte mengadalë, i luante fletët dhe e prishte qetësinë. U lodha së prituri dhe, si automat, nxorra sahatin dhe e pashë që ish plot ora e pjekjes. U ngrita më këmbë dhe, pa arrirë të bëj as pesë çape, e pashë që po vinte duke nxituar. Iu sula dhe e arriva në gjysmën e rrugës. Kur ma zgjati dorën e shpuri buzën mbë gas dhe më pyeti:

— Ke kohë që po pret?

Sikur ndëgjova zërin e bilbilit, kur ndëgjova fjalën e saj dhe e pashë drejt në sytë e saj larushe, nga të cilat buronte dashuri për mua.

U fjalosmë mjaft kohë dhe e pyesnim njëri-jatrin për gjëra të kota. Pastaj ramë në heshtje, të cilën e prisha unë se i thashë duke qeshur:

— Mos u mundo me mejtime të kota, moj e shtrenjta ime. dhe mos u mërzit, po gëzohu bashkë me mua,

1) Vende të buta, pjellore dhe të bukura.

se dashuria jonë lyp vetëm gëzime, dëfrime, lodra, kërcime, këngë e kremtime, kremtime... Po, lyp kremtime se, si të shkojë Vera e jetës sonë, do të vijë Vjeshta dhe atëherej do të mos shohëm asgjë tjetër, po vetëm **rënien e gjetheve.**

Matilda heshti pak, më pa drejt në sy, ma mori dorën në të sajnë, ma shtrëngoi me sa fuqi që kish e më tha:

— Vërtet ashtu është, more Kolë; vërtet duhet të gëzohemi dhe ta shkojmë kohën tërë kremtime se kemi Verën e jetës sonë. Mirë, shumë mirë... dhe unë jam në një mëndje me ty. Po a do ta shkojmë dot tërë kohën në gëzime e në kremtime, po të vazhdojmë të jemi kështu të ndarë e duke u pjekur vetëm nga dy orë ditën? Jo, më duket se kështu nuk plotësohen fjalët e tua prandaj eja sonte tek im atë që të më kërkosh dorën.

Unë, sadoqë u turbulluash pak, me t'i parë sytë e Matildës, që m'i drejtoi si shkëndija të zjarrta, e mblodha veten dhe, pa u mejtuar shumë, i thashë:

— Sonte do të mos mund të vij, se kam shumë punë në zyrë; nesër të më presësh, se do të vij të të kërkoj prej prindërve.

Shtatëdhjetë e pesë dit ndodhesha në një kopsht plot me trandafij, me manushaqe, karafile e me gjithë lulet e bukura të dheut. E, në zgjatjen e gjithë kësaj kohe, nuk kisha këputur asnjë lule. Matilda desh të ngrihej, mirëpo unë e mbajta duke iu lutur të rrinte dhe pak. Pajtoi... Ndenji... më shikoi drejt në sy... Unë mejtohesha: «T'i them apo të mos i them?» dhe vendosa t'i them. Duke u dredhur, i tëri, e hapa dytri herë gojën pa nxjerrë as gjysmë fjalë. Më në funt, pasi më dha kurajo me fjalën «Folë dhe ç'ke të më thuash?», i thashë:

— Matildë, ndëgjomë se do të të tregoj një ëndër, që e pashë sonte.

Më pa me habi dhe më tha me pak zemërim:

— Unë po të them folë, ç'ke të më thuash, e ti do të më tregosh ëndra.

— Ndëgjomë më parë, të lutem e shtrenjta ime, pastaj thuajmë ç'do të më thuash. Ajo më foli, po unë vazhdova: — Pashë në ëndër sikur qeshë në një kopsht, ku ti po rrinje mbi një fron të zbukuruar me turli lule. Posa të pashë, u drejtuash nga ana jote. Nuk kish asnjëri tjetër. Rreth meje ishin me mijë rrënjët e trandafijve të thatë. Sapo t'u afrova, të pushtova dhe fillova të të puthnja. Po sa ish çudia ime kur pashë se, pas së puthëres, gjelbëruan trandafijt dhe lulëzuan që të gjithë.

Më t'i thënë këto fjalë, nuk e mbajta dot veten dhe e putha ëmbël. Thashë se do të më zemërohet, mirëpo jo, se dhe ajo, nga ana e saj, mori shëmbëll prej meje... Më në funt, e lamë parkun dhe e përcolla gjer në shtëpi. Kur u ndava, për t'u kthyer në odën time, solla ndër mënd nënën plakë që e kisha lënë këtu e dhjetë vjet, babanë e plakur, që me fuqitë e tij të dobëta po e mbante jetën me dhëmbë, duke pritur me padurim të më martonte e t'a gëzonte pak zemrën e shkretë. Kujtova motrat, vëllanë që mezi i mbanja mënt. Që të gjitha këto më shkuan para syve të mij si nonjë film kinematografik... po u çduknë përnjëherë, meqë mejtimi im më i fortë ishte për Matildën, prej së cilës sot mora dhuratën e madhe, se më fton-te në shtëpi që ta kërkonja për grua prej prindërve të saj. Mirëpo unë nuk e dinja cili ish i ati i saj e në c'shtëpi do të hynja e çfarë soj njerës do të bënjta fis. Dhe kështu, duke u mejtuar, arriva në shtëpi. Nuk më flihej... mora një libër dhe këndova historinë e një djali që harroi nënë e babë e mbeti në vënt të huaj, ku u martua dhe shumë të tjera. I lodhur nga këndimi, kur mbi xhamet e penxheres po trokëllisnin pikat e shiut, më zuri një gjumë i ëmbël.

III

Tërë natën fjeta me turbullime. se më mundonte një hije. Po... më mundonte... Dhe, për ta lehtë-

suar veten, do ta tregoj ëndrën me gjithë hollësitat e saj. Tani që po e kujtoj, më ngjithen mishrat. Po më mirë le t'jua tregoj:

— Shkonja pranë një shtëpize të bukur dhe qeshë dhënë i tëri pas mejtimeve... këto nuk m'i prishte as trokitja e karrocave, as era e fortë, as shtërgata që po mblidhej, as të thirrurat e çifutëve, as të sharat e punëtorëve dhe asgjë prej gjëje. Mejtohesha për Matildën dhe vetëm për të... dhe mejtonja se si do ta merrnja prej krahu që të vinim kurorë... a do të deshënin prindët e saj të ma ipnin... Pas kësaj solla ndër mënt Shqipërinë, nënën, babën, motrat, vllanë. Këto më duallë shpejt prej mëndjes, se vëndin e tyre e zuri Matilda dhe më dukej sikur ajo dhe vëndi ku jetoja ish atdheu im. Duke mejtuar këto, poqa udhës një shqiptar, një shokun tim që ish i martuar me një vëndëse. Ky i dinte që të gjitha, po nuk më ra në sy dhe vetëm më tha:

— Bërë shumë mirë... Ne tani, shyqyr Zotit, nuk mund të ndjekim zakonet tona që janë barbare, ato zakone që stigmatizojnë dhe dënojnë dy zemra që bashkohen me lidhjen e dashurisë.

Më tha dhe shumë gjëra të tjera. E unë, siç qeshë i dehur më spërkatjen e Kupidonit, e ndëgjova me kujdes dhe e falënderova për urimet që më bëri. Miku, më t'u larguar, qeshi me sarkazmë... unë shko-va më tutje. Jo... të them të vërtetën... nuk e kisha mëndjen në kokë dhe, padashur, u gjënda para shtëpisë së Matildës... Si prej çudie u hap dera, prej së cilës dolli ëngjëllushja ime... Nuk më tha as gjysmë fjale, po më rrëmbeu prej krahu e më shpuri në shtëpinë e saj. Dhomat ishin të ndriçuara... tryezat të shtruara... ishin shumë të ftuar. Matilda më shpuri para një burri nonja 50-55 vjeç, i cili më rroku pas dorë dhe më dha uratën. Pas kësaj më shpuri para një gruaje të thyer dhe ajo më dha uratën... më në fund më lëshoi në mes të zonjave e të zotërinjve. Që të gjitha këto ngjanë shpejt. Unë nuk fola asnjë fjalë, se

më qe lidhur goja nga që nuk më hahej as muhabeti me ata njerës, që nuk bashkoheshin me karakterin e me natyrën time. Duke heshtur kështu, m'u afrua Matilda. Tani ish e veshur me rroba të bardha. Ardhja e saj m'i largoi mejtimet, se më dha një pako e më tha:

— Na merri... shko në odën tjetër e veshu, se duhet të shkojmë në kishë. Po na presën qëkur... Shkova në odën tjetër dhe dolla i veshur dhëndër. Me të dalë nuk më lanë të mejtohem, po më rrëmbyen prej krahu dhe më hipnë në një karrocë me kuajt të bardhë e më shpunë në kishë, ku ishin gati që të gjitha të kurorës: qirinjtë ishin ndezur, lustrat që të gjitha çkëlqenin e qelqet e tyre lëshonin që të shtatë ngjyrat e ylberit. Priftërinjtë ishin të veshur me robat e shtrenjta e po na prisnin. Me të hyrë, iu afruan babait të Matildës dhe i thanë: «Shumë u vonuat?» Ay nuk u përgjegj. Një prift plak po i thërriste shërbëtorit të kishës. Kur na vunë para kornizmës, prifti filloi të këndonte të kurorës e kori që sipër përgjigjej. E ktheva kokën, po nuk pashë kurrgjë e zërat dilnin shumë të bukura. Kori pushoi, prifti vazhdoi këndimin e tij e unë mori kurorat që të na i vinte mbi kryet. Në këtë hop, u dëgjua një zhurmë, fryri një erë e fortë që shoi një pjesë të qirinjve edhe pranë meje qëndroi ajo grua-ja e veshur nër të zeza. Që të gjithë u gurosmë e ajo na tha:

— Zotërinj e zonja! Ky djalë është imi; ju m'a rrëmbyet; nuk do ta le që të mbetet këtu, në këtë vënt të huaj për të. Ka dhe ky atdhe, ka dhe ky nënë, ka dhe ky babë, vëllezër, motra e farefis... Që të gjithë ata, si do zot unë, janë të veshur në zi e buza nuk u qesh kurrë. E kanë djalë të vetëm dhe dita-ditës po e presën që t'u kthehet e t'i gëzojë... Po ky?... ky dashka të mbetet këtu... E ju?... u gëzuat që fituat një djalë të tillë... Gjer më sot, më kini marrë shumë djem, se i gënjeni me lajkat e me ndërtitë¹⁾ e vajzave tuaja e

1) ndërtitë = me tualetin e fytyrës.

më shkalloni nga mëntë... E, duke thënë këto fjalë, më pushtoi prej krahu e fluturoi bashkë me mua. — Matilda, — thirra dhe u zgjuash.

Qaqë ish ëndra ime. Kur u squash isha qull prej djersës dhe krejt i raskapitur. Kur hapa sytë, pashë se në to ishin lot të tharë, të cilët, siç duket, u derdhë nga pikëllimi që më ndanë prej Matildës.

IV.

Punë?!... a mund të bësh dot punë kur të ndëgjohen në zemër trokëllima e kur Amuri¹⁾ t'i ka futur shtizat e ëmbra? A je i zoti ta shohësh punën dhe, a mund ta mbarosh për të qënë?

A mund ta kesh mëndjen në kokë dhe a di se ç'bën?... Jo... jo... nuk bën dot asgjë me mënt; nuk e sheh dot punën; harron atdhe, harron prind... Në zyrë, ku punonja, harohesha me pëndën në dorë mbi tryezën e madhe dhe, në vënd të pesës, shkruanja treshin; në vënt të mbledhjes bënja zbritje... e, e të gjitha këto, ngjisnin, se para syve të mij ngahera ish Matilda... Im zot e kish vënë re prej kohe që bënja shumë gabime, po, meqë kisha kohë që punonja atje, ma falte e nuk më binte në sy se i kish kuptuar nga më vinin të gjitha këto. Kur mbarova punën, u bëshë gati për të vajtur në shtëpinë e Matildës. Më pushtoi një e dredhur... çapet m'u vogëluar... Duke shkuar kështu, për te Matilda, poqa rrugës postierin, që më dha një letër. Duke shkuar para një kopshti publik, qëndrova e ndenja mbi një fron me mejtim që ta këndonja letrën. Grisa zarfin, nxora një fije letër dhe fillova ta këndo. Ishte prej babait: shkruante për mallin që kishin e që e ndjenin për mua, për kujdesjet. Në letër kishte shumë skërfitje të zemrës, po ca më shumë u helmuash se më shkruante që im më kish dy javë e

2) Amuri = një format që merr kupidoni, perëndija e dashurisë.

sëmurë. Në këtë kohë, i gjithë mejtimi im m'u drejtua në shtëpi dhe para syve të mij, të gjalla më qëndruan të gjitha të Shqipërisë: koha e foshnjërisë, e miturisë, sheshet e luadhet, ku brithnim e harbonim e ku ziheshim me gurë; kroi ku mbushnim ujë; vreshtat, ku vinim e vithnim rush; m'u kujtuan lotët e nënës, që i erdhë kur u ndamë... m'u kujtua, tani, e shtrirë në rrobat... m'u kujtua qyteti, farefisi, malet... të gjitha... psherëtita dhe thashë me zë:

— Kam shumë kohë që jam larg teje, o atdhe, o nënë!... Kopshti ishte plot me drurë... Zoqtë po këndonin këngën e vajtimit: siç dukej ndonjë qen sheret do t'u kish marrë zoqtë e vegjël. Po me gjithë këto, mëndjen e kisha më shumë te Matilda... Tani, prapë, më kapnë të ngjethura... këmbët më qenë rënduar dhe duke shkuar kështu, u gjetshë pranë shtëpisë së Matildës. E mblodha veten e i rashë ziles... Shërbëtori më shpuri në sallon, ku po më prisnin. Dielli po i futte rezet e tij dhe po e zbardhullonte odën. Me të më parë, u ngritnë më këmbë dhe erdhë drejt meje. Unë e humba... u gurosa e do të qeshë turpëruar po të mos më kish shpëtuar Matilda. Ajo më shpuri tek i ati, tek e ëma dhe më njohu me disa miq të tjerë. Po unë edhe nuk kisha ardhur ndër vete... Bisedimi ish i gjallë: më shumë fliste vjehri. Unë fola vetëm nonja dy herë. E kur ora vajti dymbëdhjetë e natës u drejtuash nga vjehri dhe duke u dredhur e me mundime, i thashë:

— Zotni, më falni, unë sot kam ardhur në shtëpi në t'uaj dhe marr kuximin t'ju kërkoj dorën e Matildës, e bijës suaj...

Ay më pa drejt në sy e më tha:

— Më dukesh djalë i mirë e i shtruar, patsh uratën time dhe, pasi thirri dhe Matildën, na tha: «U trashëgofshi e shkofshi me një jetë të lumtur!»

Ishim të lumtur dhe, pasi caktuam edhe ditën e dasmës, u ndamë. Duke u kthyer për në shtëpi, në zëmër, ndjenja një zë: «Kështu a, gjithë kundra do të më

vesh... mirë... s'ka gjë... do të vijë dita që do të pendohesh, po do të jetë vonë». Ky zë më shtyri t'i sjell ndër mënt njerëzit e shtëpisë.

V.

Kur u ngrita nuk mentonja asgjë tjetër, po vetëm Matildën. I pregatita të gjitha sa duheshin për dasmë...

Paratë, që i kisha fituar me aqë mundime, nuk i kursenja fare... Njeriu i derthka që të gjitha për ndjenjën e pagarandëshme të dashurisë dhe, për të, qënka gati ta shesë tapinë e shtëpisë dhe qimet e kokës! Vallë kush nuk ka ndëgjuar për atë që, meqë i kanë marrë dashurinë, është bërë egërsirë me fuqi të rrallë, ka vrrarë, ka çdukur... dhe, të gjitha këto, për dashurinë. Kush nuk i mban mënt, prej historisë, rolet e mëdha që ka luajtur gruaja apo, më mirë ta themi, ajo ndjenja e pagarandëshme e dashurisë? Cili nuk e di Dalilen që e lidhi Samsonin me rrypa? Dhe cili, prapë, nuk e di që, sadoqë Samsoni kish njëmijë e një prova që do ta dhuronte, ja tregoi ku i fshihej fuqia, meqë ish nën urdhërin e dashurisë? Pastaj kush nuk di njëmijë e një që janë prishur mëntsh, që janë vrrarë e kanë bërë rezillëke të panumërta, vetëm e vetëm se kanë qënë nën urdhërin e dashurisë. Miliona njerës vuajnë prej kësaj ndjenje, se Venera¹⁾ ka besnikët më të shumët në botë.

Këtu do të më pyesni: «Pse na i thua të gjitha këto dhe pse nuk bërë dhe ti ndryshe duke marrë mësim prej tyre?» Vërtet, të dashur zotërinj e zonja... kam frikë se do të më gjykoni shumë rëndë, prandaj jua shkruaj këto që të ma lehtësoni fajin... Dhe ju do të çuditi, po duhet ta dini se këto po i shkruaj pasi mbaroi dhe muaji i mjaltit e prej syve të mij më ra perdja që më kish veshur dashuria; tani, dhe asaj që

1) Venera = perëndesha e dashurisë.

nuk i gjeja të meta, po i gjej shumë. E çdo ditë po them: «Ah i ziu unë, ah unë i mjeri! Ah ç'bëra që u martuash në vënt të huaj!» Për dashurinë i harrova që të gjitha: atdhenë, nënën, babën dhe shokët shqiptarë. Po, dhe ata, meqë më këshillonin të mos e bëjja këtë punë, m'u zemëruan e bëjnë sikur nuk më njohin. E unë i harrova që të gjitha për atë vesën: Shumë veta do të thonë: «Ç'gjë e quan vesë».

— Vesë quaj dashurinë se, siç e than atë dielli i mëngjezit ashtu dhe koha e than dashurinë. E në atë kohë kur nuk desha ta kuptoj që jeta e dashurisë është vetëm një ëndër, dolla një mëngjes dhe e pyeta Dielli: «O Diell i bukur, as më thuaj, mos ma more ti, të bukurën e dheut që ma dhe dje duke përënduar?» E ay, me një buzëqeshje, më përgjegjet: «Do të më pyesësh: Pse po qesh? Pse po qesh? Pse të shoh me habi? Eh, more djalë, ti qënke fare naiv... Qesha me ty, o naivi im, se po kërkon atë që do të mos e gjesh dot kurrë më. Nuk më beson? Nuk më beson?..»

«Atëherej shëko lëndinën që është e njomë. A pe të binte shi natën?... Jo... shi nuk ra... këto janë lotët e asaj, që të iku... Dhe unë do të mos kisha dalë, po më urdhëroi ajo të dal e të mbledh lotët e saj. Di-je pra, o djalë, se dashuria mban aqë sa do të më duhen t'i mbleth lotët e saj». Nuk më foli më, po mori udhën dhe, sa më lart ngjitej, aqë më shumë thahej lëndina. Kur u tha fare, mbi veshin tim u ndëgjuan këto fjalë: «Kaqë zgjat dhe dashuria».

Më ndjeni... po le ta tregoj punën me radhë. Nuk hasmë asnonjë ndalim. Të ftuar kishim shumë. Muzika loste e ne kërcenim, Kur po vazhdonte ziafeti më kapi pyetja: «Qindra shqiptarë ndodhen këtu... kam miq... kam soj... kam shokë... Ndava përmi njëqind ftesa e megjithto, nuk ka ardhur asnjë. Pse të mos kenë ardhur?» M'u hap në zemër një plagë, që më mundonte shumë. Do të mejtohesha dhe shumë po të mos kish ardhur Matilda, e cila më pushtoi prej krahu, e më shpuri pranë tryezës së shtruar. Që këtu filloi nisja e fundit. Kur ndenja, më pyeti:

— Pse po rri i brengosur? — po, meqë nuk i dhashë përgjegjie, vazhdoi: — Unë e di pse? Ti, këtu, po sheh vetëm miqt e mij dhe nuk po sheh asnonjë nga të tutë. A duhet të brengosesh për një gjë të tillë kur më ke mua pranë? Apo, për ty, janë, më të shtrenjtë bashkëkombasit që nuk të nderuan në ditën më të shënuar të jetës s'ate?

Nuk dinja ç't'i them: kish të drejtë, se ja kisha thënë të gjitha që më parë. Po dhe unë kisha të drejtë; ja që e bëra pa u mejtuar mirë. Kur u shtruam pranë tryezavë, bëra sikur isha i lumtur dhe bisedonja me sjellje të mirë. E mbajta veten, sado që bisedimi i tyre nuk më pëlqente; fjalët e tyre më dukeshin fare pa kripë. Me një fjalë, që nga dita që hyra në këtë qerdhe, fillova të brengosem. Kur u ndamë, e mbetmë të dy, mora frymë lirisht.

VI.

Jo sikur ish nata e parë që ishim martuar, po sikur kishim disa vjet... Po, me të hyrë në shtëpi, prapë u dehshë prej dashurisë, meqë nuk ish më ajo atmosferë e sallonit dhe zura ta gjej veten të lumtur.

Në mëngjes kur u ngrita, dielli ish ngjitur disa ostena në qiell. Pullumbesha edhe nuk ish ngritur; shërbëtorja na solli kafënë. Rrinim të dy të lumtur edhe asgjë nuk na e prishte qetësinë. Ajo fliste, unë ndëgjonja; flisnja unë, më ndëgjonte ajo. Të gjitha ishin të pëlqyera. Kështu shkoi një javë e tërë. Dhe si shkoi java prapë e kalonim kohën plot me dashuri. Prapë e harrova atdhenë, bashk atdhetarët dhe të gjitha... Kështu shkoi tërë muaji i mjaltit. E pas këtij, munt të them, java e parë shkoi mirë. po të mos i ve në hesap nja dy fjalë të ashpra që më tha Matilda. E, pas pak kohe, kur një mbrëmje u kthyesh nga puna, asaj iu duk sikur qeshë vonuar dhe zuri të më çfryjë. Në zemrën time edhe ishin ndjenjat e para, prandaj u për-

poqa t'a bindnja me logjikë. Me shumë mundime, e qetova për gjysmë; por ç'e do që edhe ishte buzëlëshuar. Nuk i fola më po, duke heshtur, u larguash në odën time. Në këtë hop, më pushtuan mejtimet: solla ndër mënt nënën, e cila m'u duk sikur ish përpara meje e ligur, e verdhur e më shihte ëmbël; m'u dëftye fytyra e babait, që më shihte me të egër dhe m'u ndëgjua një zë: «Prandaj të rrita, a?» Pastaj m'u duk fytyra e vëllait, që ish e pikëlluar e që më tha: «Të tilla shëmbëlla po më jep, o vllaçko i dashur?» Pastaj me qëndroi fytyra e sime motër, që ish plot pikëllim e zëri i saj i hollë më tha: «Qënka thënë që të mos gëzohemi ne, po të huajt!» dhe më në fund më qëndroi fytyra e Shqipërisë, bashkë me një vajzë të bukur; e zëri i saj më tha: «Nuk ta mbushi synë kjo vajzë, po t'a mbushnë synë ato që dinë të të grindin». Në këtë hop, hyri shërbëtorja, se e kish dërguar Matilda të më thërriste: Vajta. Ajo, me të më parë të brengosur, desh të më bente skena. Më tha që nuk e dua... që nuk kam dashurinë e parë që... që... që... Më në funt, u pajtuam. E, kur rashë të fle, thashë me vete: «Mezi i fundit». Nuk vonoi të vinte dhe fundi i fundit, se një ditë kur u kthyesh vonë, se kishim shumë punë në zyrë, na u ngrit një shtërgatë, prej së cilës dhe erdhi prishja. Këtë radhë m'u squa damari i shqiptarit, se kur fliste, duke bërtitur, unë i bërtisnja ca më shumë. Kjo u bë shkak që erdhi fundi i fundit, se shkova nga shtëpia e Matildës dhe tani po rroj vetëm.

VI.

Pas një mot e gjysmë mora ndarjen se, duke e parë që më s'desha të pajtohem, e kërkoi dhe vetë. Tani jam i lirë dhe po pres ditën e mirë që të kthehem në Shqipëri, ku do të mund ta gjej shokun e jetës sime për tërë jetën.

Odesë, 1911

Dielli kish perënduar. Treni shkonte me shpejtim. Bisedimet s'kishin nonjë temë tjetër, përveç luftës. I lodhur dhe i mërzhitur vajta në vagonrestorantin me qëllim ta laknja fytin e thatë. Vagonrestoranti ish plot me njerës, po vërejtjen time ma tërhoqi një grua e lartër, e bukur, me ngjyrën e fytyrës të zeshkë dhe e veshur me gust e shik parizianeje. Kjo zonjë i hodhi sytë më të katër anët dhe zuri vënt pranë derës. Se kë kërkonte. Zura ta studioj dhe do të mund të them, pa u gabuar, që bashkë me të 30 vjete të dukej si 20 vjeç dhe kish më të mirat mënyra të shekullit të 20-të. Desha t'ja ktheja vërejtjen, **po vështrimi i saj kish punë, se po shihte një djalë gjer më nonja 30 vjeç.** I cili po bisedonte me një vajzë. Vajza ish mjaft e bukur, sadoqë e kish hundën pak si të madhe; sytë e saj të zeshkë dhe të vllagshim¹⁾ ishin plot me shpirt; vetullat e dëndura dhe të zeza sterrë; flokët e zes e të krehur bukur dhe gusha e gjatë të bashkuara me buzëqeshjen e ëmbël, ja mbulonin kusurin e vogël. Mi veshin tim arrinin ca fjalë, nga të cilat e kuptova që ishin rumunë dhe shkonin për në Bukuresht. Bisedimi i tyre përmbledhej mi premtime dhe iluzione të jetës së pritme. Ishin të vluar dhe pas ca javësh do të mar-toheshin.

Gruaja që rrinte pranë derës nuk ja hiqte sytë djalit; po dhe djali e vuri re sapo hyri, e njohu dhe përpara syve të tij i erdhi tërë koha e shkuar. Iu kujtua ajo dita kur ish edhe nxënës dhe u njoh, tek e motra e martuar, me atë vajzën e turpëshme, e cila tani, qënka zbukuruar dhe përmirësuar. Iu kujtua koha e gjatë e dashurisë dhe dita fatale kur ja theu jetën. Pastaj iu kujtua si zuri t'i ftohej ndjenja. S'priste ta shihte dhe as që desh se, që nga dita e fundit që e kish parë Dragën, kishin shkuar më shumë se pesë vjet. E unji kokën se kish frikë se mos e njihte dhe

1) vllagshim = me vllag.

ja prishte tërë punën. Ky u njoh me të bijën e Joneskut, e pëlqeu më shumë për paratë, se sa për bukurinë, se ish bërë njeri me hesap. Koha e intrigave të dashurisë i kish shkuar. Zuri të flasë me të vluarën po, mjerisht, mejtimi i kulloste në kohërat e shkudara kur e priste të vinte. Iu kujtua ajo dita, kur iu premtua me betime që do ta dojë gjer në ditën e fundit dhe u droth i tëri.

Desh t'i dbonte këto mejtime dhe porositi garsonin t'i sjellë një shishe me verë, me alkolin e së çilës desh t'i largonte kujtimet e largme që e mundonin. Në këtë hop syri i tij u bashkua me të Dragës, u skuq... s'mundi ta mbajë veten... e përshëndoshi, ja zuri dorën dhe, si automat, ja puthi. Draga e hante me sy dhe me dritën e tyre po e qërtonte. Ay e humbi, duke qëndruar si i ngrirë.

Draga i tha:

— Urdhëroni, rrini! Sapo ju pashë ju njoha, sado që kanë shkuar kaqë shumë vjet.

— Kini ndryshuar shumë... Mezi ju njoha... pastaj, s'e besonja kurrë t'ju shoh në vagonrestorantin e Hungarisë. — i tha Taqua me zë të unjtër.

Draga edhe kish dashuri më Taqon. Ajo e kish dashur të tërë kohën dhe, tani, zilia ja ndezi sytë e rrembat dhe e zuri ndër mënt ta çkëputte nga krahët e asaj hundëmadhes. Nuk dinte si t'i çfaqte të drejtat e saj. Kish pesë vjet që s'e kish parë... nuk ja kish ndëgjuar zërin e tij... nuk ja kish ndjerë firomën... Më parë, ay ish i rrëmbyer. Fliste ç'i vinte në majën e gjuhës, kurse tani e peshonte çdo fjalë. Ajo desh ta kish për ngaherë, desh ta mirrte burrë, se e kuptoj nga fjalët e tij dhe më shumë nga sytë, që martohej për interes e jo për dashuri; andaj e pyeti:

— Cila është ajo vajzë me të cilën udhëton?...

Taqua u ndoht në gjëndje të keqe. Desh ta gënjente. S'mundte ta thesh të drejtën, se fjalën që i dha hundëmadhes ja kish dhënë më parë Dragës. Kjo i tha:

— Kij kuxim. Taqo! Thuajma të drejtën... S'kërkoj asgjë prej teje... koha të liroi nga betë dhe premtimet. Dua të flas me ty si me mikun e vjetër dhe, që të ta zgjith gojën, do të flas për veten time, — dhe, me mjeshtëri artisteje, zuri ta lozë rolë:

— Gjashtë muaj pas pjekjes së fundit, të cilën ti duhet ta mbash mënt, më vdiq një ungji im, i cili më la ca miliune. Koha ma shëroi plagën, se ti e di shumë mirë sa kam vuar nga d... Më humbe nga sytë dhe koha më dha të drejtë t'i shkel premtimet që i dhamë shoqi-shoqit te froni i luleve dhe u vluash me një knjaz rus. Tani kthehem në Bukuresht për të rregulluar punët dhe, pas ca muaj, do të shkoj për në Petersburg, ku do të martohemi.

Vajza, me hundën e madhe, tërë kohën vështronte nga ana e Dragës dhe po përgjonte. Bisedimi i tyre ja zbuloi të shkuarën e të vluarit. Duke parë bukurinë dhe elegantësinë e Dragës, kish frikë mos ja mirrte të vluarin, fjalët e fundme të tij e qetuan dhe e bënë ta shohë Dragën me sy të ëmbël.

Taqon e zuri të dredhurit. I kujtoi ditët e bardha që kish shkuar me Dragën dhe zuri ta fajtonte veten që sillej aq i ashpër dhe i ftohtë me të. Tani filloi ta dojë përsëri, se ndëgjoi që ka shumë para. Ay e dinte që kish influencë të madhe mi të dhe i dukej se, me një fjalë, do ta bënte të tijne. E ajo, duke kuptuar ç'mejtonte Taqua, u ngrit, i zgjati dorën dhe, duke mbajtur zemërimin, që i dilte nga ay vënd ku e kish dhe dashurinë, i tha:

— Rri me shëndet! U trashëgofsh... gjithkush prej nesh e gjeti fatin, — dhe shkoi.

Taqua u kthye në tryezën e së vluarës si nonjë zog i plagosur. S'gjente dot fjalë ç'të fliste, se mëndja e tij e tëra ish te Draga dhe ca më shumë te miliunet e saj. Paratë ja këmbyen mejtimet. E vluara e vuri re ndryshimin dhe e pyeste me fjalë të ëmbëla. Ajo s'mirrte asnonjë përgjegje, se ay ja priste fjalën duke thënë:

— Lermë, për kokën tënde, lermë të qetë, se jam i sëmurë.

— Ç'ke, ç'të dhemb? — e pyeste ajo e turbulluar. Ajo e desh Taqon, se ai ish dashuria e saj e parë. Me ta njohur në shtëpinë e ungjit të saj, pa ndëgjuar edhe nga nonjë tjetër fjalë të mfryta që ta dredhin kokën, e pëlqeu dhe e desh, se, pas mëndjes së saj, ky ish i dërguari i fatit. Ai vishej bukur dhe kish gust në çdo gjë. Kur ja kërkoi dorën nuk ja kundërshtuan, se zemëra e saj ish mbushur me dashuri naive, me të tillë dashuri që do njeriu vetëm herën e parë. Njëmend ajo e njoh dhe me ndjenjën e zilisë. E desh Taqon dhe s'mundte ta linte që t'i shkonte. Ajo e kish ndëgjuar që çdo burrë ka një të shkuar, po nuk e dinte se e shkuara nuk shuhet lehtë. I ati i saj po pinte puron i qetë dhe sytë e tij s'panë asgjë. Ay zuri të tregonte rekëza me të cilat, në vënt që t'i bënte të qeshnin, i malconte që të dy. Taqua ish gati t'ja ipte shkëlmin vlesës. Çdo fjalë e saj e zemëronte. E treni shkonte si vetëtima. Në stacionet, kur qëndronte, shihnje ushtarë, që vinin në kasapanën e botës së madhe, dhe ndëgjonje këngët e tyre, me anën e të cilave i largonin brengat e mfshehta.

— Folë-de, ç'pate që rri i mejtuar? — e pyeti e vluara Taqon.

— Ja, po mejtoj për punërat që i paralizoi lufta, — iu përgjey, pasi u mejtua pak, — Tregëtia vdiq, punëra më s'ka... kapitali po më tretet; si të mos mejtohet njeriu.

— Ç'të ardhë njëmend në kokë këto mejtime? — iu përgjey ajo, duke pandehur se mos me të vërtet ato mejtime e mundonin. — Mos u mejto, se ja, pas dy javë martohemi dhe do të mundësh t'i ndreqësh punët me paratë e mia. — Dhe e shihte veten të lumtur, se zilia i kish lëkur.

— Mirë thua, — i tha Taqua me të ftohtë dhe në trutë e tij i qëndruan këto mejtime: «Me njëzetmijë franga kërkon të m'i ndreqë hallet». E në vesh edhe

i bëhej zëri i Dragës: «Në Petersburg më vdiq një ungli im dhe më la ca miliune». Treni arriu në Bukuresht.

* * *

Taqua çdo sekundë e kujtonte Dragën. I dukej sikur e desh pa masë dhe tërë ditët i humbiste nëpër kafene, restorantet dhe hotelet, ku e kërkonte. Kish vënë njerës më të katër anët, që t'ja kërkonin drejtimin. Asnonjë rezultat. Përpara së vluarës përpiquej ta mbante veten të gëzuar. Nuk desh ta humbiste dhe këtë, se ay e shihte që, njëmend, Draga ish bërë me karakter të fortë dhe s'mundte t'i diktonte. Më parë. dëshirat e tij ajo ja mbaronte verbërisht, kurse tani as që e ndëgjonte. Këto i kuptoi nga që ky priste një posulle nga dora e saj. Vallë mos është martuar dhe rron me emrin e burrit? — i hynë dyshimet.

Kishin shkuar shumë ditë. Draga, nga ditë, mejtohej për Taqon. mirëpo krenaria me vetëdashjen nuk e linin t'i bindej zërit të zemrës, e cila i ish mbushur plot me dashuri.

— Sonte do të lozin Evgjëni Oneginin. — i tha e vluara Taqos. — Babai mori një llozhë. Do të vish me ne sonte?

Taqua pranoi, se një zë i brëndëshëm i thesh: Atje do ta gjesh Dragën.

Kur hynë, në teatro ishin shuar dritat dhe orkestina po loste uvertyrën. Në sallë mbretëronte një heshtje... U hap perdja... U lojt akti i parë. Në antrakt, Taqua e drejtoi dylbinë më të katër anët. Në llozhën e tretë të radhës së parë e pa Dragën. Ish me ca zonja dhe me ca zotërinj. U verth në fytyrë dhe e pushtoi të dredhurit. I kërkoi leje së vluarës dhe doli nga llozha. E kish shpresën ta shihte. Desh t'i fliste nga zemra dhe desh t'i kërkonte ndjesë për tërë fajet. Ish gati të bëhej robi i saj. S'dinte ç'të bënte, se ajo s'kish të dilte.

Shetiti si i lënë në tërë kohën e pushimit. Kur hyri në llozhën me dritë e vluara i dha dylbinë duke thënë:

— Shiko, atje në llozhë është ajo e njohura jonë. Në zërin e saj çquhej zilia dhe me sy po ja vinte re lëvizjet e fytyrës.

— Çudi si qënka këtu, — i tha Taqua, — ajo më tha se shkoi për në Petersburg, dhe, përnjëherej, e këmbëu bisedimin se i dhimbte zemra. Në trutë rrytllonte pllanet që desh t'i bënte në praktikë me miliunet e Dragës. Folë dhe shumë për atë «zonjën me brilante», siç e quante e vluara e tij.

U mbarua akti i fundit dhe njerëzia u ndanë. Taqua i kish dërguar një posulle dhe i lutej të piqeshin në restorant «Kontinental». I dukej se mos e kish punën më vijë. Kur hyri në restorant e gjeti Dragën që e priste. Ja pushtoi dorën dhe ja puthi me zjarr. Me shënjen e saj ndenji dhe rrinte si i lënë. Nuk dinte si ta niste bisedimin. Draga rrinte e mburrur dhe, me një zë njeriu që e ndjen veten, më të lartër nga tjatri. i tha:

— Ç'kishit të më thoshnit?

— Desha... T'ju shoh... Ju e dini që dashuria e parë nuk humbet... nuk duhet... Ju, ju kam dashur...

— Më tutje, më tutje, ç'doni të mos thoni? — ja previ ajo

— Dua... dua të vazhdojmë dashurinë e parë...

— Po e vluara juaj? — i tha ajo.

— Nuk e dua... jo... njëmend e kuptova... Vetëm se nuk e dini ku ndodhi..., po..., prandaj u vluash me të... Tani e shoh që do të mos jem i lumtur me tjetër.

Në këtë hop hyri në restorant hundëmadheja me t'anë. Ajo e pa Taqon pranë Dragës. I ndëgjoi fjalët e tij të fundit dhe i tha t'et:

— Eja të shkojmë që këtu. Më s'mund ta shoh dot me sy... Ay s'është për mua.

Draga s'pa asnjeri. Vojtjet e gjata, që iu kujtuan posi zinxhir, i muar përsipër. Ajo e kish dashur Ta-

qon shumë... me gjithë zemër... Desh ta lithte jetën me të, po, megjithto, e urrente se nuk ish i qëndrueshmë. Iu kujtuan fjalët e tij të ftohta, qërtimet, këshillat dhe ajo ditë që i kish thënë drejt në sy: «S'të dua». S'u mbajt dot dhe me zemërim i tha:

— Dije që jam e lirë dhe që do të të dua tërë jetën, po do të përpiqem të mos të dua.

U ngrit duke thënë:

— Rri me shëndet për ngaherë, mos u përpiq të më shohësh, — dhe e la Taqon vetëm.

* * *

Më të nesërmen, Taqua po pinte duhan dhe po i sillte ndër mënt të gjitha sa ngjanë. E mori dhe një herë letrën që i kish sjellë postieri dhe e këndoi: «Zemra juaj është tepër e gjërë. Më s'jam e vluara juaj. Maria».

Krime, 1915

VASKA, HYSENI E TOLSTOI

Nga që së ndënjuri në shtëpi u mërzita, andaj u veshë dhe mora udhën për në miku im, Hyseni, të cilin e gjeta në shtëpi. Miku posa më pa, u gëzua dhe, duke e lënë letrën që po shkruante, më pyeti:

— As më thuaj si vete nga shëndeti që ishe i sëmurë? Je mirë tani? Pastaj nuk bëre mirë që dolle, se kjo mjegulla dhe notia¹⁾ e sotme, mundin të ta kthejnë sëmundjen, pa e pëson liksh.

E kishe kuptuar, që prej kohej, se miku më don me gjithë zemër dhe kurdoherë kujdeseshe për shëndetin tim. Mirëpo, unë isha mërzitur duke ndënjur tri javë në shtëpi, pa dalë as nga dera. Po ca më shumë më shtyri të dilnja lajmi që këndova në gazetën e fundit që më ardhë nga Rusia: kish vdekur i madhi dhe famëshumi plak Leon Tolstoi. Ky lajm më pikëlloi shumë, andaj duke dashur të lehtësohesha, dolla me mejtim që të vinja në miku dhe t'i thoshe për humbjen që pësoi bota. Kur pushoi miku, i thashë:

— Vërtet ke të drejtë, Hysen, mirëpo ky lajm më hidhëroi shumë, andaj arçe në ty, që, duke ta thënë dhe ty të lehtësohem.

— Ç'është, m'u përgjegj me rrëmbim miku, — mos na bënë dhe nonjë tjetër gjë xhonërit?²⁾ Mos i

1) notia = lagështia.

2) xhonërit = xhonturqit, turqit e rinj.

zunë që të gjithë atdhetarët dhe i dërguan në Jemen ose ngjetkë syrgjyn?—Oh, ne të mjerët, njëmijë e një pësuam nga ky i vetëdhënë hyrijet! Thuajma de të shkretën ç'ngjau, se unë nuk jam në vete. Thuajma, të lutem, ç'është, që të dimë ç'të bëjmë; të shkojmë a? Të fshihemi gjëkund në ardhka ngjer më kaqë? Ose më mirë të marrim armët dhe t'i biem atij më të madhit.

Miku u turbullua shumë; u skuq, u bë i kaltër në fytyrë; fjalët i dilnin me rrëmbim dhe ish gati të vriste shumë armiq. Unë qëndrova duke thënë:

— Mos u nxeh, të lutem, pa mësuar si qëndron puna, po ndëgjomë me gjakftohtësi.

— Si the, more, — ma preu fjalën miku, — me gjakftohtësi? Vallë ç'të ndëgjoj me gjakftohtësi? Mbylljen e shkollave? Konfiskatën e shtypshkronjave? Vrasjet në Shqipëri? Zinë që u suallë ndënjësve apo të burgosurit e atdhetarëve? Pastaj, më thua të të ndëgjoj me gjakftohtësi, vallë ç'mbeti pa bërë? Të na marrin që të gjithëve dhe të na pjekin në hell, kjo vetëm mbeti?

Duke i thënë këto, miku u ngrit më këmbë dhe bariste i furosur këtej-andej. Unë e ndjenja veten shumë të dobët dhe padurimi i mikut më dobësoj fare. U ngrita më këmbë e zura mikun prej dore dhe i thashë:

— Shumë të lutem, të më ndëgjosh dhe të mos ma preç fjalën, se unë dua të të them gjera të ndryshme dhe jo nga ato që pandeh ti. Puna është se vdiq një shkrimtar i math i Rusisë. Tolstoin e ke ndëgjuar?

— E, e kam ndëgjuar, — m'u përgjegj miku me qetësi, duke më shikuar mua me çudi nga që ay ish i sigurt se do t'i flisnja për ngjarjet e Shqipërisë. — E qe me të qe? Vdiq, vdiq, Perëndia e ndjeftë.

— Ja, s'më kupton, — i thashë mikut dhe e pashe me habitje se nuk e besonja kurrë që do ta ndëgjonte vdekjen e famëmadhit shkrimtar me kaqë qetësi dhe pa ndjerë pikëllim. — Unë të them që vdiq

më i madhi burri i botës, e ti më përgjigjesh «ç'ke me të». Nuk e di ti që janë të rrallë shkrimtarët si ay? Nuk e di ti që ay nuk kishte kundërshtar?

— Mirë the. — m'u përgjigj me zemërim miku dhe më pa me një vështrim të keq, nga i cili kuptova që fjalët e mia e mundonin miken dhe le që nuk gjente kënaqësi me të, po edhe shumë mërziteshe: le të qe i math sa që të desh. Kur nuk ish shqiptar, ç'ke me të qe ish i madh.

Miku edhe pasonte të bariste nëpër dhomë, nga që ky bisedim, i cili i dukesh shumë i mërzitshëm, e lodhi, dhe ai ndenji me anën tjetër të dhomës.

Unë u ngritshë nga vendi, i vajta pranë mikut. Ndenja më një fron dhe i thashë:

— Si nuk e ke kënduar Tolstoin ti, a? O more dhe ti! Ti paske humbur gjysmën e jetës. — Pasi i thashë këto, nxora nga xhepi gazetën, e hapa në faqen që shkruante për vdekjen e Tolstoit dhe nisa të këndonja duke thënë:

— Ndëgjomë, të lutem, që të dish dhe ti ku vdiq i ralli plak.

— Po, mirë dhe këndo, — më tha me mërzitje miku.

Unë nisa këndimin: «Sot në mëngjes, i ralli dhe i pashokëti¹⁾ plak vdiq në stacionin Astapovo».

— Për Perëndi, nuk kuptoj dot asgjë me ty, Vaskë, — nisi të më fliste me zemrim Hyseni. — Ngrihesh nga shtëpia, ne të këtillë kohë, kur shpesh do mundish të marrësh plevitnë, dhe më vjen këtu se paska vdekur një plak. Po, vdiq dhe vdiq, nuk do bëheshe shka-bonjë qe? Plak ish.

Nisa ta sbutnja miken dhe me njëmijë e njëqint belara mezi e binda. Kur u fut pak brenda në çështjen, miku më tha:

— A, i këtillë ish ay plaku që vdiq në Astapovo? Desh njerëzinë? Predikonte dashurinë, vëllazërinë? Kështu më thuaj de të shkretën? Ti e ke fajne, Vaskë,

1) i pashokëti = i pa shoqi.

se nuk më the më parë ç'ish, po më the drejt për drejt që vdiq një plak.

— Pas mendjes tënde kam faj unë, — ja rrëmbeva fjalën mikut, — mirëpo, pas mendjes sime, nuk kam faj nga që nuk e besonja kurrë që të mos e dije atë famëmadh burrë, që e dinë dhe të egërit e Afrikës.

— A, more de ti, Vaskë, se ngjer ku vete! Sikur neve kemi shkuar më larg se të Afrikës! Po, neve do kishim shkuar shumë më larg, mirëpo nuk na lanë ata... nu... ç'të ta them që... ata, pa ti e kupton...

— Ata, me të cilët na ka lidhur fati këtu e 450 vjet, kërkon të thuash, Hysen?

— Po ata, — ma rrëmbeu fjalën Hyseni. — Ata që thonë se do na i çkulin gjuhën dhe të cilët, pasi e shtrovi Shqipërinë Turgut Pasha, e vunë festen mënjatë se e pandehnë se mos i mori armët pashai. Po, ata... ata që mos qofshin më mirë... — dhe heshti miku pak e tha: — Pa t'i lëmë ata, që m'i lëntë Perëndia pa kokë dhe le të vimë ne plaku Tolstoi. Po kështu ë, plaku që vdiq ishte njeri i madh dhe shkrimet e tij janë të rralla.

— Po, i dashur Hysen, shumë më vjen keq që nuk paske kënduar asgjë nga veprat e Tolstoit.

— Po si do mundnja t'i këndonja unë, more Vaskë, — m'u përgjeq me buzëqeshje Hyseni — se mos janë shqip? T'i si duket, harrove që unë nuk di rusisht?

— He, po tjetër gjuhë nuk di ti, a? — ja preva fjalën mikut duke ndjerë gas në zemër se miku nisi ta simpathizonte Tolstoin.

— Po, se mënt harrova; ti përveç shqipes dhe turçes, nuk di tjetër gjuhë. Që të jetë përkthyer Tolstoi turçe nuk besoj, nga që ay më shumë vise ngojos Krishtin dhe Perëndinë; prandaj nuk e besoj që të jetë përkthyer, se ata janë shumë fanatikë. Pa, sa për shqip, jam i sigurt që nuk është ëdhë, po munt të ndodhen njerëz që ta dinë gjuhën e tij dhe e përkthejnë dhe shqip, që ta këndojnë dhe ata që nuk dinë gjuhë tjetër.

— Po ktheje ti, — më tha me rrëmbim Hyseni — ktheje që ta këndoj dhe unë, si dhe shumë të tjerë si unë.

— Mirë, ja do ta përkthej, do të të ndëgjoj, o Hysen. Po, që të munt ta përhap duhet shtypur, e unë që ta shtyp para nuk kam; botonjës që të ma blenë përkthimin, për fat të keq, ne shqiptarët edhe nuk kemi; pa ta përkthej dhe të lodhem çesa muaj ose vite dhe ta vë në sëndyq që ta hajë tymi, nuk kam kam ndër mënt; andaj nuk do ta përkthej, sadoqë dëshëronj me gjithë zemër që ta benj këtë punë.

— Për ta shtypur nuk të zotohem, — më tha duke qeshur Hyseni, — po sa për ta kënduar, meqë ma lëvdove kaqë shumë, sado që të kushtonjë do ta ble, se ti shumë më kureshtove.

U fjalosmë dhe shumë orë me miknë gjithë për Tolstoin. Kur unë shkova, miku kish arrirë jo vetëm ta simpathizonte, po dhe ta adhuronte.

II.

Tre muaj kishin shkuar që nga dita e vdekjes së Tolstoit dhe të bisedimit me miknë dhe që nga ajo ditë nuk e kisha parë Hysenë. Unë nuk kisha dalë nga që miku doli profet, se që atë ditë u ftoha dhe më ktheu sëmundja, mirëpo tashi nuk kisha rënë si ahere, po e kisha plevit. Kisha kthyer për mirë, pasi pësova shumë; po të dilnja nuk kisha marrë leje nga shëronjësi ¹⁾ dhe as që kuxonja, se kisha frikë se mos e pësonja fare liksh. Miknë nuk e kisha parë dhe më kish marrë malli shumë, po nga që e dinja se ndodheshe në çiflik andaj nuk e fajtonja për mosardhjen e tij. Në atë hop që kujtova miknë, u hap dera dhe hyri miku i mallëngjyer shumë, dhe me të afruar, pa pyetur si jam dhe si ja shpie, me zë të fortë më drejtoi posi breshër këto fjalë:

1) Shëronjësi = mjeku.

— Ama dhe ti, Vaskë, më lavdove një plak duke thënë që ay është më i madhi shkrimtar i botës. Më marrtë të keqen e Gramenos¹⁾, ku di ay të shkruaj. Fundi ç'më ka shkojtur? Ca përralla, po dhe ato, pa nonjë ëmbëlsirë shkrimi, po me fraza posi të vdekurra, me sllog²⁾ posi të ngordhur; me fjalë të tjera, plakat tona mundin të rrëfejnë njëqint mijë herë më të mira. Kur nuk ke kuptuar gjë, ç'të të them unë. Vete më turbullon aqë shumë, sa edhe sot s'e kam marrë veten që nga ajo ditë. Pastaj më quanje të marrë se nuk e dinja Tolstoin, i cili paska shkrojtur ca përralla. Ku je ti sa më të mira janë të Kalimasë!³⁾.

Me të pushuar miku, e mora unë fjalën dhe i thashë:

— Duro pak të lutem se jam sëmurë. Folmë me zë të unjtër dhe mos u turbullo, po rrëfemë çkoqur si qëndron puna që të kuptoj dhe unë. Pa thuajmë, të lutem, si e këndove Tolstoin? Apo mos e këndoi njeri dhe ta tha ty aqë liksh sa s'e çuptove?

— Jo, jo, — ma rrëmbeu fjalën miku, unë e këndova vetë dhe e këndova shqip nga që i lëvduari Aleks Koçi na e përktheu.

— Kush, more! — dhe u hodhshë nga shtresa. — Aleks Koçi! Ç'thua, more? Po ay e parë e punës nuk di rusishten; pra si munda ta përkthenjë?! Pa nema, të lutem, që ta shoh, ç'ka përkthyer prej të Tolstoit.

Miku futi dorën në xhep, që ku nxori një libër të hollë, përmi të cilën ish fytyra e famëmadrhit plak. Me rrëmbim i këndova që të dy rrëfenjat: «Mbret i Asirisë Asarhadoni» dhe «Tri pyetje», të cilat ishin përkthyer jo mirë. Nuk desha t'i ndanja me miknë, përshypjet që më dha përkthimi po, duke dashur që simpathia që ja futia pa kënduar Tolstoin t'i mbetesh, i thashë:

— Thuajmë, të lutem, ç'domethënë graf?

1) Gramenos = Mihal Gramenos.

2) Sllog = fjalitë e dyta ndërmjetëse.

3) Përrallat e «Njëmijë e një netëve».

— Nuk di as unë ç'domethënë kjo fjalë, po si duket do jetë titull. — Dhe më pa drejt mikut, nga që, si e kuptova, dhe mikut do mos e kish vënë re këtë fjalë.

— Po, titull, — i thashë me shpejtim mikut, — dhe graf d.m.th. «kont», mirëpo meqë përkthenjësi i di mirë që të dy gjuhët andaj e la ashtu si ish sllavëve, nga që u mejtua se do të jetë më mirë që ta huajmë këtë fjalë nga sllavët se sa nga latinët.

— Po sido që të më thuash, — me vërtetim,¹⁾ — Tolstoi nuk qenka nonjë njeri i rrallë, se nuk ka nonjë mejtim të thellë, — këtu: përrallë dhe jo gjë tjetër.

Fjalët e mikut më vunë të mejtohesha dhe t'i vinja pyetje vetes: «Vërtet, shumë do ta humbasin simpathinë që ndjejnë për Tolstoin, duke kënduar të parin dhe të rrallin përkthim në gjuhën shqipe. Duke mejtuar këto, i shtiva sytë mi miknë, i cili kish marrë librën e Tolstoit dhe po i shikonte fytyrën. Vështrimet na u bashkuan dhe mikut më tha:

— Kjo fytyrë, vërtet, duket si shumë e lëruar.²⁾ Po... dhe e preu fjalën, siç dukej, nga që nuk desh të më zemëronte, se e kuptoi që unë qeshë adhuronjës i të rrallit plak.

— Ndëgjomë, Hysen! «Dhe kali i mirë qorolliset»; thotë fjala shqipe. Këtu, unë, nuk dua të them që Tolstoi u qorollis, po dua të them që këto nëmërohen më të dobëtat nga veprat e tij. Tolstoi, në fitoi madhësinë, nuk e fitoi me «Mbretinë e Asirisë» as me të «Tri pyetjet», po e fitoi me të tjera; si, me «Sonatën e Kreutzerit», me «Kozakët», me «Anna Kareninën», me «Luftën dhe paqen», me «Ngjalljen» dhe me ca të tjera. Këto, o i shtrenjtë mik, që për fat të keq na u përkthyen shqip, munt t'i quajmë të shkarat e pendës së Tolstoit. Dhe kështu, të shkarat e pendës të të lartit burrë, na i shtiu fati që të na i përkthejnë shqip; pa

1) me vërtetim = me siguri.

2) e lëruar = e zhvilluar.

le me ç'gjuhë? Po, me ç'gjuhë të them dhe dua të të them që gjuha është e pakuptuarshme. — Kur heshta, miku e mori fjalën dhe më tha:

— Po pse, nuk janë këto që të gjitha sa ka shkrojtur Tolstoi? Kur është ashtu, përse nuk ka shkrojtur që vazhdon?

— Prapë nuk më kupton, Hysen! — iu përgjeqshë mikut. — Këto qenë dy rrëfenja, të cilat u mbaruan, po ka dhe të tjera, se Tolstoi ka shkrojtur më shumë se 15.000 faqe dhe jo vetëm dy rrëfenja, dhe më të shumat janë për shëmbëll.

— He, kështu qenka?! — më tha me pendim miku. — E unë, pasi këndova këto të paka faqe, nisa të kritikojta të varfërin plak.

— Ti ke të drejtë, — iu përgjeqshë mikut, me gëzim, — se bota, kur përkthejnë, përkthejnë kurdoherë nga më të mirat dhe jo nga më të ligat; se ja këto dy rrëfenja, që u përkthyen shqip aqë bukur sa nuk meritojnë as kritikë, besoj që nuk janë përkthyer as më nonjë gjuhë tjetër.

Pasi i ndëgjoi që të gjitha këto, miku ra në mejtime, dhe pas pak duke u ngritur, më tha:

— Më ndje, se të ngrita prehjen shumë. Ti edhe të shikoj qenke i sëmure. Nga fjalët e tua kuptova që fajne nuk e paska Tolstoi, po përkthenjësi, andaj do pres gjer sa të kthehen kryeveprat e Tolstoit, pa këto do t'i këndoj shkel e shko.

Miknë e qëndrova dhe ndenji prapë. Këtë kohë biseduam për shumë gjëra: gjendjen e ligë të Shqipërisë, urinë që mundon të ngratët ndënjësit e të dashurit tanë atdhe, mos mbjelljen e të tre vjetëve, shovinizmin dhe marrëzinë e honeve. Pasi i mbaruam këto, miku duke parë rreth e rrotull, më tha:

— A ke njeri këtu, Vaskë, — dhe më pa me një vështrim të zjarrtë, nga i cili dilnin shkëndija. Unë nuk dinja se ç'të mejtonja për këtë dhe i thashë:

— Përse më pyet a ka njeri, Hysen?

— Më thua përse të pyes. Të pyes se dua të të them

ca fjalë, të cilat nuk dua t'i ndëgjojë dot tjetër njeri, se kam frikë mos më kallzojnë.

Pasi mori përgjigje që nuk kish asnjëri tjetër, përveç s'ime mëje, më tha:

— A do ngrihen vallë malësorët sivjet? A do dalë Isa Boletini?

— Gjethi, i dashur Hysen, ay do na i dëftënjë, — dhe një e teshtitur ma preu fjalën.

Miku, nga që ish disidemon, ¹⁾ më tha:

— Me shëndet. Vërtet do ngrihen kur do nishjë të gjelbëronjë gjethi?

Pas kësaj u ngrit, më shtrëngoi dorën dhe më tha:

— Shëndet të dhëntë Zoti, Vaskë; rri me shëndet, pa Tolstoin do pres që ta këndoij, — dhe kaptoi praktinë.

Në trutë e mi rrotulloheshin mejtimet: «O i shenj-tëruar plak, përse nuk të lënë të qetë atje ku je, nën dhenë e Jasnaja Polanës, po nisin të falsifikojnë ca që nuk të kuputojnë shpirtin, po vetëm fjalët?»

Odesë, 25/III/911.

ÇAPI I PARË

— Të më sqosh, nënë. të më sqosh — i tha Kola s'ëmës, pasi ja puthi dorën e saj të fishkur e të rrudhur, kur ra të flërë. E ëma, pasi e puthi, e shtrëngoi në krahët e saj e e mbuloi, nisi të punonte çorapin që e kish nisur prej dy ditësh e prej të cilit do të mirrte pesë grosh.

* * *

Kola ish një djalë gjer në nonja 13 vjeç, i bardhë, i bulkur, me sy të shkruar dhe shumë i mbarë. Kurrë nuk ja kish bërë fjalën dy s'ëmës. Sytë i kish plot me magnat dhe me to fitonte simpathinë e të gjithëve. E Cokja, e

1) disidemon = supersticioz.

ëma e Kolës, kish disa vjet që nuk mirrte nga i shoqi letra me rregull; ky tërë jetën e tij e kish shkuar në kurbet dhe, sadoqë kish 28 vjet që ish martuar, po t'ja bënë mirë hesap nuk kish shkuar pranë saj as dy vjet. Ajo kish lindur dhe fëmijë të tjerë, po ja kish rrëmbyer vdekja dhe i kish mbetur vetëm Kola, djali i pleqërisë, mi të cilin e kish vënë tërë kujdesjen e saj. Dhe sadoqë i shoqi kish kaqë vjet që nuk po i dërgonte, Cokja u kish bërë ballë gjithë nevojave, duke punuar çorap e punëra të tjera të dorës. Kështu e kish rritur Kolën. Gjer në këtë kohë, Kola vinte në shkollë: mësoi mjaft sa e mbaroi rreshtin e pestë të fillores. Po kur u fut në të fshehtat e halleve të shtëpisë, të cilat i mori vesh prej s'ëmës kur kujtoi çkujdesjen e fqinjëve, pa kohë djali u fut në mejtimet e kujdesjeve. Dhe ky, kur mbaroi rreshtin e pestë, i shpuri s'ëmës notat e shkollës dhe duke e vështruar t'ëmën ndër sy, me lutje i tha:

— Nëno, nuk dua të mësoj më! Dua të hyj çirak e të fitoj para! se... — dhe iu derth s'ëmës, e pushtoi pas qafe, me kryet futur në krahëruarin e saj... — se dua të fitoj para... se u bëra burrë. E ëma duke ja pilluar flokët e puthte dhe i thosh:

— Do të fitosh, biro, do të fitosh!

* * *

Ish dimër. Mezi i natës. Cokja pasi e mbaroi njerën grykë të çorapit, shoi gaznikun, mbuloi zjarrin dhe u fut në rrobat ku, qëkur, po flinte Kola. Ky kish dy muaj që kish hyrë çirak dhe, nga natë, i lutej s'ëmës ta sqonte që në mëngjes, se kish frikë mos vonohej. Jashtë era frynte si e marrë dhe e ngrinte dëborën, që kish rënë tri dit me radhë. Ora shkonte. Furfurina ndëgjohej duke vërshtëllyer. Kola flinte si shqerrë, se ish i lodhur... Ora shkonte... Cokja sqohej dhe i hihte sytë nga i biri, ja ndreqte kryet që i varej, e mbulonte dhe prapë tulatej. Po, na, ndëgjonte zërat e këndezave që ishin si zinxhir: pa reshur njëri, ja thërriste tjetri. Nga këto e kuptonte që kish arrirë koha për t'a squar Kolën. Ajo e shihte të birin si

flinte ëmbël, i vinte keq ta sqonte, se kujtonte lumtërinë e të tjerëve. I largoi mejtimet, i hcdhi mbulesat prej vetes, u ngrit më këmbë dhe, duke ndëgjuar zërat e punëtorëve që shkolin rrugës, ndezi zjarrin. I vinte keq ta sqojë, po asaj i dukej sikur i thesh zëri i këndezit:

— Sqoje, sqoje... shkoi koha!

Ajo iu afrua djalit dhe desh të largohej, po përnjëherë iu kujtua «detyra qëndron më lart nga dashuria», me përkëdhelime, me fjalë të ëmbëla i thesh:

— Ngrehu, bir, ngrehu; ngrehu, shpresë, ngrehu... ngrehu t'u bëfsha kurban, ngrehu se u gdhi... ngrehu de... — dhe shumë përkëdhelime e fjalë të ëmbëla që dinë t'i gjejnë vetëm nënat e që dinë t'i flasin vetëm buzët e tyre.

E Kola sy mbyllur i thesh:

— Është shpejt, moj nëno, është shpejt... ja dhe një çikëzë... është shpejt, ja u ngrita... dhe, duke u kthyer nga ana tjetër, e zinte gjumi.

* * *

— Pse nuk më sqove më shpejt moj nënockë? — i tha Kola s'ëmës, kur u ngrit duke shtrëmbëruar buzët e duke përpjekur këmbët. Si u la e u vesh, u shtrua pranë vatrës, ku digjeshin dy dru, që lëshonin më shumë tym se sa flagë. E ëma ja kish bërë gati kafënë, të cilën po e hante me bukë të zezë, duke e ngjyer me riska të mëdha. E kur e kish gojën pa bukë, kthehej nga e ëma e i thosh:

— Të thashë, moj nëno, të më sqonje shpejt, pse nuk më sqove?

Prapë e mbushte gojën me bukë të ngjyer. Dhe e ëma, duke vështruar të birin me mall, i thesh:

— Je shpejt... je shpejt... s'ka shumë që ra toka ¹⁾ e mëngjezit.

Kola as që i ndëgjoi fjalët e s'ëmës: duke u mblaçitur veshi pallton e trashë e t'arnuar, mbathi këpucët e rënda që ja kish bërë ustai, lidhi shaminë qafës, i puthi dorën s'ëmës dhe doli me shpejtim nga shtëpia.

1) toka = një copë pllakë hekuri që është varun në kambancinë e kishës dhe i bihet me raste festash.

Udha ish e hapur. Kola shkante me nxitim pa vënë re gazin, qejfet e nxënësve dhe arriu te porta e dyqanit. Me ta parë që dyqani ish i mbyllur, mori frymë, shkundi dëbcrën dhe po priste, duke mos i hequr sytë prej dëborës që ish mbledhur te dera. Kur ktheu sytë, pa ustandë që ish i veshur me qyrk, që kish dorashka, shoshonje dhe një shall të trashë qafës. Kola mezi e hapi dyqanin, pasi e grëu dëborën me duar. Kur ja ktheu kyçet ustait, ky i tha:

— Hajde, djalë... ndize mangallin, po mos para verë shumë gymyr.

Kola e ndiste mangallin dhe e vinte pranë ustait. E ky, me ta parë që rrinte pa punë, i thesh:

— Hajde, djalë... fshije dyqanin dhe çapu mbush ujë!

Kola fshin dyqanë, merr buçelen e vete për ujë. Kur kthehet në dyqan ka mardhur, është bërë koçan. Po ustai i thotë:

— Hajde, djalë... ndreqi topat.

Kola nis e ndreq topat, i vë në raftet, i zbret dhe prapë i vë e prapë i zbret, se ua rrëfen myshterinjve u lëvdon mallin, u bën be që e shesin në serme...¹⁾ E pasi bie këmbana, i thotë ustai:

— Hajde, djalë, shko, çapu në shtëpi e na sill drekën.

E prej kësaj dreke Kola ha të mbeturat e ustait... Dhe pas dreke prapë: fshi dyqanë, mbushna ujë, tregcje mallin, shpjerua në shtëpi e të tjera. Këto zgjatin gjersa cipa e zezë e mbulon dhenë që e mbyllin dyqanë. Ahere Kola merr frymë, sulet me të katra, vete në shtëpi, ngrohet pranë vatrës e krahëve të s'ëmës dhe thur ëndrrat e jetës.

Odesë, 1910

L Y P Ë S I

Ora ishte tetë. Dielli po fshihej prapa maleve, mi të ciut zbarthte dëbora, dhe dukej si nonjë top i math e i purpurtë. Qiellin, në shumë vise, e kishin pushtuar retë.

1) në serme = në kosto.

dhe ato që ishin pranë diellit që perëndonte dukeshin si të lara me flori. Në këtë kohë, unë isha në kopshtin e Borisit dhe, me librën, në dorë, po rrinja pranë liqenit të mjeshtëruar mi të cilin, me madhështi e kalorësi, po uqtaq e vogël, që bënte këmbët e tyre kur çanin ujin, bashkohej me melodinë e zhabave. Në mes të tyre kish solo, alto, diskanto; kish tenorër, basër, baritonër dhe shumë soprano. Mi veshuri tim qëndronte kori i tyre, që ish pa armoni dhe që falsonte shumë shpesh. Me gjithë këtë me kënaqësi të madhe e kujtoj korin e tyre, i cili i bashkuar me fëshfëritjen e fletëve të drurëve prej erës së hollë, me këngën e gjinkallës dhe me cicërimin e nonjë shpendi, që lëvrinte nëpër fletët e plepit të hollë e të gjatë, më dukej si nonjë simfoni e pambaruar.

Të tilla mbrëmje mbaj mënt shumë. Po kjo, për të cilën po bëj fjalë, m'u rrënjos në trutë e mi dhe më mbeti e paterur.

Dielli kish humbur dhe e pushtoi tokën të mugëtët. Unë vazhdonja ta ndëgjoj melodinë e të vështroj mi faqen e librës, që e kisha hapur qëkur. Në këtë kohë, përpara meje shkoi një djalë gjer më nonja dhjetë vjeç, më pa me sy të frikshëm, e hapi gojën dhe e mbylli përnjëherej, u largua, prapë m'u afrua dhe, pasi mori pak kurajo, më tha, me një zë të drethur e të unjtër, ca fjalë, më një gjuhë që nuk e kuptonja. Fjalët e djalit u bënë shkak që ngrita kryet dhe e pashë. Ju thashë që ish i vogël, po ish dhe çalaman, se njerën këmbë e kish si drapër dhe, kur ecte, trupi i tij, që ish i hollë si i ngjalës, tundej shumë pas çdo çapi që bënte. Fytyra e tij, që ish ca e djegur prej diellit e ca e nxirë prej të palarit, dukej si prej arapi. Mirëpo leshrat i kish të verdha, buzët shumë të holla, si dhe gjithë shenjat e fytyrës të rregullta. Dhe kështu, këto, të bashkuara tok, tregonin se do të ish prej shtëpie fisnike. E, në këtë kohë, djali më tha me zë të unjtër: «Molem gospodin»²⁾. . . Me t'i ndëgjuar veshi im këto fjalë, m'u largua melodia dhe ja humba sërën simfonisë së zhabave.

1) plevatnin = notonin, notonin.

2) molem gospodin = të lutem zotni.

Nuk e mbajta dot veten, se sjellja e djalit më xhëndosi, u ngrita dhe, si i marrë, automatikisht ja hoqa kokës, duke i thënë shqip: «Mos më çaj kokën;.. Nuk e sheh se kam shumë punë... se po zbavitem me zhabat?...»

Kur u largua e vura re që ecte me shumë mundime; mirëpo, furia ime ish aq e madhe sa që edhe e vështro-nja me sy të egër. Lavdi Zotit që u çduk dhe më s'ma çau kokën.

* * *

Vazhdonja të ndëgjoj melodinë e zhabave. Ora e qytetit trëngëlliti nëntë. Dhenë e kish pushtuar errësira. Melodia më s'po dëgjohej. Barku më kujtoi të ngrihem. Dolla prej kopshtit dhe shkonja me çape të shpejta duke vështruar bullgarkat, të cilat nuk ma mbushnin syrin, se nuk ishin gra, po, djemë o Perëndi, karikatura. Uria më bëri të shpejtoj çapet. Duke shkuar përpara një avllie, të rrethuar me dërrasa, mbi sofatin e gurtë që ish te porta, po rrinte ay djali, që ma prishi qetësinë e zbavitjen, dhe po qante. Më ardhi shumë keq dhe, posikur nuk isha vetë dora që i rashë kokës, iu afruash. Po sa ish çudia ime, kur djali, me të më parë që afrohesha, u sul dhe zuri të largohej. I fola me të ëmbël, me fjalë të buta. Nuk më fliste, po më shikonte si nonjë këlysh i rrahur. Iu lutshë dhe i thashë se do t'i jap një grosh. Fjala e fundit ja qëndroi këmbët dhe, me ta marrë paranë, të cilën ja hodha përdhe, u sul, i ra portës me të dy duart dhe humbi. Më pushtoi një kuresht dhe shkova pas tij. E hapta derën, që ish bërë prej tri dhogash të mbërthyera, që kish një dorëzë të drunjtë dhe që s'kish as kyç as rezde. Me të hyrë pashë një copë tokë, mi të cilën kish mbirë bar një herë, po tashi e kish djegur dielli. Retë ishin larguar, qielli ish i kthjelltë. Hëna, që ish e plotë, i hithte shkënditë e saj që nga lartësia dhe ish e begendisur jo vetëm për të pasurit, po dhe për të varfërit. Kur më pa djali që hyra brenda, u trëmb, shtyri derën e mezit dhe, i frikësuar, u fut brenda. Siç dukej, kish frikë se mos ja mirrnja paranë. Hyra dhe unë pas djalit dhe përpara sy-

ve të mij u dëftye kjo tablo: Një grua me leshra të zeza sterrë, me sy të zes si ulliri, e të futur në fytyrën e tretur, me faqe të venitura e me buzë të thara, ish shtrirë mi një qilim të vjetër dhe ish e mbuluar me një jorgan të vjetër e me shumë arna. Pranë saj qante një djalë gjer më nonja pesë vjeç. Në odë ishin dhe ca pjata prej çingoje, që ishin hedhur pa rregull. Nga kjo pamje m'u droth zemra, po ca më shumë më ardhni keq kur pashë që djali i çalë, të cilit i dhashë groshin, duke e shtrënguar paranë, i vajt pranë s'ëmës dhe u fsheh prej syrit tim nën jorganin e saj. Gruaja e shtrirë, me të më parë, më hodhi një vështirim posikur më pyeste: «Ç'do këtu?». I mata me sy të katër muret që nuk dukej të ishin të sigurtë prej notisë, iu afruash gruas dhe, me zë kujdesjeje, i thashë:

— Më ardhni shumë keq për djalin, moj zonjë, prandaj hyra.

Nuk munda të flas më se djali i çalë e nxori kryet prej jorganit dhe më shikoi me sy të ëmbël: i mesmi iu afrua s'ëmës dhe i tha: «Më hahet bukë» e i vogli, që s'ma zuri syri kur hyra, zuri të qante: «Ua-ua-ua! . . . » Gruaja, pasi e puthi të mesmin, mori të voglin, çkopsiti krahërorin e saj, që nuk ish asgjë tjetër po vetëm lëkurë e koska, dhe ja nguli kryet.

Desha të flisnija, po e quajta për mëkatë t'a hap gojën, unë i çkujdesuri, në atë shtëpi ku mbretëronte nevoja. U ngrita dhe, pa u vënë re prej gruas, lëshova përdhe pesë franga dhe shkova, i pushtuar prej mejtimeve për fatkeqen shtëpi, që kish mbetur në duart e nevojës, të urisë e të pësimeve.

Sofje, 1912

PA STREHË

— E ç'tëre, a gjete shtëpi? — e pyeti Dila Lecin, që ish i veshur me brekushe, i parrojtur e që dukej si hieja e t'et të Hamletit.

Ay e pa të shoqen, mori frymë me të shpejtë e gëlltiti pështymën e pa dhe një herë në sy dhe i tha:

— Eh moj grua! Gjërät e lira shkuan bashkë me turkun; tani, bashkë me lirinë na erdhi dhe shtrenjtësira. I thashë Gjon Conit për atë shtëpinë që ka me një odë përdhese e pa tavan e me një kuzinë si haur. Më kërkoi një napolonë e gjysmë. Mirë është ta marrëm, po ku t'i gjejmë paret për ta paguar. Pastaj lyp për dy muaj në dorë.

Dhe, duke e mpështetur kryet mbi duart, ra në mejtime të thella. Dila e shikonte të shoqin në fytyrë, ku i ish vënë vula e kujdesjes, dhe i tha:

— Alla hile ç'do të bëjmë? Sot ish Gjysh Cani dhe më tha që të mbaremi nga shtëpia, se dhe këtu afati ka dy muaj që ka kaluar. Qysh do ta bëjmë? Qiratë aqë shumë u shtrenjtuan sa nuk jetohet dot. Ndue Gjysh'i mori çadrën dhe shkoi e u vendos në zallin e Kirit. A vemi dhe ne: kam një çadër që nga koha e turkut. .

— Mirë, mirë thua, moj grua, mirëpo ne jemi me fëmijë; atje ka lagështi e mund të na plevitosen fëmija.

Kërkuan dhe shumë kohë e shumë herë, po asgjëkundi nuk gjetnë dot shtëpi: ku gjenin nonjë si të lirë ua lipnin qiranë për dy muaj peshin ¹⁾ dhe, kështu, u shtrënguan të vendosen nën çadër në Zallin e Kirit, të larguar nga qyteti si të dënuar nga gjyqi i parasë.

* * *

Çeli agimi. Dielli, që prapa maleve që tregonin krenarinë e Shkodrës, e zbardhëlloi qytetin, kishat, xhamitë, pallatet, kasollet, si dhe çadrat e fukarasë, se ay është i begendisur për të gjithë. Marku me Prenkën, djemtë e Lecit, duallë nga birat e çadrave, dhe të çkujdesur, filluan të losnin, meqë ata édhe nuk kishin arrirë të hynin në fshehtësitë e kësaj jete, që është mpështetur mbi paranë. Dielli po çapitte, mengadalë dhe i çkujdessur, në qiellin pa fund, kur pa ndalim e kur i penguar prej nonjë reje. Leci kish shkuar me kohë në qytet, kish pritur te zyra e punës e kish punuar gjithë ditën për shtatë grosh. Mbrëmave u kthye në shtëpi me bukë kallamboqi e kos. Pasi e lanë gjysmën e bukës për të nesërmet, gjysmë të ngopur ranë

1) për dy muaj peshin = dy muaj paratë në dorë.

të flenë. Kështu shkoi një muaj e një tjetër. Po një ditë ra një shi që zgjati shumë kohë. U bënë pëllgje dhe u fut shumë ujë në çadrat. Leci bashkë me robërit e tij u ftoh dhe iu sëmurën rëndë që të dy djemtë: kishin zjarrmi të madhe. Leci shkoi te mjeku, mirëpo ay, duke i parë të veshur keq ja lypi paret në dorë. «Kish vetëm dy çerekë; këto pas hesapit të mjekut nuk i arrinin as për karrocë. Dhe, kur doli rrugës për të gjetur nonjë rrugdalje, pada-shur iu kujtua lufta, vuajtjet, koha kur hanin mish kali e këlkëzë¹⁾; iu kujtuan florinjët e gruas, që i shiti për një qese kallamboqi, i erdhi për të qarë dhe e zuri kryet me dorë. Pas kësaj iu kujtua koha kur kërciste topi, kur vërvitte gjylet që pëlcisnin e sillnin shkatërime. Kur pa të shocën e pyeti:

— E moj, si janë?

Ajo nuk iu përgjegj, po vetëm qante e derthte lotë. E mori vesh që do të ishin më keq.

«Eh, more!» — tha me vete dhe doli jashtë e mori rrugën për në pazar, ku shpresonte të takonte nonjë mik e t'i mirrte hua ose të gjente nonjë punë.

* * *

Ora ishte më shumë se dy allafranga. Qielli ish kthjelluar dhe dielli po e ngrohte dheun, po e avullonte ujët; po e thante baltën dhe po e zbutte ajrin. Leci, me të arri-rë në gjymbryk,²⁾ pa që po çkarkonin një arkë të madhe të një tregëtari. Sadoqë rrotull saj ishin mbledhur më shumë se pesë hamej, nuk po i gjenin volinë se si ta mirrinin. Leci e kuptoi që këtu do të mund të mirrte nonjë çereke ose dhe më shumë bakshish dhe, pasi të nxirrte dhe shumë arka të tjera, do të mundte të fitonte mjaft para që të mirrte mjekun e t'i shëronte djemtë.

Hamajtë, me ta parë Lecin me sytë e zgurdulluar e me fytyra të egërsuara, u prapsnë dhe e lanë ta mirrte arkën. Me një vrull e këceu arkën mbi shpinë. Po nuk bëri dot as pesë çapa dhe arka e përkuli, i ra përsipër dhe nuk

1) këlkëzë = bar' i keq.

2) gjymbryk = doganë.

mundi të thotë dot as gjysmë fjalë, po vetëm thirri: «Oh»!.

U sulë hamajt e njerëzia dhe e liruan nga barra. Me të shpejtë erdhi mjeku i gjymbrykut dhe kuptoi se i qenë shtypur mushkëritë e i qenë thyer disa brinjë. E spërkatnë me ujë dhe mjeku i vuri një bar në hundë. Pas këtyre i hapi sytë, pa diellin, qiellin, rreth e rrotull dhe, me zë të ulët e me fjalë të prera, tha: «Në shtëpi... në shtëpi!»

Me shumë mundime e pas shumë të pyeturash, mezi e gjetnë ku banonte. Kur iu afruan çadrave, ay me gjisht tregonte çadrën e tij, banesën për të cilën nuk paguante qira. Kur e pa e shoqja, i mbushi sytë me lot, po nuk luajti nga vëndi. Kur e lëshuan mbi shtratin e hollë, meqë i qe prerë goja, shikoi fytyrat e zbeta të fëmijëve dhe me vështrim e pyeti: «Si janë?» Ajo nuk iu përgjeyq, po i zuri fëmijën me dorë, i lëshoi dhe, kur ranë si kërcunj, ja thirri ulurimës.

Tani e kuptoi ç'kish ngjarë, po nuk fliste dot; i hodhi sytë nga e shoqja që qante, pa fëmijën të vdekur, i vagulloi sytë, i zgjati këmbët dhe e dha frymën në shtëpinë e tij që nuk paguante qira.

E shoqja ja thirri të qarit me më shumë forcë, duke çjerrë fytyrën, duke kafshuar llërët dhe pastaj ngriti duart në qiell duke kërkuar hakmarrje mbi shkaktarët e të këqiave që pësoi, se mbeti pa burrë, pa fëmijë, pa bukë dhe pa strehë.

Shkodër, 25/V/914

SHENIME:

Tregimet e botuara në këtë përmbledhje janë nxjerrë nga librat «Rrëfenja» (1911) «Plagët e kurbetit» (1938), «Goca e Koçanikut e tregime të tjera» (1944) dhe nga revista dhe gazeta të kohës.

Në marrëveshje me autorin janë zgjedhur tregimet më me vlerë, që ruajnë edhe sot dinjitetin e tyre artistik.

Duke marrë parasysh se tregimet janë botuar në kohë të ndryshme dhe një pjesë e tyre janë shkruar për nevojat e ditës, u munduan të bëjmë disa ndreqje të pjesëshme pa i cënuar aspak gjërat kryesore.

Përsa i përket arkaizmave dhe barbarizmave që gjenden në tregimet, nuk kemi vënë dorë, me qëllim që të ruhen ngjyrat e kohës.

Tregimet po i botojmë me orthografinë e sotme.

Për të gjitha këto që përmendëm kemi rënë dakord me autorin

R.